



# Historia e Shqipetarevet t'Italise

*Prey*

PETRO SCAGLIONE (Pseudonimo P. Saravuli)

*Me parethenie prej Prof. JOSEF KADIKAMI*

*E me perhyrje prej LUMO SKENDO*



BK1  
S15

CONFIDENTIAL INFORMATION

PETRO SCAGLIONE

Pseudonimo P. SARAVULI



Συγγραφές. 30, 71  
τελ. 82 αεβ. χωρίς, 79

επιστολή Καννάδ 36

## Historia

# e Shqipetarevet t' Italise

ME PARETHENIE PREJ

PROF. JOSEF KADIKAMI

E ME PERHYRJE PREJ

LUMO SKENDO




NEW YORK

1921



**Copyright, 1921  
by  
PETRO SCAGLIONE**



PETRO SCAGLIONE (Pseudonimo P. Saravulli)

ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ  
ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΑ  
ΛΑΥΡΙΩΤΟΥ  
ΑΥΞΩΝ ΑΡΙΘ.....





TRASHGJIMTAREVET TE SKENDER-BEUT  
ATDHETAREVET TE VYER  
TE  
VDEKUREVE NE LUFTE PER LIRINE  
DJELMERISE SHQIPETARE  
QE  
MARE NE MESIMET DASHRORE  
KOMBETARE, E CILA DOT PERHAPENJE  
NE  
POPULLI, DASHURIN, VELLAZERIN  
DITURIN, DRITEZIN, LIRIN  
E  
MADHESIN TE SHQIPERISE  
KETE LIBRE HISTORIKE  
DEDIKONJE

AUTORI





## PARTHENIE

Mëndja e zëmerra e Petro Skaljonit, lindur në kollonitë Shqipëtare të Siçilisë, të gritura në dëshirat hejnore të atdheut i fillës, kjo është një provim drithësuame që dashuria permbahet në fisi i tyre, dashuri që i flakëron shpirtin përmón, në syrgjnitë t'emigruar; n'Itali, në shkonia e tyre në mestrë te kohës e menjëdashimin e vendëvet, edhe me gjith largjimit prej Atdheut që një dit shkëlqei Xheni trimërorë e të Atdhetarismës të Skënder-beut bashk me bujarët trima të tija, prej këtyre madhënime Skaljoni mori gjith idhealin të rrojtjes punitore, e në shkonia me suqipotë të shkëmimit keqesorë të fatit.

Dashuroj Shqipërin që në kohët e para të djalerisë e tij, me një dashuri xhelose e rrelative; Ë dashuroj në kohat që rënkojë e shpirtesojë nën sundunin keqesorë të Sultanicës; Ë dashuroj në të parat kohë fitimtarë e lirore të Djalmerisë Turke.

O Musulmanë Shqipëtarë, të cilët drengesuan tundimin litorë; Ë dashuroj në koha e rrësikëshme të çvillimit e luftës e përbolëshme, në e cilla luftë per të parren herë trimërimi ushteriak të Shqipëtarëvet të Shqipërisë tok me vëllezërit t'Italianisë luftuan një atdheu të gjishëvet, përçestjen e lirisë kundra perëndimit rremtar të lirisë e të demokracisë.

Emigruar nga Siçilia Piana dei Greçi në Amerikë Petro Skaljoni gjeti kohë për

me gritur tërë energjin e tij n'i vjetri i-dhical të Atdheut, e me deftuar një e fortë dëshirë e patreguame, hoqi prej dashurisë kombëtare, mburimet e laurimin të kultërs letrare.

Aj meriton lëvedimin të ket shkruar historin të kollonivet Italo-Shqipëtare në gjuhë Shqipe, në gjuha e mesuar me dashuri në tërë kohën te jetimit e tij, e që sot c flete e shkruan me mështrësi.

Kjo, është e para veprë historike prej ketij soji. Po me vërtetë më përparrë kyshiën të diturishmen Monografi e të vyerit Gjikat A. Mashi "Origine delle Colonie Albaneesi d'Italia" (Filesa e kollonivet Shqipëtare t'Italiane) shkruar në gjuhë klasike Italiane, e për këtë gje, pak o farë e njohur prej Shqipëtarëvet andej nga Adriatiku, të cilët nuk njohejën këtë gjuhë.

\*\*\*

Historia e Petro Skaljonit ka nderin të jetë e ree dhe e kohshmes, e bashkuar me mungjimet voglerisht, po naturishtë të pamëndëra dhe për ata që në ushtrimi letërarë kanë bërë fushiën e punës e tyre përgjith jetimin.

Petro Skaljoni n'Amerikë ka me dashur me punuar për me rrojtur, Petro Skaljoni për dy ca vjet ka qën i zëmërrë e i dobët nka shëndeta, edhe me gjith ka shkruejtur historin e tij copa, copa, krye, për krye, edhe dhënë në shtypë pasi te ket



## PARTHENIE

Mëndja e zëmerra e Petro Skaljonit, lindur në kollonitë Shqipëtare të Siçilisë, të gritura në dëshirat hejnore të atdheut i fillës, kjo është një provim drithësuame që dashuria permbahet në fisi i tyre, dashuri që i flakëron shpirtin përmor, në syrgjnitët t'emigruar; n'Itali, në shkonia e tyre në mestrë te kohës e mendrishimin e vendëvet, edhe me gjith largjimit prej Atdheut që një dit shkëlqei Xheni trimërorë e të Atdhetarismës të Skënder-beut bashik me bujarët trima të tija, prej këtyre madhënime Skaljoni morri gjith idhealin të rrojtjes punitore, e në shkonia me suqipotë të shkëmimit keqesorë të fatit.

Dashuroj Shqipërin që në kohët e para të djalterisë e tij, me një dashuri xhelose e rrelative; Është dashuroj në kohat që rënkojë e shpirtesojë nën sundunin keqesorë të Sultanit; Është dashuroj në të parat kohë fitimitare e lirore të Djelmerisë Turke.

O Musulmanë Shqipëtarë, të cilët drengesuan tundimin lirorë; Është dashuroj në koha e-rresikëshme të çvillimit e luftës e përbotëshme, në e cilla luftë per të parën herë trimerimi ushteriaq të Shqipëtarëvet të Shqipërisë tok me vëllezërit t'Italianë luftuan në atdheu të gjishëvet, përcështjen e lirisë kundra perëndimit rremtar të lirisë e të demokracisë.

Emigruar nga Siçilia Piana dei Greçi në Amerikë Petro Skaljoni gjeti kohë përm

me gritur tërë energjin e tij n'i vjetri i-dheal të Atdheut, e me deftuar një e fortë dëshirë e patreguame, hoqi prej dashurisë kombëtare, mburimet e laurimin të kultërs letrare.

Aj meriton lëvedimin të ket shkruar historin të kollonivet Italo-Shqipëtare në gjilë Shqipe, në gjuhja e mesuar me dashuri në tërë kohën te jetimit e tij, e që sot c flete e shkruan me mështrësi.

Kjo, është e para veprë historike prej ketij soji. Po me vërtetë më përpëra kyshën të diturishmen Monografi e të vyerit Gjikat A. Mashi "Origine delle Colonie Albanese d'Italia" (Filesa e kollonivet Shqipëtare t'Italiane) shkruar në gjuhë klasike Italiane, e përkëtë gje, pak o farë e njohur prej Shqipëtarëvet andej nga Adriatiku, të cilët nuk njohejën këtë gjuhë.

\*\*\*

Historia e Petro Skaljonit ka nderin të jetë e ree dhe e kohshimes, e bashkuar me mungjimet voglerishit, po naturishtë të pamëndëra dhe për ata që në ushtrimi letesarë kanë bërë fushën e punës e tyre përgjith jetimin.

Petro Skaljoni n'Amerikë ka me dashur me punuar për me rrojtur, Petro Skaljoni për dy ca vjet ka qën i zëmëre e i dobët nka shëndeta, edhe me gjith ka shkruan historin e tij copa, copa, krye, përkrye, edhe dhën në shtypë pasi te ket



## PARTHÉNIE

mbaruar me shkruar, pa me pasur kohën e kujdesimin të ndreqesimit e të përmble-dhesimit sistematik.

Nga ky shkak mungon këtu e ketje ligjja e gatimit në urdhëri kronologjkë.

Janë disa mungesa, dhe të lena. Çë me daljen në dani e në e vërteta në mbarimi të veprës.

Me kot kërkonen emera të Italo-Shqipëtarëc, të degjuar në historia t'ITALISË, si leterat e kanunistë e gjykat të vyer, me kot kërkonen emërat të martiruzuamit, dhe të trimëvet që madhenojën pralezimin epik të rringjalimit t'ITALISË, me tërë kurajon e me hekien të karakterit të sojit i tyre i parë Shqipetar. Janë mungjime që autori në shpejtësimi të shtypit nuk mendë më shpëtuar.

Po mungesa që dot jen të ndregesa uara në një e dytë rrështhpie, në këndonjesit, e më teprë prej a tyre të mëmdheut bëjën një mirëpritje librit, kjo veprë dot kujtonjë e tyre ç'dot et e pa-mundur në shkrirtarët t'ardhemit që të mëndë shkruaën historin e përgjithshme të Shqipërisë, mos me njohur shdrivillimin e çvillimin letrare prej ç'do kolloni Shqipëtare, të cilat kolloni për me shkuar rrësikun të tiranisë Turke; e migruan jashta

shqiperisë, e më teprë n'Itali, në Rumania n'Egjypë, në Gregi, dhe në tjerë vende të botës, të cilët ndodhen në hatrin e shdrivillimit e të çvillimit të lettruresë.

\* \* \*

Në përfundimi libri historikë të P. Skaljonit ka meritin' i pa-kuvendar të fillesës, e të oportunitetit, po n'aji trëgon një bujari e përbajtur me mëntime patriotike, e të flakta, që elegjon në shpirti e në fjalë të rrefimit historikë.

Për këtë nderim vepra dot jarrenjë me pëlqim në bujarishini popull e trimërorë iç Shqipërisë, në ky çastë historikë e madheshtor, prej të cillit tërë bota e qyteteruanë ka kethjer syt në trashgjimtarët të Skënder-beut, për me gjykuar mendjen e zotimin i tyre, në shpërblimi politik e madheshtor për me zgjedhur me mëndje më të mëdhat problema, në uidisimi të kostitucionës të qeverisë kombëtare mbi themëlin te urdhurimit e të lirisë e të demografisë, të pa hilë e të pa rar-mëndjes në krimi, që pëslitjet me drithë gjaktare dhe fatzezë flamurin i kuq' o sovjetiste të demagogjis moderne.

PROF. JOSEF KADIKAMI





## PERHYRJE

Për veprën që na jep sot Zoti Petro Skaljone ndjejmë tërë atë simpati që ndjen zëniëra e ç'do Shqipëtar i për kolonit Arbreshe t'Italianë. Kjo veprë na mush një mungin një nevojë.

Na ep një kujtim me të afrëtë për ata vellezër tanë të ndar prej nesh prej një dët, po të bashkuar dhë kurrë të pëndar në zëmerat tonë.

Pesë shekuj të gjatë të dy degat e një lastari kanë qënë pa marredhenëje menjëra jatren, pa prekje, pa piekje. Themi më tëprë pë ne të Shqipërisë, të Arbrisë, fort pakë degjonim emërin' e atyre vellezëritë, me pakë akoma venim t'i vizitojmë, ose pothua se kurrë i kishim par no një prej tyre që të vijë ne dera e atrit, të shohë vatrën dhe pleqtë. Të dy palët rronin në mosnjohje të njeri jatrit.

S'ka më teprë se gjysmë qintvjeti që njehemi, dhe që dimë se përtej detit kemi vellezër që flasin, që ndjejnë, që mejtojnë si ne.

Këtë ndjenjë këtë mentim Arbreshi t'ë Kalabrisë dhe të Sicilisë, kolloni t'ë Shqipëtarë t'ë Italianë e kanë ruajtur të pa-tundur. Kanë mbetur besnik ne shpirti e gjyshëvet të tyre. Kam dëgjuar se Arbreshi, pasi dalen nga kisha, burra, gra dhe fëmijë kthehen nga lind dielli-drejt asaj pikë ku ne kujtim t'ë tyre janë vatratal' e strëgjyshevët — bien më gjunjë dhe këndoja një kantike patriotike. Nukë di në jetët t'ime gje më të mallëngjyshme dhe më poetikërisht sentimentale se keta lutje, që është dhe një hov, një klithje e zëmëres drejt një vëndi prej t'ë cilët fati


i verbër e ka ç'kçputur, po që gjaku nuk e le ta harojnë.

Këtë kujtim t'ë origjinës, këtë lithkë ne besa e atevet, Arbreshi t'ë kanë mbajtur t'ë gjallë dhe t'ë fortë: Kanë qëne madeshitorë t'ë kujtojnë se janë bijt e Shkëmbënjet t'ë Shqiperisë, s'e kanë haruarë që gjaku që i rjeth në rëmbat e tyre është tërë ay gjak që i zjente në krahëror t'ë iroit Kastriot.

Edhe kur një vjershëtor Arbresh heth një notë t'ë fortë kundër Tyrgvet, ajo notë është një mallkin kundër gallinjyvet asiatic që ika grabitur shtëpin dhe e ka ndar nga njerëzija.

Po ky kujtim i origjinës, nukë manifeitohetë vetëm me ndjenjën e madhështisë në racat, vetëm me besnikeri në gjuha. Rrefehetë dhe në dashuria e vërtetë që ndyen ç'do Arbresh për Shqipërinë tënë; rrefehetë më teprë akoma në punat t'ë bërra prej Arbreshëvet për t'ë punuar, për t'ë begatuar dhe për t'ë zbuluar gjuhën dhe leteraturën e strëgjyshevët. Me një fjalë kjo besnikroi në gojëdhanëjet e pleqve, lithka dhe dashuria për tokën mëmë, i-mbetet vetëm me manifestime lendorë dhe inkonsiente, po deftehetë edhe më teprë akoma në formë intelektuale, më një mënyrë konsiente.

Radhoj i shkrimitarevet Shqipëtarevet t'ë kolloni vjet n'Itali është mjaft i math. Zoti Petro Skaljone na rrefen disa syresh; më parë tij Stratico-i në (Manuale di Letteratura Albanese), na kishte dhënë një radhua që na mbushte zëmerën me kryelartesi: Përgjithërisht shumë prej



këndonjësvet tanë dinë vetëm emerat e Kamarda dhe De Radës, të ketyre dy patriarkeve punetorë të palodhur të gjuhës dhe shëbertorë të famës Shqipëtarë të mbëdhënë — dhe shkruanë jo për qejfin e shkrimit dhe të shtyrë prej instinktit, po duke punuar për të vetëmin qellim t'i jepin emër dhe famë Shqipes dhe Shqipërise — veç ketyre dy fytyrave të venerashme, gjejmë dhe një tok të tjerë, të shpirtesuar gjithë prej asaj fryme patriotike, shërbëtorë të gjith asaj ideje. Sà, për shëmbllë, një prej tyre, Vincenzo Dorsa, autori i librës Ricerche e Pensieri, i cili merr për motto të veprës se ty keto fjälë: Heuréeix cluis qui élève un monument à sa Patrie! (*I lumtur aj që i ngreh një monument vendit të tij*). Një vjershië e tërë, një roman i vërtetë mbledhur me një fjale të shkurtur, se vendi i lindjes, toka memë, për këtë burrë, ështe Italia, e bukur dhe e gjere, po aj vend m'at'anë deitet, ajo Shqipëri e voglë dhe e varfër, kujtimi se cilë — kujtim jo i mbajturë i gjallë se i parë, po i ndjerë, se i trashëguar ne gjakun dhe me fryshtën — kujtim që i Tfaqetë — përparr teyezes kur shkon, përparr udhësë — kur accën dhe shitet, kujtim që i siell, ç'do ditë Dielli që lind. Dhe përpanesh tfaqetë fytyra e një patrioti, e një njeri me durim që punon vetëm për emerin dhe famën e vellezerezet, nipevet dhe të gjyshevët.

Me një fjälë të një burri fisnik.

Edhe menjtohem këtë fisnikeri Arbreshët a e fituanë në piekje me kombin neccollatin të Italisë, me marredhënëje me atë qytetërim të bukur dhe të hollë që shkelqen në krye të kohësë moderne, se po-dhe kjo eshtë me afrë se vërtetës e suallë me vetëhe me qënë se ata që iknë përparr Tyrkut padyshim qenë prej shkallësë me fisnikë dhe më aristokrate, ose të pakën me kryelartë dhe me kuximtare.

Këtë fisnikëri, këtë kuxim Arbreshët e rrëfyenë — dhe jam i lumtur të shkruanë këtu — dhe në fushët politike, edhe me ditët tona, jo shumi muaj më parë se nga dita që po shkruan këto radhë duke mbajturë një vendim edhe kundrë qeverisë Italiane, kur që fjalë për lirinë dhe independentencën e plotë të Shqipërisë.

“Noblesse oblige”, thotë frengu; edhe aj që ështe fisnik vërtet merr barrë të bukurë, po edhe shpesh të rëndë.

Duke kënduar veprën e Zoti Petro Skaljone këta janë mendimet që i vijnë njeriut; dhe vertet jemi fatbardhë që kemi në dorë një librë të tillë të vjejtur, të dobishme dhe të bukurë.

Për këtë i jemi mirënjojës autorit.

Zoti Skaljone e di mirë tezën e tij. Duke se ka pasur durimin dhe dashurinë e mjeshtërisë, se ka dashur edhe aj të ngrehë një monument, për vendin dhe për gjyshi; i njeh mirë ata që kanë rrojtur, shkuar dhe levduar përparrë tij.

Edhe pandaj këtë veprë të sotme e shohim si një prëmtim për një veprë më të gjercë, më të thellë ku autori të na bëjë të njohim edhe më mirë akoma kohën dhe fytyrat e shkuara të kollonivet Arbreshc.

Këtë prëmtim e gjejmë në mes të ç'do fajqeje, dhe veprën më të plotë e presim, kemi të drejtë ta presim prej një kërkonesi durimtar si Zoti Skaljone.

Nderimi për pleqtë, për të moqmët, për gjyshët dhe stergjyshët është një virtut.

Historia e të shkuarëvet është një mesim, një vëzhgim për ne. Kolloni Shqipetare të Italisë që kanë dispozitë të tyre thesorët e bibliotekavet dhe të arkivave — e kanë për detyre punën e këtyre shkrimeve.

Që tani shohim se një qendrë fort simpatike dhe intelektuale — qendra e monastirit Grottaferrata afer Romës — po merretë me kërkime historike dhe letçrare mi Arbreshët dhe Shqipëtarët. Revista e saj Roma e l'Oriente ka botuar me teprë se një studim me interes dhe rëndësi të vërtetë. Shoqeria e Palermos edhe ajo po bën një punë të levduar, dho eshtë një qendrë e ndritur. Këta të dy burrime shpresojnë se do të jen shëmbella përkrijmin e të tjerëve, për kërkimet dhe studimet historike, literare, glotoriste dhe sociologjije të cilëvet presim një lendë serioze dhe të dobishme, përfamën dha ndrin të Shqipëtarizmës.

Noblesse Oblige.

Barcelona, 8 Prill 1921.

LUMO SKENDO  
Midhat Frasheri





## K R Y E . I .

### FILLES A

Fillojm, istorin tēnē që nē kohë tē luf-tavet, te ushtarit trim luan Shqipëtar Gjergj Kastriota pér njohur më teprë pér mi emërin Skënder-bëu. Lufta pér mbaj-tur kundra armiqëvët pér mon, Sultanë-vet tē Turqis Muratit II edhe pastaj më vonë, kundra tē bjirit Muamitet II, cili u hip nē thron tē Turqis, pas vdekies e t'atit.

Veprat trimërore, e tē pa vdekurit Shqipëtar u dëgjuan nē pér tërë botën. Shumë Princira Kristianë, kur dëgjuan ve-prat eroike tē Princit Shqipëtar kundra Infedelit, i dërguan falënderie bashkë me dhurata, pér më kët shpëtuar Euro-pën dhe Krishterimin, nga invadori barbar Infidel, dhe e thirrnin *Salvator*, i Krishterimit.

Njeri prej këtire Princa ishte Alfonso ng'Aragona, Mbret' i Napolit, cilli dërgoi Skënder-beut, me ambasador teprë dhurata, dhe ushqyme pér kombin Shqipëtar. Ambasadori i çoi bashkt nje letrë personale ku i thoshte: Se u kish mbetur'i çeditur nga trimeria etjë edhe do tē kish-te pér nder tē me pasur pér mik, Princin Shqipëtar, cili vërtëtë rrëfeu tē jëtë trashgimtari i tē famëshmit gjeneral *Maqedhon-Epirot, Alexandri e Pirros*.

Skënder-bëu ndëroj shumë mirë ambasadorin kalorishtë i dërgoj fal nderie e se mbetejë teprë i kanaqyr, tē kish nderin tē ishte miku i një Princi tē shpisë Mbretërore t'Aragonës. Nga ky shkak tē dy Princirat lidhnë një miqesi tē fortë, e

vëllazënore. Shumë herë Mbreti Alfonso ndihmoi Skënder-bëun, me ushqyme pér ushtrinë Shqipëtare. Në mest tē kohës që pérderojë miqesia, nē dy Princirat, Mbret Alfonso pati trubulime nē viset e Kalabris, me krye-gritje prej popullit.

Nga ky shkak Mbret Alfonso dërgoj e lipi ndihmë prej Skënder-bëut, pér me pushuar krye-gritien Princi Shqipetar me gjithë se ish nē luftë, deshi tē ndihmojë mikun e i dërgoj ushteri Shqipëtare nën kumandatin Shqipëtar Dimitri Reres, bashke me tē bjite, Vasilin edhe Gjergjn, këta qenë tē parët Shqipëtarë që hinë ne tok t'Italis. Dimitri me tē bjitet edhe ush-terin Shqipëtarë, me pushoj, e qetesoj trubullimet e Kalabris.

Mbreti Alfonso ng'Aragona u mbet mjaft i kanaqyr nga methot që përdori Gjenerali Shqipëtar pér tē pushuar krye-gritien pa prishur shume gjakë. Ju fal nderit e pér tē nderuar, e bëri governor e Kalabris tē poshtme, (1) edhe fali e dhuroi shumë vende nga Vialeti Katanzaro, nē këta vise që patin dhurat, Shqipëtarët filluan e gritën disa fshatra, cilët qenë këta. Andali, Karaffa, Karfizzi, Gizzeria, Marçedula, Pallangorio, San Nikolò dell'Alto, Vena, Zingarone, Arieta, Amato, Kasalnuovo.

Shumë autorë janë me mëntime ndri-she, nga ardhia n'Itali te Dimitrit Reres, di sa nga keta autore e kan vune ne mest te kohes 1416-1450 (2).



*Shënim*

(1) Marrjëm e i japjëm për të liçitur këndonjësevet, një pustull (dokumentë) e vjetër gjëndur në saloni mbretëror të Qytetit Napoli, ky pustull ishtë në gjuhën latine.

"Alfonso për hir-in të Zotit, Mbret

shëbërtirën e huajtur kurorës jone mbretërore.

"Konsideruar se me madhesi, mëndësi ka përduruar shërbimet ushteriak, si Kapedan të tre kolonivet Shqipëtare, nën shërbim tënë dhe me prishje kjaku, për



GJERGJ KASTRIOTA SKENDER-BEU  
Mbret' i Shqiperise 1404-1467

t'Aragonesëvet, të Sicilivet, të Gjerësalmit, të Valenzës dhe të Ungeresëvet, e tjetrë.

"Bujari ushtar Demetrio Reres, Kapedan trim t'Epirotëvet, i dashuri jinë besnik, ju ka dhën prej Mbretëris jonë lirishtë për herë, për me ju njojur ndihmëtarëvet mikë, nën-heqesit, pjesdarketarëvet, dhe tërë njerëzit, mirë bënesit, për

me fituar tërë Provincën e Kalabris të Poshtme, si kur do herë dhe në tjer raste, qe i kadishme dhe bashkë i gatuar me bijtë tatë Vasilin, e Gjergjn, cili tani mbetet në mbretëria jonë të Sicilis andej nga Fari, nën shërbimin tënë si Kapedan t'Epirotëvet sundimetarë tanë, cilët jan për ndihmën të thënës mbretëri, prej Gallivet invadorë, për njojjen e këtyre, dhe për të vjetrën tënte Bujari cila merr files

prej të Shkëlquemes familje Kastriota prej Princëvet Epirotë, kemi qëndruar pë me ju sgjedhur, e me u kriuar, dhe emëruar, ai i hejshmi ushtar Demetrio Reres, Governor mbretëror joni të ethënies Provincë jonë e Kalabris e Poshtme, si me virtutin të pelqimin të përpashme pustull mbretërore jonë, sgjedhjëm, dhe kriojëm, dhe emërojëm përdhënien e parë tënë, Governor Mbretëror të e thënës Provincë të Kalabris e Poshtme, me të dreitat, lypje, parime, madhëni, autoritet, pushtet, falje privilegje, fitime, si edhe në të tëra të ardhme në çë fare do soje qì ingasjën për drejtësi e të thënës zyrë, të barrës Governore.

“Për këtë gje urdhurojëm tërë zyrtarëvet të medhënjë, e më të vergijl, të përpashmë, s’edhe më t’ardhurit, s’edhe përtë tjer besnikitarë; e pushtimetarë, po sa me qit të përpashmen pustull mbretërore.

“Me tundur nga ndo një vadje o vomin, për të dhënnenë dorë, me të zakonëshmet besimitarë, të pushtimit e të thënjes zyrë, për me zën barren tën pë Governor, mbretëror, t’ e thënies Provincë, e me ndëruar e me njohur si neve Governor Mbretërorë jinë, dhe tue me shkue dhe për me ngrijtut në çë do sojë të përkrahshme në tërë urdhrimet, rrushtimin

urdhuror, kuit ti ngasnëjë ta gënjë pa me vrejtur, e pa me vatur kuntra, nën fajin të hidhirimin të mbretërisë jonë.

“Dhenë në Gaeta me i të Shtatorit 1448.

*“Une Mbret Alfonso”.*

Më poshtë.

“Për urdhreimin e të për ndershçmin Mbret Alfonso, Don Tommaso Girafalko, i madhi Sekretar.

“E ka qjën e hequr e përparshma kopie të pustullus mbretërore, në regjishtri të përkuidesivet të për nderçmin Mbret Alfonso, ndodhur në sala mbretërore të këtij Qyteti Napoli, me të cilën, u përkundrua, e ujdishme etj.

“Unë Dottor Don Giorgio Reres, kam pasur ka i thëni notar kopie originale e përparshmen kuitimtare.

“I nënshkruari.

*“Une Dottor Don Gjergj Reres”.*

(2) Pas kërkimëvet tonë, dhe Zotimin e pustullës sipër shënuar, data me vërtetë e te shkuarit në Itali të gjeneralit Shqipëtar Demetrio Reres, dotë j’etë në, koha çë vete, në 1440-1450. Dhe jo në kohën 1416, përsë në ajo kohë Skënder-bëu, ishte i vogël, dhe Skllev i Sultanit.

## K R Y E II.

### SKËNDER-BËU N’ITALI

Në një 1461, Ferdinandi Mbret i ri i Mbretërise dy Sicilivet, cili u kish hipur në thron, pas vdekjes të mikut të Shqipëris Mbret Alfonso ng’Aragona, vdekje ardhur në 1458. Ferdinandi që kur hapi në thron, ju filluan trubulime në tërë mbretërinë, e pastaj më vonë më teprë, përsë Princi Giovanni nga Taranto, ju grijt kuntra tue me bashkuar me Franssin Karlo d’Angio, për me erësuar poshtë. Mbret Ferdinandi duk shkuar rrezikun që ndodhejë, u kishillua me Shejtesin etje Papen, cili ish Pio II, Papa e kishilloi, për te lipur ndihme Skënder-beut, cili kishtë qënë miku i math t’atit. Mbret Ferdi-

nando mori keshillat e të Shejtit At, edhe shpeto dërgoi Ambasador në Skënder-bëu, tue me ju lutur per me ndihmuar në ky rrezik të madh që ndodhenjë, dhe tue ju mëntuar miqesin e vjetërë.

Muamet II pas një luftë të rreptë që kishë pasur me trimin luan Shqipëtar pati humbur shumë ushteri, e nga ky shkak lipi pushimin e luftës tue me dhënë besën për një mot mos me lustuar. Skënder-bëu, kur arrun Ambasadorët e Mbret Ferdinandit ndodhejë në marëveshje me Sultanin Muameten II, e kur digjoj e kuptëoj rrezikun që ndodhejë i biri i mi-



kut, akseptojoj pushimin e luftës tue me dhënë besën për një mot. Ky shkrim u nënshkrua me 22 të Qershorit nj 1461.

Kur Skënder-bëu, ujdisi e vuri tërë në vent la Qiverimin në dorë të nuses e tij bashkë me Bujarin Lek Dukagjinin. Skënder-bëu u nis me ushteri Shqipëtare përtë ndihmuar personalisht Mbret Ferdinandi në Itali.

dhe shtrëngoi këtë për të shkuar nga Qyteti Barleta e prej fortesez *Roka di Trajni*, e nga shume të tjera vise, Po te ardhur lajme nga Shqiperia. Skënder-bëut, se Muameti II, kishte çare besen, trimi mentoi për me shkuar në Shqipëri, mos me humbasur atdhen. Po Mbret Ferdinandi nuk ella per me shkoje pa nderuar, ashtu porositi shume festa përtë nderuar



PAPA CLEMENTE XII.  
Prej fisi Shqipetar

Skënder-bëu me ushterin Shqipëtare zbriti në Qyteti Brindisi tek' u bashkua me ushterin e Ferdinandit. Ushteria Francese-ish urdhuruar nga gjenerali i degjuar Konte Piççinino, cili përdorojë mjeshteri të madhe dhe kërkojë me intriga për me gënjer Princin Shqipetar, po Skënder-bëu, nuk ish ajnjeri përtë gënjer se në pune e luftes ish me izoti se Piççinini.

Skënder-bëu luftoi trimerisht edhe fitoi shume lufta kuntra Kontit Piççinino,

trimin Shqipëtar, e idha për dhuratë edhe e veshi me Dukatin të Sh. Pietro Galatina.

Po ushteria Shqipëtare mbet, në Napoli nën urdherimin e një gjenerali qe i thoshënë Basta, edhe bashk u mbet një nip të Skënder-bëut për emer Ghjni Stresio, kjo ushteri pas pushhimin i luftëvet, u bashkua me tjatret shqipëtare pë ishin n'Itali. Skënder-bëu pas që ju fale nderit Mbretit Ferdinandit për festat, e dhuratat, qe i fali, shkoi në Romë përtë salu-

tuar Shejtësin e krye Fese Katolike. Në Rome Shejtesia e tje Papa Pio II, priti me ndërimë mbretërore, Princin ushtar shqipëtar, e levduar për trimërin e ndëfuar në tërë luftat, edhe e thirri e emroi *Kampioni i Fesë Kristiane*.

Skënder-bëu mbet dy muajë në Romë e pastaj shkoi në Shqiperi teku gjeti Sultan Muametin që kishë prishur Besën.

Po luani shqipëtar me shpeitësi organizoi ushterin, edhe luftoi armikun tue me pasur me ate fitime të mbëdha. Po në 1467 tue dashur për me organizuar një ushteri të shëndoshime për të dhënë funt luftës, për liruar për mon Shqipërin nga armiku, Thirri ne Lesh tërë parësin e Shqipëtarëvet për të mbajtur kuvënt për me bisiduar çestijen. Po fati i keq i Shqipëris, nuke la trimin për të mbushur dëtyrën e tjë, përsë u sumur keq dreq në

ajo kokë e nivoshme, trimi u mëntua në ora e fundit se vdekja e tjë ishte humbia e atdheut, e me përrpara se me vdekur thirri paresin rrotul edhe i rrekomandoi bashkim në donin të mirën e atdheut trimi tue mentuar njerë ne-ora e fundit mëmëdheun, fali shpirtin Perendise me 17 te Kollozekut 1467.

Vdekja e luanit shqipëtar qe humbia e liris te Shqipërisë, për se aj bashkimi që teprë i rakomanduar prej trimit nuke e paten, se grindja, ambizia griste shpirtërat e tyre, për kush të ish kumandari.

Humbia e Atit qe zia për tere shqipërine. Shtu thirri me zërë i këputur nga dhima i nderçmi Lek Dukagini, kur shekoi se trimi dha shpirtin.

*Ieta na u err prej ne  
Skënder-bëu s'është më.*

### K R Y E III. GHJINI KASTRIOTI

Pas vdekjes e Skënderbeut: Hipi në tronë të Shqipërisë i biri Ghjni Kastrioti, Ndihmuar nga Princi i Shqipëris të poshtëme Arianiti Komneno, cili ish ati i mëmës Ghjnijt.

Turqit kur dëgjuanë vdekjën e Skënderbeut, muartin më teprë kurajo, e mëntuan se ardhhi koha duke me marrë inatin. Si filuan një ushteri të madhe nën urdhërimin e Vezirit Yussuf Pasha, invadhoj prapë Shqipërinë.

Princi Shqipëtar Ghjn Kastrioti, luftoi trimërisht per 12 vjet kundra armikut, po më 1480 ngiau një përcarje në meste Shqipëtarëvet, me ardhien e vdekjes e gysht të Ghjnijt, Princi Arianite Komneno i Himares.

Himariotet pas vdekjes të Princit tyre nuku deshnin të bashkoneshin me vellezërit të Shqipërisë të sipërme. E për këto shkate, thirnë kuvent në mes të tyre e në kuvent qenë shumë përcarje kudra Shkodranëvet, dhe të tjerëve Shqipëtarë të Shqipëris' e sipërme. Në këtë kuvent sollogjuant prishien e bashkimit (1).

Ajy kuvent qe humbja e Shqipëris, jo vetëm sollogjuan me mos ndihmuar më në luftë vellëzqrit e tyre, po edhe i shkruajtin armikut, kumandarit Turk Yussuf Pashiës, duk'e i thënë në ajy i lë të lirë në Qytetet, e viset e tyre, ata mbeteshin pa me luftuar. Viziri Yussuf Pasha, kur mori vesh përcarjen e Shqipëtarëvet, u kënaq e u gëzua tepër shumë, se kuy shkak jepte rastin nér me fituar luttën.

Edhe jo vetëm se i leshoj ato gjera qe ata i lipen, po edhe më teprë, për tue me kënaqur e gënjer më mirë, e ashtu bën trataktin, e i idhane besën.

Yussuf pasha mbledhi tërë ushterin Turke edhe e shpuri tërë kundra ushteris e Ghjn Kastriotit. Ghjni luftoi; trimërsht bashkë me ushterin po ishën shum pak edhe armiku kishte një ushteri të madhe.

Parësia e Shqipëris e sipërme kur shekuan se vellezërit e Shqipëris'e poshtëme, ilanë në dorë të armikut, kupetuan se ardhni ora e fundit të humbjes e Shqipë-



ris, 'e mbaitin një mbledhie nënë kryesin e Princit Ghjn Kastriotit për tue me kishilluar. Në mbledien kishën marrë piesë këta kapedanë, cilet ishën mbetur besnik. Vëllezërit Kola e Marko Shini, Elia Malosi, Marko Madhia, cili ish'i zot i 50 çiflike ne Musaqe, Gjergj Mirespia, Zakkaria Groppa, Paolo Manes, Elia Mallisi, e Ghjni Dara, e shum të tjerë. Në këshil sollogjnan për të lipur ndihmë Republikes Veneciane, për tju dërguar disa anie, tue me shkuar në Itali, për me shpëtuar nga skllavëria.

Republika Veneciane, kërkimet e Shqipëtarëvet i mori me pelqim e dashuri edhe i dergoi miaft anie, për me ngarkuar, po nga shkakë se në Adriatik, nga limanet e Shqipërisë ishte flota Turke, aniet Veneciane nuku afrojan në limani i Antivarat e shkuan ne limani Shkiavoni, që kish per emër Pastroviç, cili ish nën sundimin te Qeveris Veneciane. Kur Ghjni Kastrioti mori lajmen se aniet nuk mundë të afronëshin në limanet e Shqipëris' kuptëuan se ishën në rezik të math. Po Shqipëtarët nuk kishën frikë e mëntuan

për me vatur në ajy, liman'i Pastroviçit Ashtu u përblodhën tëre se bashku për të me marrë me yrysh armikun. Një natë mjegullore dhe e erëshme cila udihmontë pllanin e Shqipëtarëvet, këta u bashkuan tëre për se bashku, edhe foshnjat, plakat, edhe grat, i vunë në mes e tyre, trimat rotul tyre (2).

Kështu tëre bashkë me marë një yrysh si luane shtynin armikun. Turqit të cilit flinin nuk kupëtuan ç'u kish ngjare, dhe nga shkaku i erësirës nuk shkojnë Shqipëtarët, si dhe nga frika dhe nga mos kuptëimi luftoneshin në mes të tyre ku bë një trubëllim i math. Shqipëtarët muaratin çastin e ikën me shepjësi duk e shkuar Malesinë edhe kur erdhë dita i shën shume larg nga armiku, e pas shume të pa pritme arrinë në Pastroviç: Po kur shkuan radhimin e njerëzisë shkuan se shumë u kishën humbur në udhetim. Aniet Veneciane ishin tëre në liman tue me pritur Shqipëtarët. Kështu u ngarkuan mi aniet, e Ghjni urdheroi për të marë udhën e Sicilis.

### *Shenim*

(1) Historia e Ghjn Kastriotit qe botuar nga Girolamo De Rada në e paragazete Shqipe (La Bandiera dell'Albania) Flamuri i Shqiperis. Girolamo De Rada dorëshkrimin e gjeti në shpia e Shqipëtarit, Zotit Flaminio Toççi cili ishte prej katundit Sh. Kosmo Albanese

(Kalabri). Dorëshkrimi thotë, se Himariotët në atë kohë kuptëtoneshin për Shqipëtarët e Juges.

(2) Dorëshkrimi i Zotit Toççit thot se edhe shumë gra Shqipëtarë ishën të armatosura edhe luftonin bashkë me burrat.

### K R Y E I V .

#### FERRANTI NG'ARAGONA, EDHE SHQIPETARET

Në Mbretëria e dy Siçilivet, Mbretëroj, Mbret Ferranti ng'Aragona, pse Mbret Ferdinandi kishte vdekur. Ferranti rrojë në Qyteti Palermo. Ghjni Kastrioti u kishillua me parësinë, për me shkuar në limani të ati Qyteti. Kur arrun në limani Shqipëtarët lajmeruan ardhien e tyre, e

tue me lipur ndihmë. Po kur Mbret Ferranti njeri frikaman edhe i poshter, nga frika se Turqit mundë tu bejenne lufte në ajy ndihmoj Shqipetaret, dha urdhur mos hynë në Qyteti, po jo vetëm në Palermo po dhe në tëre Mbretërin e tyre.

## Donika nusia e Skender-beut, Mbreteresa e Shqiperise (Donika Golemi-Kommene Thopia)

Per me qene Mbreteresa t'Epri urtesia te buri  
Me hjan hejnishte qe Perendis Jovit pelqente



Aqe e dashur je nga burri jit, sa fama qe meriton  
Aqe sa qe Deidamia (1) per burrin i saje.

(1) Deidamia e bija e Likomedit mbreti Shirot ne Eto'i, qe ne dashuri te forte me Akilin, prej te ciles dashuri u lini Pirrua I.

Shqipëtarët ju lutnë të kish kujdes nga ndodhia a keqe të tyre, po Ferranti qe i shurdhur nga lutjet e Shqipëtarëvet. Vehtëm judha mjaftë ushqime e i urdhuroj me shkuar.

Shqipëtarët u helmuan dhe u deshpreruan teprë nga fati i keq qi përdoj. E prapë muartin detin më deshperim të math. Pas shumë dit aniet arinë afrë Qytetit Napoli, e kur Shqipëtarët shkuan prapë dhee, Ghjni Kastrioti thirri tërë paresin në anie të tii për të shkuar të dalë nga reziku. Në mbledhia solliguan për të marë dhee edhe të ishën të shtren-guar me marë me palle në dorë.

Po nën-Mbreti cili kish marë urdherimin nga Palermo të mos lërë të hyine Shqipëtarët. Shqipëtarët Kishin afuar në skele të Qytetit Salerno per me dalë jashtë, Po nën-Mbreti me ushteri i shtrëngoj mos me hynë brënda Qytetit Salerno. Shqipëtarët, e të deshpëruar shkuan për në Napoli, populi i Napolit zili simbathizoj shumë Shqipëtarët, e mori vesh urdherimin e poshtër të nem-bretit u ngrit kundra, e priti aniet e shqipëtarëvet në skelë të Qytetit.

Kur aniet u afroan populi thirri rrof-shin Shqipetaret dhe me enthuziasmë të madhë Shqipëtarët hyrën brënda ne Qytetin Napoli festuar shumë nga populi mirënjontës.

Nen-mbreti pati të bëjë volontetin e popullit edhe për konak ju dha një fortës me emerin Kastel Nuovo ku për të parën herë atje u prëhne trupin pas shumë trazimesh.

Pas siç mbetën pak kohë Ghjni Kastrioti la qevërimin e Shqipëtarëvet në dorë të Mark Shini, e shkoj me parësinë në Romë e cila parësi përbëheshë me këta: Gjergj, Mirespia, Zaharia

Groppa, Paolo Manes, Ellia Mallisi, e Ghjni Dara, edhe të tjera luftetarë.

Si arinë në Romë, Ghjni Kastrioti vate i ra në gjunjë Shejténis cili ishte Paolo II. Duke thene dy gjera:

“Une që ri pérpara tëjë jam një burre “cili për 12 vjetë kam luftuar kundër “Turkut si në kohët e shkuara, kishën “luftuar gjyshi dhe Ati im Skënderbeu, “edhe të vellezerit e ti, të cilit vdikjën “të farmakosur, për fenë të Krishtit. “Tashi që na ardhi me pak gjake pasja “e fuqia shtypur nga armiku i Kristia-“nëvet, vijni për të kërkuar konak në “Kristianët. Po Mbret Ferranti nga-“Aragona nuku u kujdes farë si njeri, “për na ndihmuar se kishte detyrë, e “neve jemi aqë të perplasur nga lufta sa “skemi fytyrë njeriu dhe nga valet e “detit Jone”.

Shejténia e ti Papa Paolo II, kur digjoi vojtjet e popullit Shqipëtar, shumë u helmua. E tue me forcuar me thënë fjalë të mira i kishilloj tue me shkuarnë Napoli për me ba në zëmër popullin, se ajy donte te përkuideset e të përdëronjë të tërë fuqine e ti për te ju ndihmuar popullit Shqipetar. Ghjni i karaqur me paresin shkoi prapë në Napoli.

Papa Paolo II i shkruati Mbretit Francës, dhe Imperatorit Spanjës, për të kishelluar Ferrantin ng'Aragona për të dhënë ndihmën të nivoshme Shqipëtarëvet, e tue më veshur Ghjn Kastriotin me Dukatin të Sh. Petro Galatina, cilin e kishe pasur dhurat Ati i ti Skënderbeu. Mbret Ferranti pa kënaqesi e volëntet, po i shtrënguar prej Papës e nga Princët Kristiane, ndihmoj Shqipëtarët, dhe tue me dhën Ghjn Kastriotin fortësen Kastel Nuovo, edhe Dukatin te Sh. Petro Galatina.



## K R Y E V.

## THEMELIM' I KOLLONIVET.

Għjni Kastrioti si mori pushtim' e Kastello Nuovo cili kastel vet-ċem em-ċem kish iri, e pastaj ishte njē fortēse shumē e vjetrē edhe e prishur. Ghini ndreqi, e ngriti kastellin dhe qiti kater pirge, (torre) Edhe nga pirget vuri shenjat e shtepise Kastrioti. Brenda ne kastel ngriti dhe njē kishe, ne e cila u varos pas vdekjes. (1)

Mbreti Ferranti ng'Aragona, nga frika e këtire trimiex luftetar, nukè desh me lènē Shqipetarët pér me rojtur bashké, mos këta njē ditē munt tē bëneshin tē fortē, e munt me rezuar atē nga throni. E pér këtē gie urdhéroj, e shtrengoj Shqipetaret, pér me i përdar me shumē vise tē mbretērisé.

Ashtu miaſt' Shqipetarë shkuan nē siċili, cilet themelu këta katunde.

Gjergj Mirespia me shoket e ti themelōj, Palazzon Adriano. Paolo Manes me tē tjerē shoke themelu, Mezzojusso. (2) Dispoti Černovič, me te tjerē themelōj, Sh. Angelo Muxuro, Ilia Mallisi, Petro Pravata, Petro Kuċċia, e Mu-saqia, themelu Piana dei Greci, e prej ketire me vonē qe themelu fshati i Sh. Kristina Gela. (3) Katundi Kontesa Entelina kishte qenē i themelu qē mē parē nga ushteria e Skenderbëut qē kish mibetur nēn urdherin e gjenerallit Basta, bashké me gjenerallin Ghjni Stresio i nipi i Skenderbëut.

Għjni Kastrioti me shumicen e Shqipetarëvet qē u mbet, u perda ne Napoli nē Kosenze, ne Kalabri, edhe nē Puglie. (Pulje).

Istoriani Zoti Tajani, i cili shkrojti njē istori mbi Shqipetarët, shkruan e thot se themelimi i kollonivet tē Shqipetarëvet, ardhi nē kohēn e vitevet qe miex 1467-1471.

Kenek keta: Sh. Elena, Kroce di Mi-

għiano, (Miljano) e kolle del Lauro nē Molise, Sh. Demetrio Korone, Maqja, Vakarizzo Albanese, Sh. Kosmo Albanese, Sh. Gjorgjo, e Spezzano Albanese. Nē 1473-1474, qenē themelu fħarrat, Faggiano, Martinjano, Monteposano, Roka Forzata, Sh. Gjorgjo pērposh Taranto, Sh. Martino, Sh. Marzano, Sternazia e Zollino ne dhee d'Otranto, Kaselvequio, Kaselnuovo, Panni, Greċi, Sh. Paolo, nè Kapitanata.

Nē 1476-1478 u themelu, Lungro, Firmo, Akuaformosa, Kastroreggio, Kavallerizo, Cərzeto, Civita, Falkonara, Frashinet, Perçile, Sh. Basilio, Sh. Benedetto Ullano, Sh. Katerina, Sh. Giakkamo Albanese, Sh. Lorenzo, Sh. Martino, Sh. Sofia d'Epiro, Serra di Leo, Marsi, Cervikati, Farneta, Mongrasano, Platani, Rota Greka.

Mē 1534 Shqipetarët e Koronit nē More, si ra Qyteti i tyre nē dorē tē armikut, Lipen ndihmē e nembbredit tē Napolit, Don Petro de Toledo, i cili i ndihmmoj duke me dérguar 200 anie tē cilat shkuan nē limanet tē Shqipetarët pér me ndihmuar e marrē Shqipetarët tē cilēt i ngarkuan nē aniet dhe i shpune nē Itali.

Disa prej këtire Shqipetarëve vanē e u bashkuu me véllezérit tē tyre e kolloni revet, tē Barrile, Maskite, Sh. Konstantino Albanese, Sh. Paolo Albanese, Brindisi della Montaja ne Provinca Basilikata, e ne Farneta ne Provinca te Kosenza.

Mē 1680 emigruan dhe tē tjerē Shqipetarë, tē cilēt themelu dhe këto kolloni. Ururi, Portokanone, Kampo Marino, Monteċiżfona, ne Provinca e Kam-pobasso e Kieti nē Provincie tē Puglia. (Pulja).

Mē 1744 dukē me mbretēruar nē Na-



poli Karlo III, prej familjes mbretaro re tē Borbone. Dhe tē tjerē Shqipētare emigruan kryesuar prej tre Prifterinj tē cilēt patin dhurat vendin Villa Badessa, cili ishte propietet tē Dukevet Farnesi di Parma. E atje themeluan fshatin Vil-

la Badessa. Emigrasiona e fundit tē Shqipētarëvet qe nē kohē qe mbretēronte mbret Ferdinandi IV, këta Shqipētare vanë e qëndruan nē Brindisi e nē nisia Lipari. (4)

## SHËNIME.

(1) Nē kishë tē Kastel Nuovo, ndodhet edhe sot i bukuri monëment tē Princit Shqipetar Ghjni Kastriotit, prej mermëri, rrrotluar prej katër kollona prej guri tē hole, edhe me pesë llamba qe ndizen gjithë monë. Mbi murin shëkonet piktyra me fytyren e ti. Kyçin e kishës e mban një Prift Shqipetar nga Fea Orthodokse cili ron nē Qyteti Napoli.

(2) Nē një librë i botuar prej Arçipristit at Onofrio Bukola, nē Palermo ne 1909, mbi kollonin Shqipētare te Katundit Mezzojuso, thotë se qe themeluari prej vëllezërvet Gjergj dhe Vasili Reres, tē bijet' e tē parit Gjeneral Shqipētar Demetrio Reres, te cilet shkuan nē Siqili më 1448-49 pas qe Ati i tyre Dimitri qe i emëruar Governor i Kalabris tē poshtëme, nka Mbret Alfonso ng'Aragona.

Marriëm dhe prej librës te At Bukola, pér vertëtimit a qendrimin e Shqipētarëvet, per me thimuluari kollonit, dy diploma, tē përhapëra pér më ndihmuar Shqipētarët, prej Mbretërevet Alfonso d'Aragona, e Giovanni I i Kastilja. Zedhenie dhën nē ditat 8 e 18 Tetorit 1467.

"Neve Gjovanni pér hir-in te Zotit "Mbret t'Aragonesëvet, te Siçilis, e te "Xhjerësalem, e tē Valenzës.

"Me letra e tē Shkëlqemit Mbret jonë "Ferdinandi i Napolit, nipi jinë kenë "neve rakomanduar, Nikola Bidera La-skari, dhe Kostantino Masaraqia Ka-

"striota, Princira t'Epirt e tē Shqipēris, Kapedan trima kuntra Turqevet "prej një gjaku me Gjergin Masaraqia "Kastriota Skënderbeu, dhe bashke me "tyere ushtarë, pak vjete përparrë ardhur "prej Shqiperie.

"Shumë teprë u përderuan pér me "mprojtur Mbretërin tone te Siçilis "s'edhe tē Mbretërin e Napolit, kuntra "haries në token jone te Gallevet e tē "Angioinëvet.

"Tashi qe Shqipëria dhe Epiri qe in- "vachuar prej Turqevet, tē thënët Ni- "ko'lë e Kostantino kan ardhur nē Mbret- "ëria jonë me dy sa kolonira, te ku "mëntohen pér më tē rrojtur.

"Pér këtë gje ne' tē shikurtë se kanë "drejtësi, miresi, urtesi, dhe trimeri, dhe "janë tē Fese Katolike, dhe me konsi- "deruar tē madhen Bujri e tyre, etj.

"Dhën nē Baçelona me 8 Totorit 1467.

"Ne' Gjovanni, pér hir-in tē Zotit "Mbret t'Aragonesëvet, tē Siçilis, Xhje- "rësalem, e tē Valenzës.

"Me anë tē Shkëlqesë e ty Mbret "Ferdinandi i Napolit, nipi jione, nē "neve kenë rakomanduar Petro Ema- "nuele de Pravata, Zakaria Kroppe, Pe- "tro Kuçja, e Paolo Manisi, Pujarë "Epirot Shqipētare, Kapedan trima kun- "tra Turqëvet, e prej një gjaku me tē "dritësuamin e tē pa mundurin Kapedan "trimë Gjergin Kastriota Skender-beu, "Prince i Epirt e tē Shqipëris, s'edhe "pér se bashkë ndodhen dhe tjerë Bu-

"jare Shqipëtarë, cillet kan ardhur e kan "shkuar në Mbretëria jonë të Siçilis, "bashkë me tjera kollonira me të cillat "a tje dot mbeten.

"Për këtë gje neve të shikurtë se janë "te Fese Katolike, dhe njersh me dre-

"thëna Mbretëri jonë, janë të lirë për "tërë pagesat, rëndesi, voshni, të sotmet "dhe të ardhëmet, si edhe për tërë rrojtie "e tyre, shpeshejal të thënë Pravata "Groppa."

"Kuççia e Manisi, s'edhe shumë të




Shqipetare prej katundit Vakarizzo-Albanese Kalabri

"jtësi, mirësi, urtesi, trimeri, në tue "përnjohur varferin e tyre për se tërë "pasurin e tyre e kanë lënë në duartë "e Turqëvet të keqë.

"Pa marrë Mëndimin e këshillit "Mbretëror, Urdhurojem e solugjoem "se tër Bujarët Epirot Shqipëtare, ar- "dhur për miresi për me shtrehë në e

"tjerë që dëftojën Bujarin e tyre.

"Urdhurojemi për këtë qëlimë tërë "Zyrtarët, të Mbretëris jonë si të me- "dhenjë edhe me të vegjël, për të sotmit "edhe për të ardhurite që dot jenë për "gjithë kohën, shpeshial Bujarit Mjesh- "tre i Gqikatës, s'edhe Luogotenentit e "tje, Gjikatëvet e te Madhies Kurie



"Mbretërorë, edhe Mjeshtereve Razional, Avvokatëvet, Prokuraturëvet fiskale, Xheneralit Arketar e dhe të Grejtë "sohet për prevelegjet tona Mbretërorë, "që të jaipiën, për me mbar mirë, e tue "me përknjohur, të lirishtë të për thënët Epirote Shqipëtare, që rrojën në "Mbretëria jonë për se bashkë me familjet tyre, cillët janë shkruar në Zyra "e të thënës Gjikatore, të pasuris Mbretërejonë, dhe të i bujën gostitie, e "me kuitua për heqjen, prej të gjithesvet "pagesavet edhe rëndimëvet, për tërë "motin e rrojties tyre, për me grejtur "prej varferisë e tyre, dhe nga të tjera "satzeza, e duam dhe urdhurojën të "mos me vatur kuntra nënë fajin të "idhunimit e Mbretërisë jonë.

"Dhën në Barcelona me 18 Tetorit 1467".

Shtu pas kërkimëvet e Atë Buëola, Mezzojuso qe the mëluar me 1449 e jo si thone te tjere autore, cilet e vune ne kohen 1488-1501.

(3) Këto kollonira sipër të shënuara, qenë themëluar në kohë që vete më 1481-1488 e ne gjithe ajo kohe qene themëluar katundet Sh. Mikele, dhe Bronte. e Biankavilla, ne Provinca te Katania.

Albanofili Komendantori E. Portal, shkruan një biografi mbi katundin Biankavilla, cili ishte edhe katundi i lindjes e ti. Pas kerkimevet qe buri nxori në dritë se Biankavilla qe themeluari prej komandarit Shqipetar Cesare Masi me shoket e ti ne 1488.

(4) Në emigrazione e fundit shumë tjerë Shqipëtarë vanë e qendruan në nisitë Malta, e Lipari.

## KRYE VI.

### LISI GENEOLOGIK I FAMILIES KASTRIOTA.

Familja Kastriota filon që me shekulin XIV me kryeparë, Kostantino pern-johur më mirë mbi emërin Masareqio, cili pati dy bij, Gjergjn, e Bernardin.

Nga Gjergj u linte Ghjni, prej Ghjnit martuar me Vojsavën, bijë te nj Zotën prej Tribali, u linte, Reposhio, Stanisi, Kostantini, e Gjergj për thënë Skënder-beu. Edhe vashat, Maria, Gjela, Angelina, Vllaika, e Mamiza.

Nga Gjergj Kastriota Skënder-beu, martuar me Princesen Donika e bija e te fuqishmit Prince Arianite Golemi Komneno Thopia, u linte, Ghjni, dhe vajza Vojsava.

Nga Ghjni i martuar me një prej të bijat e Lazzaro Brankovitz. U linte, Ferrante, Gjergj, e Kostantino, cili qe Piskop d'Isernia. Vashat, Elena, e Maria.

Nga Ferranti Markese te Civita Sh.

Angelo, martuar me një pe të bijat e Bonifacio Acquaviva Duka di Nardo, u linte. Akile, Federiko, Porzia, Alfonso, Ferranti, Cesare, Paolo, Ghjni Markese nga Kastiljone, Kumandanti i fortecavet të kastellëvet të Qytetit Bari, e Governor i ushterisë të asajë Provincë. Vasha, Giovanna, Andronika, Irene, cila u martua me Princin Italian Don Pietro Antonino Sanseverino Principe di Bisinjano. Kio martesë qe një ndihme e madhe për Shqipëtarët përsë Princi ish fort'i pasur.

Nga Akile, u linte Pirro, e Kostantini.

Nga Pirro ne 1659 u linte, Antonio, Filipo, edhe vajza Beatriçë.

Nga Antonio u linte, Akile, Kostantino, Gjergji, edhe një vajzë Rina.

Nga Akile u linte, Ghjni, Tomaso, Antonio, Ipolito, edhe vashat, Marga-

rita, Viktoria, Giulja, Doniken, Teresa, Ngjelen.

Nga Antonio, u l'intne, Akile, Gjergi, Angelo, e vashat, Anna, Viktoria, dhe Elena.

Nga Gjergi më 1706 u l'intnë, Ferranti, Antonio, Pirro, dhe vashat Anna, Gjovana, Maria Rosa, Kamilla, e më vonë pastaj më 1724, u l'intne, Maria, cila me 1749 vate nuse me Princin Spanjol Don Gjovani d'Aladro. Nga qio martese ne 1751 u l'intne tjatre Don Gjovani, e pastsj nga ky më vonë më 1845 u l'intnë i Shkelqieri Prince Don Gjovani d'Aladro Kastriota cili mjaft punoj e drithësoi çeshtjen e Shqipërisë.

Nga Ferranti u l'intnë Filipo, Antonio, e Gjergj, dhe vashat, Françeska, e Maria Luisa.

Nga Antonio, u l'intnë, Gjovani, e vashat Elena, Maria Rosa, e Maria.

E më në funt nga Gjovani, u l'intnë, Manuele, e Françesko. Dhe gjer ketu jepë funt Lisi geonologik e degës mashkulore të familjes Kastriota.

(1) Mburimet geonologike të familijs Kastriota i kam marre, prej Kërkimevet e Prof. Giuseppe Sqirò, dhe Antonio Skura.

## KRYE VII.

### REGIMENTA MBRETERORE MAQEDHON (1)

Historia e Mbretërise Napolit ishtë miaft' e mbushur me veprat trimërere të ushterisë Shqipëtare. E para ushteri qe filuar në shekulli XV më Regimentin t' emëruar për nder Mbretërer Maqedhon; e pastaj më vonë me emrin Reale Albanese. I pari regimentë qe filuar me ushterin Shqipëtare qe mbeti nënë urdhërin e Ghjnit-Stresio nipi i Skënder-beut, pas që ky shkoj në Shqipëri.

Ushteria Shqipëtare kur do herë, qe urdhuruar me kapedanë të dëgjuar, si Dhimitri Kepucëmadhi e Kuqiari, Theodoro Biskari, e shumë të tjera, cilët dhanë shërbimet e tyre nën Imperatorin të Spanjes.

Më parë se tue me hijur në kohërat e shekullit XV për me përkuituar trimërin të cilet ndihmuani Suvranerat e Napolit, kundra invadorëvet të huaje, si dhe kryegritjet nga më të fyqishmit e vendit.


N'a to kohë dy gjera rodhënë në metropoli, cilat me diftuar më afrë e për

me njohur miresin dhe qëndriniin, e ushterisë Shqipëtare për shërbimin të asaj mbretërie, dhe për të mbajtur mënt, në Kisha e Rityt Greke-Ortodosë të Sh. Petro e Paulit, të ati kryeqyteti, (Napoli) gjendet një gur vari, me këto shkronja.

"Këtu prëhen Kapedanët e Kompanisë, të treqintëve Kallorëvet, emeruar "Stradiot" të cilet urdheruar në kjo Mbretëri për me i dhënë kurora shtepisë mbretërore të Spanjesë te qëaturin Kapedan Shqipëtar, në vitin 1608.

Në kohë të nën Mbretit të Napolit Don Giovanni Alfonso Pimentel D'Errera Konte i Bonavante, ardhı kompania e treqintëvet kallorë, kryesuar prej Kapedanit Cesare Masi, të cilët hynë në tokë Partenopes me flamuret e tyre. (2)

Ato kohë ishën të përmëndëshme përsë, në Spanjë Mbretëronte Filippi III, i biri të famëshmit Filippit II, të cilin kur vdik Katolikëtë e quajtin një Salomon, dhe Protestantët një Tiberio. Që në ato kohë nën mbreti i Napolit



Konte Bonavante, dha urdherin për të prishur kallan e Durezit në Shqiperi përsë thështe se ajo ishte fole pej kusarësh të cilët shkrebtonin breget dejtore të Mbretërise.

Në viti 1647 Mbretëroj në Spanjë Filippi IV i 28 Mbret i Napolit, mbretëroj si nën Mbret i saje. Si u rezua qevëria e Don Rodriko Pons de Leon Duka d'Arkos, ardhi e famëshmja kryegritje popullore me 7 të Korrikut, emeruar kryegritja e Masaniellos. (3)

Populli i egërsuar, marshoj kundra palatit mbretëror, i cili nën mbret pati restrain same ikur e me mbyllur më një Kovent (Monastir). Po populli e kuptoj që nën mbreti ndodheshë në konvent, dhe ekapi atje. Po nje kapedan Shqipetar prej regimentës mbretërore Albanese, me trimërin' e madhe qëndroj përra derës me kordhë në dorë, dhe mbajti popullin lark, me gjith që ish dhe i plagosur, mbeti burrisht gjer sa ardhi fuqia e madhe e ushterisë. Mbreti me pastaj, e nderoj kapedanin per trimerine shume.

Janë për të kujtuar shërbimet qe dha Regimeta Reale Albanese e cila ndodhesh nën kryesin e sundimetarit Gjergj Karafa, në luftën e 10 Gushtit, 1744, në Velletri, ku Mbret Karlo III bashkuar me Mbretin Ferdinand I te Borbonit, i cili qe shtrënguar nga Austria dhe Anglia për të bashkuar për më luftuar ushterinë Franceze, e cila kish zbritur rë Itali.

Ushteria Shqipëtare qe ndare me dy regimenta, një Reale Maqedhen, e jatra Reale Albanese.

Me 1798 ushteria Shqipëtare qe dërguar në nisia Ponza, pe në det u poq me dy anie kusarake të cilat ishin armatosura me topa. Po Shqipëtarët luftuan me trimëri, dhe mjeshtëri të madhe, gjer sa fituan luftën pa humbasur as një nga të tyret.

Me 22 Tetorit, 1798, një shumesë shqipëtarësh u dërguan në Romë, dhe te cilet muartin Pjesë në rrëthimin të Ankonës nën komanden e Gjeneralit Fralih, i cili shtrëngëj ushterin Franceze kryesuar prej Gjeneralit Monier.

Në Civita Kastellana, Shqipëtarët shtrënguan Francezët mos me këputur mosmarëveshjet e aliatevet në ujerat e Civitavekia.

Në e madhja luftë e ushterisë Napolitane, kryesuar prej Gjeneralit Championet, kundra Francezëvet, me 8 të Kollazekut 1799, ushteria Shqipetare trëgoj trimëri të madhe tue më prishur ushterin Franceze, e me marë sklevë 10 zyrtare bashkë me kolonelin Arnaud, dhe flamurin e injedhushtarit. (Taborit).

Historia e Mbretëris te dy Sicilive, (4) ishte miaft e mbushur me vepra trimërore të ushterisë Shqipëtare. Regimeta e fundit qe zgjidhur nga mbret Ferdinand di Borbone me 4 të Korrikut 1820, dhe i cili ishte dhe fundi i ushteris Shqipetare.

### *Shenime.*

(1) Në një ditar gjënder në mestrë të kartëvet e Zotit Nikola Dassi bujar Epirot, qënë marre e botuar pët të parën herë të parat lajmë në Korfus në 1843 mbi regimentën Mbretërorë Albanese. Zoti Nikola Dassi qe Officer i të fundemtit Regimentë.

(2) Partenopea (Republikë Napolitane) cila ashtu qe thirrur nga Republika Franceze, nga shkaku se ajo qe i pari

emer i Qytetit Napoli. Kjo Republike umbet qe ne kohë 23 te Kollazekut njer me 4 te Gushtit 1799.

(3) Masaniello (o Aniello Tomaso) qe një i famëshme peshkëshitur, lindur në Qyteti Amalfi, qe kryetari të nje kryegritje prej popullit të Napolit kundra nën Mbretit Spanjol Duka d'Arkos në 1647.

(Shko numerin i tretë)

(4) Në 1605 Theodhoro Reres prej Katundit Shqipë i Siçilis, Mezzojuso, që emëruar Kapedan, me pasur nën urdhurimin 452 ushtarë Shqipëtarë, dhe kishte të bjtë Lukën e Andren, njeri flamëritar, e jatri Sergente, nën shërbimet e

Notot, zëdhënie prej të Shkëlqiemit Zottit Giovanni Lanuzza, nën-mbret të Qytetit Katania, dhe përpëra të i nderçimit Kapedan Gjeneral Giovanni Iambas bashkë me offiserët e tijë, në me shënuar Shqipëtarët të gjith Mbretëris e Siçilis,



### At FELICE SAMUELE RODOTA

Themelonjesi i Rollegjit Italo-Albanese ne Shen Benedetto Ullano.


kurorës mbretërore në Qyteti Lentini (Siçili) pjacë fortëcë të Fushes e Qytetit Noto, te ku bën trimëri të pa vdekura, si shkonet prej një zëdhënic e Senatit të Qytetit Lentini, dhënë më 4 Tetorit 1667.

#### Zëdhënie

Ishtë për të djitur se në regjistri (tëfter) në cili janë shënuar tërë ushtarët e Viletit, që ardhën për shërbimet ushturiakë në moti 1605, i bur në ki Qytet i Lentinit, piacë të armëvet e fushës të

jan për me shënuar më teprë Theodhoro Reres, Shqipëtar prej katundit Mezzojuso, Kapëdan të 452 Shqipëtarë dhe ushtarë të kë sajë mbretëri, bashkë me flamëritarin e sergjentin Luka e Andrea Reres, të bjtë e tijë. Me pagesën prej të Kortës (Konak) Mbretërore,

Et in testimonium veritatis praesentem fidem, mea manu feci et sigillavi cum solito sigillo illustrissimi Senatus Urbis Leonti 4 ottobre 1667. D. Sebastiano Baelico Coriero Magistro Notaro.



## KRYE VIII.

## QËNDRIMET E SHQIPËTARËVET

Si themeluan katundet Shqipëtarët lipun lejë nga Papa për me ngritur Kisha, e për me meshuar në Fen etyre Ortodoxe. Papa dha urdhur Piskopëvet Katolikë për me ndihmuar e mos me tra-zuar Shqipëtarët. Po nga shkak' i pakësisë të Priftërinjëvet e mos me patur kollegje për të bërë dhe tjerë, shumë kollonira muarën dhe përdorën Priftërinjë Katolik. Dhe nga nivoja Sqipëtarët ishin të shtrënguar për me dërguar djemtë në shkollë të Katolikëvet. Po kur Papa Gregori VIII hapi në Romë më 1574 Kollegjin e Shën. Thanasit për të mbledhur djemtë Grekë të për ndare, undha edhe lejë Shqipëtarëvet për të marë mësimet në aj Kollegjë. Dhe kesisoj shumë djema të rinj prej Shqipëtarëvet të Kalabris, edhe të Sicilis. Shkuan në Romë për me marë mësimë për me bërë Priftërinjë.

Më 1597 Zoti Nikola Matranga nga Katundi Shqipë i Sicilis, Piana dei Greçi (1) në Provinca të Palermës, kërkoj dhe lipi leje nga Piskopi i Monrealit cili kishte urdherin të a tyre vise, për

me ngritur në Piana dei Greçi një Monastir edhe një Kishë, për me vunë kallogjerë. Piskopi i Monrealit ish Ludo-viko II Torres, cili me kanaqesi udha lejë për me bërë Monastirin.

Kisha bashkë me Monastirin, u vun në vepërim 1598, edhe ubitisën në 1619, dhe u emeruan Shën Kola Tolentino di Bari.

Andrea Reres nga Mezzojuso (2) ngritti një Monastir Basilian më 1617 për me vun kallogjerë, nga Riti i Fese Greko-Ortodoxe të Shën Vasilit, cilët kishën edhe për të dhënë mësimë djel-mërisë Shqipëtare. (3)

Të parët kallogjer, u muar nga nisia (Kandia). Kallogjerët ishen Kryesuar nga At Don Zeremia Shkudili, cili me diturin e urtësin e tii idha famë të madhe Monastirit. Edhë në Kalabri punonin Shqipëtarët për me dalë nga erësia, edhë themuluan Abasi, si në Shën Benedetto Ullano, në Shën Demetrio Korone ngritën Monastirin Basilian, me emërimin Shën Adriano, si dhe më shumë të tjerë vende.

*Shenime*

(1) Piana dei Greçi (Fusha e Grekëvet) populli Palermëtan, thirri përgabim të parët Shqipëtarë nga shkaku se ishin veshur me robat Shqipëtare, emë teprë prej Fesë Greke-Ortodoxe që përdërojnë.

(2) Andrea Reres ishte një nga trashingimtarët të parit Gjeneral Shqipëtarë që shkoj në Itali, Dimitri Reres.

(3) Në ky Monastir muartin mësimet, dy të famshë, dhe te dygjuar misionarë të asajë kohëje, që të dy lindur në katundi Shqipë i Sicilis Piana dei Greçi, këta dy qënë Misionarë dhe Piskopë në Chamari (Shqipëri).

Më përpëra qe At Vasili Matranga, cili më përpëra se të shkojë në Chameri, ishte imësonjësë i Monastirit.

Po në një 1690 kollonia e Pianës dei Greçi pati gëximin të lindejë, prej Zötëivet Gjergj dhe Lena Sqirò një foshnjë cilit i vun emër Giuseppe.

Ky dialë që në vogëli rëfej mëndje hapur, me urtesi, drejtësi, dashuri përkombin e për Fen. Prindërat tue përn-johur virtutat të nalta, e dashurin përfen Kristiane, e shpun për me pasur mësimet e parë prej Shejtarit At Gjergj Guzzetta, cili e mori me dashuri të madhe i dha mësimet, po me shkuar mënd-



jen e lartë të djalit kishilloj prindërat për me dërguar në mësimet të lartë.

Giuseppe Sqirò që në djaleri mveshi robat kalogjeri, dhe pas që shkoj në Monastiri Basilian të katundit Mezzojuso, te ku gjeti bashkë katundarin e tijë At Vasil Matranga, prej cilit mori tjer mësimë.

Po pas ca kohë At Vasil Matranga qe thirrë për me shkuar në misiona e Chameris (Shqiperi). Cili mori barrën me zëmër përsë ishte në mestrë të Kombit i tijë, pas pakë vjet që ishte në Shqipëri, prej punës vëllezërore, e dashurie përbajtjor në populli, qe grutur në Lartja Zyrë Piskopale të Okrida.

Po pas që hipi në Zyrë Piskopale, deshi dhe thirri zënesin, e katundarin e tjë At Giuseppe Sqirò.

Po ki më 1710 kishte shkuar për me marë mësimet teologjike të fundit në kollegj i Shën Tanasit në Rome. Atje mori 6 vjet mësimë, e pran shkoj për me bashkuar, bashkë-katundarin etijë për me ndihmuar ne ajo Zyrë Shejte të Chamari.

Hiresia e tjë Piskopi Vasil Matranga, tue me rën i sëmër, pas 4 vjetë që kishte mbetër at Giuseppe Sqirò, deshi më shkuar në Itali, tue me doresuar Zyrën Piskopale në dorë të At Giuseppe Sqirò.

Zëvendesi i Piskopatës pas pak kohë, tue me shkuar shpirtëmadhësin, miresin drejtësin, dashurin, për popullin e komfertuan në e Lartmja Zyrë, ne cila u mbete 24 vjetë.

## KRYE IX.

### KOLLEGJ ITALO-GREKO SHQIPETAR.

U lipsëshin Shqipëtarëvet, pas qëndrimit edhe të themëluarit të katundëve edhe kishat në Fenë etyre, një vent ku muntnin të mirnin mësimet. Vërtet që Papa ju kish dhënë lejë për të vajtur në Romë në Kollegji Shen Tanasit. Po nga largësia dhe arxhët të tepra të udhëtimit, trazojë shumë Shqipëtarët, e më tepër ata të Sicilis, cilët shumë mëntonjeshin si munt ti ipnin funt kesaj çështje të rëndë.

Por për të sgjedhur e drithesuar çështien, për me dalë prej erësis, doli shpirtëmadhi At Gjergj Guzzetta (1) nga katundi Piana dei Greçi, cili me diturin e fortë që kishte, ishte inderuar nga Mbreti, si dhe prej tërë paresis e Qytetit Palermos cila atdhuronte.

Populi Palermitan kur At Gjergj Guzzetta shkonte në prej udhëvet, i falej me një nderim të math, nga mirësia, dhe dashuria, që At Gjergj kishte për populin e varfër, populli nga që kishte prej

At Gjergjit, e njinte për një burrë i shejtë dhe aduronte. Dhe ishte për të atdhuruar me të vërtet, për se dy gjera shenjtore kish në mendja At Gjergji. Perendinë edhe Shqipërin.

At Gjergji Guzzetta, pas shumë kundreshtime që pati me Qevërine e vendit, pati dhënë lejë për me themeluar një kollegj, të njojur nga Qevëria, e nën urdherim e Pishkopit të vendit. Kollegji u hap me parat e tia në Palermo, me 30 te Vjeshtes III 1730 me emérin (Kollegji Italo-Greko-Albanese).

Në ky kollegje doli drita, dituria, dhe atje nuartin mësimet më të dëgjuarit Shqipëtarë, cilet përhapën në botë letetraturën, a flakën atdhesore për Shqipërin.

Pastaj më vonë At Gjergji hapi një Monastir për vashat Shqipëtarka, në katundi Piana dei Greçi, ky Monastir ishtë dhe sot, ky Monastir kaqënë dhe ishtë vatra e përbajtjes të gjuhës, e zhakonëvet Shqipëtarë në Sicili.



Pas vdekies e At Gjergjit Guzzetta, redaksin e Kollegjit e mori At Kola Ketta (2) nga katundi Kontessa Entellina, edhe ky shpirt math, me parat e veta madhoj dhe sbukurej e dha një përparim më i madh Kollegjit. Njatrë çestie mbe-tejë e rëndë, cilla ish ajo e djemtëve Shqipëtarë që ishën për të burë Prifterinj, cilët lipseshën për me shkuar në Shën Benedeto Ullano në Kalabri, për me marrë urdherin-Sheetë, nga Pishkopi Greko-Shquipëtar të atij vendi.

At Kola Ketta krahuruar nga të tjer Shqipëtare, kerkoj nga Papa për me ngritur edhe në Palermo, një selie-Shejte. Ashtu pas tridhjete vjetë lutie e kërkime Papa idha të drejtat, tue me thirë për me shumë shiguruar direktorësin e Kollegjit At Gjergjin Stassi, prej katundi Piana dei Greçi, për me griejtur në Palermo Zyrën Pishkopale. Kësisoj At Gjergji Stassi, që emëruar Pishkopë më 1782 me titulin Veskovo di Lampsako. (3)

### *Shënimë*

(1) At Gjergji Guzzetta presentoj ne 1767 nën-mbretit Don Giovanni Fogliani d'Aragona Markese di Pellegrino, Qevëritari i Siçilis në Palermo. Nje histori mbi Mbretërin e Shqiperis edhe të drejtat që kishin mbretërat e dy Siçilivet, për me veshur me titulin si Mbret të Shqipërisë.

(2) At Kola Ketta shkruati dhe botoj një fjaletë Italo-Shqipë. Ky fjalëtor qe një nga më të parit që u panë në Itali.

(3) Kronologja e Pishkopëvet Shqi-

pëtare të Siçilis, me Zyre-Shejte në Qyteti Palermo, fillon me At Gjergjin Stassi, prej kaundit Piana dei Greçi, cili qe emëruar Pishkopë më 1782 dhe u mbet gjer në 1801. At Gjergji Guzzetta, cili qe zgjedhur në 1813. At Françesko Kiarriko më 1834; At Gjuseppe Krispi më 1854; At Agostino Franko, Pishkopë i Ermopolit më 1877; at Gjuseppe Mari Pishkopë të Tempe më 1878 gjer ne 1903; At Paolo Shqirò cili qe zgjedhur në 1904 më emërin Pishkopë di Benda

### K R Y E X.

#### KOLLEGJ SHEN ADRIANO.

Edhe në Kalabri filonin për me punuar, për me hapur një shkollë për të marrë mësimet djemtë Shqipëtarë. I pari që mori fillimin qe prifti At Stefan Rodota prej familjës Koronei, lindur në Shën Benedetto Ullano.

At Stefan Rodota kishte marrë mësimet në kollegji të Shën Thanasit në Romë, e pas si u këtheu në katund' i tij, shëkoi se atdhetarët e tijë ishën në një errësirë teprë të keqe nga arësimi, dhe mëntohejë se kishën nëvojë të madhe për të hapur një shkollë për të marrë mësimet të duhur.

Për këtë gje shkoj në Romë, për me

vatur ju lutar Papës, cilli ishte Klementi XI nga familja Albani, prej farë Shqipëtare. At Stefani bisidoj çështjen me Papën, dhe ju dha funt për me hapur shkollën në palasi të Abacisë në Shën Benedetto Ullano. Po praktikat vanë shumë gjatë edhe Papa Klementi XI vdiq në mes të praktikave.

Pas vdekies e Klementit XI, ungjitet, Papa Innoçenzo XIII, e pas këti Papa Benedeto XIII, pa ju dhënë funt çësh-tijes. Po përgjqtur në e lartja zire Klementi XII nga familja Korsini, e prej mëmë Shqipëtare e ortake i mësimëvet të Shqipëtarit, At Feliçe Samuele Ro-

dota, i cili ishte i vellaj i At Stefanit.

Feliç Rodota, kur msovi se miku i gushtë i ti, kishte hipur në e lartmija zyrë, mëntoj se ardhi koha për të mbushur dëshirat e Shqipëtarëvet, për me të hapur një shkollë. Eshtë Feliç Samuele Rodota, me shpejtësi shkoj në Romë, teku vate ju lutë Papës për me ju dhënë lejë për me hapur një shkollë për të

nga Kardinali Karaffa. Kollegj qe emëruar për nder të Papës, cili rëfej miresin e tji për Shqipëtarët, (Kollegjo Italo-Greko-Korsini). At Feliç S. Rodota, qe më von gritur në Silia-Shejte, Pishkopale me emërin Pishkopë i Brerës, edhe bashku pati dhënë tërë drejtimin e kollegjit. Papa Klementi XII prej mëmë shqipëtare, i dhuroj dhe i lidhi kollegjit



Kollegji Italo-Shqipe, i vjetre ne Shen Benedetto Ullano.


dhënë mësimë djelmërisë Shqipëtare. Papa fortë i dhëmbër nga lutjet, e Rodo-tait, e siguroj se dote përdorte tërë influencen eti për me ujdisur dëshirat e njérëzisë Shqipëtare.

Felice S. Rodota shumë teprë i kana-qyr, edhe i gëzuar, u kthyen në katundin. Papa mbajti fjalën e nderit, e pas praktikavet kanunore të Kishës Katolike, i dha-lejë për me hapur shkollën.

E keshtu pas urdherit, At Feliç S. Rodota, me 5 të vjeshtës II 1732 u hap Kollegj, në palasi i Abacisë të Shen Benedetto Ullano, dhuruar me tërë kofshin

gjashte mijë skudhë (1), dhe me kohë Hjresia etje Feliç Rodota, prapë kërkoj ndihma të tjera prej Papes, cili prapë e ndihmoj tue me lidhur tjera gjashtë mijë skudhe. Edne tjera ndihma mblodhi prej të pasurit Shqipëtarë e shtu pasuria e kollegjit mjastë u madhuia tue me jarën shtatëdhjetë mijë franka Italiane në motë. Edhe Katoliku Mbret Ferdinand i fali Kollegjin, me pasur liri të pllojtë, e tue me hequr prej tërë pagesëvot kanunore të qeverisë.

Hjresia e tjë Felice Samuele Rodota, vdiq me 12 të vjeshtit II 1740, tue me



lidhur me dhjatë Kollegjit tërë pasurin e tjë bashkë me argjenterin, librerinë, e tërë vesh-madhjet e priftelikut.

Pas vdekies e Rodotait, u hip në kryesi të kollegjit, At Kola De Markis nga Lungro, Pishkopë i Nemesi, cili mjaftë vepra miresore buri për me përhapur influencën e kollegjit. Vdiq me hidherim të zënesit në 1756. Pas këtji u hip Imzot Giaçinto Arkiopoli, nga Shën Demetrio Korone, Pishkopë të Galipolit, cili për tetëmedhjetë vjet qevërisi me dashuri e urtesi kollegjin. Në 1792, kryesin e mori Imzot Françesko Bugliari, nga Shënta Sofia d'Epiro, Pishkopë të Tegeste, burre i ditur, dhe teprë i mençme, cili shumëdritësoj me mësimet e tjia të larta kollegjin cili në ato kohë idha famë të madhe jo vetëm në Shqipëtarët, po edhe për tërë Kalabrin.

Hjiresia e tjë Imzot Bugliari kërkoj prej Mbretit tjera ndihma, edhe lejë për meshkuar kollegjin, që nga Shën Benedetto Ullano, në Shën Demetrio Korone.

Mbreti e ndihmoj me të holla, e idha lejë për me shkuar kollegjin në Shën Demetrio Korone. Urdhurimi mbretërorë ardhë më i të Marxit 1794, shtu kollegji u yendos në monastiri të Basilianevët të Shën Adrianit, në Shën Demetrio Korone, edhe shtu Kollegji mori emërin Shën Adriano.

Në Shën Demetrio Korone Kollegji, u-sbukurua, edhe lulezoi shunë teprë, po pas pak motë ardhën kohera të trubëluara me çetat të Kardinalit Ruffo, cili lëftonte për me vënë në thron mbretin Ferdinando. Një prej Atyreve, çeta hyri në Kollegji tue me bërë trazime e me prishur tërë plaçkat. Që tjë çeta shkoj për në Shënta Sofia d'Epiro, tek' u ndodheshë i nderçimi plak Imzot Bugliari, cilin çeta ë vrajë. Kjo e ligë ardhë më 17 të gushit 1799.

Pas ketyre gjera trazimore Kollegji imbeti mbyllur gjer 1807. Po me një të kollozekut të ati viti prapë qevëria dha urdhurin për rihapjen e Kollegjit, tue

me dhënë kryesin priftit at Domeniko Bellushi, nga Frashinet, Profesore i gjuhes Greke, filosof, orator (gojtar) i digjuar, cili pastaj qe bërë Pishkopë të Sinope. Ky ndreqi e zbukuroj, e dritësaj, e përparoj prapë Kollegjin.

Qevërisi me urtësi, e dituri, e miresi, për njëzetepesë vjet, vdiq më 2 të Marxit 1838, tue lënë Shqipëtarët në hidherim, e në zy.

Pas këti u hipë në kryesi, Imzot Gabriele de Markis, nga Lungro, edhe ky Profesorë i greçistes i digjuar, cili vdiq 1842.


Pastaj Kryesia e Kollgjitet shkoj, në duarte e Profesorit Antonio Marqianò, nga Maqia, po nga shkaket e mëntimëvet lirëdashe, qe hequr poshtë nga offisi, e pastaj me vonë në 1848 qe marë e futur në burg.

Zyra e Kollegjit pastaj qe Kryesuar prej Vinçenzo Rodota, po edhe ky qe hequr poshtë prej mëntimëvet lirëdashe.

Mbret Ferdinand II i Borbonit, mar nga inati se tërë shkollarët e Kollegjit ishën me idhera lirëdashe, dha urdhur për me mbyllur, po shqipëtarë, Zoti Giuseppe Bellushi, nga Shën Demetrio Korone, Kishiltar i ngushte i mbretit, ju lut aqë fortë mos më mbyllur Kollegjin, dhe shtu pas lutjevet, e Zotit Bellushi imbeti pushoj nga inati, po me gjith ato, imbeti pak kohë i mbyllur, gjer sa ardhë vdekja e Pishkopit de Markis ne Katundi i lindjes Lungro në 1858.

Pas këtyre gjerave në kryesia e Kollegjit qe thirrë Pishkopi Agostino Franko nga Mezzojuso (Sicili), po ky ishtë një njeri me mëntime të vjetra, dhe nuk buri as një të mirë, jo vet që nuk i dha përparim, po prapësoj Kollegjin. Po Shqipëtarët e vendit tue me shkuar, se Pishkopi Franko nuk' ishte i zoti për me mbar qevërimin a kollegjit, u-mblodhen e protestuan në qeveri për me hequr poshtë Pishkopin Franko, e shtu Pishkopi la Kryesin e shkoj në Napoli.

Qevërimi i Kollegjit ju dha Pishko-



pit katolik të Katudin Italian Rossano.

Po ne 1860 kur hyri qevëria e ree Italiane, lirëdashi Gjeneral Gjuseppe Garibaldi, kishilluar prej Shqipëtarit Pasquale Skura nga Vakarizzo Albanese, ministër i qevërisë provisore në Napoli, Garibaldi hoqi nga duarte i Pishkopit të Rossano sundimin e Kollegjit, e përnjohjen e fitimëvet prurë çësties Kombëtare Italiane Kollegji i dhuroj dymbehdhet mje dukate (2) për me dreqërt Kollegjin. Pastaj thirë për me formuar një komisionë për me qevërisuar Kollegjin.


Komisioni qe formuar prej ketyre zoteri, Kryetar Prof. Antonio Markianò prej katundit Maqia, Prof. Benedetto Skura, nga Vakarizo Albanese, Rektor Prof. Saverio Elmo nga Acquaformosa, këta njerësh ndrezen dhe eu-zbukuruan, e lulezuan si në kohët e para Kollegjin.

Po Prof. Antonio Marqianò, pas shumë vjetë punë, edhe i math nga vjetit, la punën e shkoj në katunti i lindjes tek ku vdiq më 16 vjeshtë III, 1896.

Në 1883 qe thirur në kryesi të Kollegjit, Pishkopi Giuseppe Bugliari, nga Shënta Sofia d'Epëro, Pishkopë të Danzara, e komisioni qe formuar, prej profesorëvet Vinçenzo Andropoli, nga Shën Demetrio Korone, e Angelo Marqianò, nga Maqia. Po pas dy vjetë Pishkopi Giuseppe Buliari vdiq në 1885. Në koha që vete që 1886 gjer 1897, kënë edhe të tjerë sumdimitar si Domeniko Failla, Pishkopi Giuseppe Shqirò, nga Kontessa Entellina, (Sicili) edhe shumë të tjerë, po këta njerësh patin tepër përqarie në sundimi i Kollegjit.

Po më 1897 pas që Kollegji Kishte mbetur një mot i mhyllur, Shqipëtarët tue me shkuar rëzikun e humbjes e Kollegjit, bun një mbledhje, dhe u protestuan në qevëria tue me kërkuar ri-hapjen a Kollegjit. Qevëria Italiane mori në sy kërkimet, e lipiet e Shqipëtarëvet, e

dërgoj për me hapur prapë Kollegjin, komisionarin mbreterose Italiane Komendantore Angelo Skalabrini, Ispektori i përgjithëskmë i shkollëvet përsiashtme Italiane. Cili mori baren pa ndo pagesë;



Prof. ANTONIO MARQIANO'

ky burrë i nderçimë, e pa interes ndreqi ndërtësën, edhe idha një perparim aqë të math, sa Kollegji sot është përnjyer një nga më të miret t'Italisë.

Ky zotimi qe i pari që njoihu gjuhën Shqipe zyrtarishtë në Kollegji. Po për me përhapur më teprë diturin në Shqipëtarët, thirri prej Shqipërie mjastë djeima për të dhënë mësimë e sot janë më teprë se dyzët shkollarë Shqipëtarë të Shqipërisë.

(1) Skudhe sojë te holla t'ërgjënta, prej kushtimit 5 franka Italiane.

(2) Dukate, paragroshë,



## K R Y E X I I .

## AT GJERGJ GUZZETTA

Në Kolonia Shqipëtare të Siçilis, në Katundi Piana dei Greçi, në Provinca e Palermos, u-lintë më 25 të Prilit 1656 Gjergj Guzzetta, prej të nderçime familje të zotit, Lorenzo Guzzetta, e zonjës Katerina Mammola. Natyra këtij njeriu idha tërë të mirat, urtësi, mirësi, lartësi, bardhësi, bujari, e dashuri për popullin.

Kur prindërat e dërguan në shkollat filtare shpetë deftoj cili dot ishte në kohë të arthème, si në mirësia, s'edhe në bukur-letrëshkrimi. Thirrur prej vël-laut Serafini, cili ishte Kalogjer të Agostinianëvet Skalzi, në Qytiti i Siçilis Trapani, kur Gjergj atje vate, qe prej vël-laut rakomanduar, në ajo Kompani Feta're e Jesufit, për me marë mësimet të larta.

Dhe këtu dëftoj, mëndje të madhe, edhe e ndritëzuame, në një konkursë dhënë prej Kollegjit, për tërë zënazit, me argomenta të forta teologjke, e me fjalë oratori, çuditit tërë mësonjesit, edhe fitoj të parin vent në Kollegji, vent i grijtur vet për djemtë hujare. (nobili).

Po në kohë që mirtë mësimet, mën-tojë si mëndë të bërë të mirë kombit te tijë, për me hequr prej errësisë, edhe fat-zizë. E me që mënire mëndë me shpëtar, e liruar Shqipërinë nga duartë e barbarit.

Për këtë çëstje për dita i lutejë Perëndisë për me dhënë dritë, e mëndje, e mënire për me përderuarë për shpëtimin të mëmëdhent, për me hequr nga robëria.

K'shtu i lutijë Perëndise : "O Zote! tij që do të mirën e tërë njerësisë e botës, dritësò mëndjen time, për me ardhur në ndihmë kombit tim të varfrë, cili rrone në shklevëri robëri te shkretë.

"Zot! ëm gëzim në shpirti ym i trubu-

luar, e në zëmër time pa paqe, për me shkuar a të dit e bekuar, e lumtë, e shpëtimit të Shqipërisë, e për me shkuar prapë të lirë si në kohërat trimërore të atit tonë Shënder-beut.

"Zot! em drit! drit... drit."

Kjo ishte lutja e përdicme të këtji shpirtëmadhi, me mburime dashurie pa kufji për Shqipërin, e Shqipëtarët.

At Gjergj Guzzetta tue me dhënë kollegj konkorsë për një mësonjesë që ishte nivojë në Seminari Pishkopal të Qytetit Monreale, mori pjesë, dhe fitoj vendin si mësonjes, dhe shpejtë shkoj në Qyteti Monreale. Me zën zyrën i mësonjës, ne aj Seminarë shpejtë dëftoj diturin e tij teologjke, edhe dashurin për zenezit, gjer sa fitoj dashurin të parësisë, e të zenezit të Seminarit.

Tue me pregititur në Katundi i lindjes Piana dei Greçi, festën e Shën Gjergjut (1) cila festë mbanë që më 21 gjer 23 të Prilit prej ç'do viti. Katudarët tue me dygjuar virtuta e At Gjergjut durguan e thirrë për me mba fjalë, mbi rrotjen e Shën Gjergjut, ky shpejit shkoj në Katundë.

Në aj motë kishte gjarë një gje e çuditme, e cilla mbante tër katundarët të helmuar e të dishperuar, përsë nuk kishëte rare shii farë, e dheu ishte i dyekur nga e thata, për këtë thatsi muk mëndë të mbylljen grurët ne groshtë.

At Gjergj Guzzetta, hashkë me popullin ju lutjet Shën Gjergjut, për me dhënë kujdezë popullit, e të me dalë nga rëxikë të uris.

Chudi e madhe! O lutjet e at Gjergjut qënë të dygjuara nga Parëndia? O mister i natyres? çë dod ket qënë? nuk mëndë me këthiluar. Po vet mëndë thomi, Se pas pak kohë të lutjes, qelli

## Apostuli i Shqipetarevet te Sicilise



### AT GJEGI GUZZETTA

#### Themelonjesi i Kollegjit Italo-Shqipe ne Palermo

P. Georgius Guzzetta Siculus Albanensis, Congr. Orat.ii Panormitanus  
Doctrina, Eruditione, Pietate clarus. Pro Albanensibus suis omnia  
factus, ut omnes Christo Servant. Obiit 21 Nov. 1756. Eatatis 75.

u-mjegulua edhe të me papritur u-errësua, me filua një furturë (fortunë) me shkreptima, (vetëtima) gjëmë, (bubulima) të cëlal dritësojën e tundësojën natyrën, e tue me ra shii të fortë, e ra a që shumë sa me lagu dheun e rinfreskoi avan, me fortë gjësim e kanaqesi të populit, cili mjaftë i gëzuar, pas furtërës, tok shkuan në shpia të at Gjergjtit, edhe falenderuan, jo sy njeri po sy i sgjedhuri i Perëndisë.

Për këtë mirakuli, fama të at Gjergjtit u përdaa për gjidhë Siçilin, shunë njerëzëtë Krye-Fese e thirrën, po at Gjergj

nuk deshte me lënë popullin e vet, e rufusaj për me shkuar gjekte, përsë aj nuk kërkonte lavdi, po deshte vet të mirënjohet e popullit.

At Gjergj tue me mbetur në katundë filoj tue me dhën mësimet e djelmërisë Shqipëtare, me qënë si at, për nxenesit, po i ashprë për gjenjeshtarët, kisholonte të pasurit, për me ndihmuar të varferit (fukarenjetë).

Po në mestrë të punës e rëndë, nuk la mësimet e vet, e shumë fortë studjoj dotrinat e Fozio-t. të cilat mjaftë përkëthej në Greqishten e re tue me mar-



famë shkrimtari të fortë, e tue me çuditur teologut të asajë kohie.

Po at Gjergj tue me shkuar se tue me mbetur në katundë, nuk mëndë me ndihmonte popullin si inshte dëshira e tji.

Shkoj në Katundi Monreale, tue me përparaqitur në at Simone Zoti, të Oratorisë (lutesi) të Qyterit Palermo, për me hirë në aj ventë i përshpirtë, at Simone me shumë gëzimë i uroj mirëardhjen.

At Gjergj hiri në Seminari i katundit Monreale me 1 të Kolazekut 1707 kishte vet 24 vjetë.

U-mbetë në aj Seminarë gjerë me 22 të Shtatorit (1707), ditë qe' urdhuruar priftë në Riti latin, pas me marrë urdhurin meshëtar, prapë shkoj në Katundi, për me dhënë funtë qëllimit për me hapur një Oratori (Shpii-lutje) në Katundë.

Pati mjaftë kundreshtime, e qe marë për maremëndjes, për një barrë e pamëndur, po aj me kurajo të fortë, fitoj gjidhë kundreshtimet, edhe më 3 të Gusshit 1716 përpara Kryekatundarit, Arkimandritet dhe prifterinjëvet e gjëdhë popullit u hapë shpii-lutja lidhur me kishën e Shën Gjergjit. Në kjo shpië-lutje ishtë për qjidhë prifterinjëtë Shqipëtarë të pa martuar.

Po mëndimi të at Gjergjit nuk u mbet vet në shpi-lutja, po aj kërkonte përparrimin e Arësimin të popullit deshte me dritesuar e naltësuar kombin e vet, si mëndë me dhënë funtë kësajë çëstje të rëmdë? tue me hapur një kollegjë ku djelmëria Shqipëtarë mëndë me marë mësime, e me mbajtur dashurin për mëndheun Shqipëri, e preqatit lirën e kombit, për me hequr në robërin e shklevërin Turke.

At Gjergj kiste ardhur në famë të lartë si Oratore (gojtare) kerkoj për me marë fitime prej kësajë famë, për me vunë në vepërimë mëntimet e vet.

Shkoj e ju lutë fortë Senatit të Qyterit Palermo për me dhënë thelimë për

me gritur një kollegjë për djelmërinë Shqipëtare.

Pas edhe shkoj tue lutur Pishkopit katolik të Qytetit për me dhënë lejë për me hapur Kollegjin afrë kishës thëmëlore të Rtit Grekë cila kishte qenë themeluar pak vjetë përpara për një bashkimë të dy kishëvet Greko-Latine.

Senati i Qytetit, bashkë me Piskopin i dhanë lejë për hapjen e Kollegjit. At Gjergj pas që mori urdherin shumë farte i kanaqër edhe i gëzuar, shkoj për të kollonit Shqipëtare edhe mbledhi 12 djema preis familje të varfra, edhe i shpuri në Qyteri Palermo. Shpetë vuri në vepërim themelimore kollegjit cilin e hapi me krimtim më 30 Dishembrit, ditën e Shën Andreut 1734.

Djemtë qenë veshur si nxënësit të kollegjit të Shën Tanasit në Romë.

Për me shiguruar më teprë rrojtjen e Kollegjit, kërkoj me lutje mbret Karlo III, edhe prej Papës Benedetto XIV për me dhënë autoritetin për me marë 5000 franka mbi 3 Piskopëvet që bujën rrethe katundet shqipë Piana dei Greçi, Mezzojuso, Palazzo Adriano, Kontessa Entellina, e Shënta Kristina Gela, Pastaj më vonë dhe Mbret Ferdinand I, e ndihmoi tue me dhënë dhuratë 2450 franka edhe Paresia e Konakut Mbretorore mjaftë e ndihmoi, e kështë shiguroj rrojtien e Kollegjit.

Pas që shiguroj rrojtien të Kollegjit, përfendoj qevërimin, edhe regulimin, urdhurimin, e autoritetin jadha, Piskopit të vendit si përfaqesonjesi të Papës, bashkë me një komisionë prej katër, deputatë (kontrollorë), cilët kishën dëtrën për me mbarë regulimin, nxenosit nuk mëndë të ishën më tepri se 12 veta, cilet me nvesh robat si djemtë të Kollegjit të Shën Tanasit në Romë.

Po shpirtëmadhesia të këtjë njerië nuk lodhejë farë, dhe këréonte për me mbushur tjera vepra për të mirën e popullit, dhe të Kombit, për me vunë në vepërimë njatrë qillimë, thirri mikun e bashkëkatundarin e tji At Antonio Brankato, me të cilin bashkë-u-kishilluan për me

hapur në katundi të lindjes, Piana dei Greçi një Monastir për vashat Shqipëtarka. Për se bashkë vun mëndimin në vepërim dhe punuan, edhe Themëluan në Katundi Piana dei Greçi, monastirin për vashat. Ky Monastir ka qënë dhe ishtë folea, e Kombësissë Shqipëtare për se a tje, u ka mbetur gjuha, e cakonat, e dashurin për mëndheun të gjishëvet.

At Gjergj në 1747 shkruati e drejtojsoj mbret Karlo III nj lajmerim historik (2), mbi të drejat që kishën mbretërinjtë e Napolit, për me emërnar me titolin si mbretë të Shqipërisë, me qellimë të me nteresuar mbretin e dy Sicilivet, e me marë në zëmër çëstjen e Shqipërisi, e mëndë me dhënë lirën, ky laimërin rrëfen mëndjen politike e fortë të at Gjergjit.

Në 1756 me ardhur shkurtur në shkonia e syvet, e pastaj më vonë verbosur farë, shkoj me ndej në Katundi Parko, dhi atje shkoj me ndejtur në Katundi Partiniku, ku u sëmër shumë keq edhe vdiqë me 21 të nendorit 1756 në mashë 75 vjetë.

Trupi qe shpur në Qyteti Palermo, te ku qe varrosër në kisha të Olivellës, prej të cilës pak vjetë prapa qe hequr e shpur ne kisha monumentale të Pantheonit të Shën Domenikut në cila kishë prëhen gjidhë burrat të Shkëlqjer të Sicilis.

Artisti Zoti Marabitti skulpterti një medhaljon shum fortë të bukur të at Gjergjit Guzzetta, ky medhaljon ishtë vënë në odhat të Seminarit, me këtë përposhë thënje latine.

D. O. M.

Georgjo Guzzetta Planiensi  
Congreg: Orat: Panorm: Presbytero

Quod

Ad Graecam Sanctae Rom: Eccl:  
Concilian dam

Genti Suac Seminarium

A Carolo III, Sic Rege Dotatum  
Erexerit Perficiendumque Curarit

Parenti Piissimo

Albanenses

H. M. P.

MDCCLXXI

Këthyer në gjuhë Shqipe shtu bje.

D. O. M.

Priftit at Gjergjit Guzzetta

Prej Piana dei Greçi

e

Të kongrekës lutjare të Palermos përsë me kërkoj të paqesuar kishën Greke me të Shejten Romane.

Bashkë Kombëtarët e tji gritin për kryesim, në Seminari i pajtuar prej Mbret Karlo III të Sicilis.

Shqipetarët t'arfrit përshpirtë këtë monëmentë vunë për qjidhë mon kujtim.

1771.

Ishtë për të Shenuar se mbajtia e rrojtia e kolonivet Shqipëtare të Sicilis i dë tyrohet at Gjegjtit Guzzetta, përsë ishtë përtëdytur se Kollegji ka qënë qendra e Qytetrit, edhe vatra drytsore të dyturis, e të dashurisë flaksore për komësin Shqipëtare.

Në ky Kollegj muartin mësimet më t'urtit e me të shkëlqiemit Shqipëtarë, cilët me veprat e tyre lartësuan emërin Shqipëtar. Janë më teprë për me Shënuar këta zoterinjë.

Françesco Krispi, statistë i famshë, e Krye-ministrë të mbretërisë Italiane.

Gabriele Dara, i famshë vjershëtor, cili shkruajti Shqipë më të bukurën vepër që kan dalë në dritë njer sotë Kënga e Shprasme e Bales".

Hiresia e tjë Piskopi Giuseppe Krispi, fortë i mënçëm e dyitur në Greqishten të vjetër, cili shkruati shqipë. "Mentime mbi gjuhën Shqipe".

Petro Kiari, avv. Vjershëtor, e Shkrimitar i fortë i dëgjuar.

At Dimitri Kamarda, i famshë, autore të një vepre gramatologjike bashkë me historin të Shqiperisë, kjo vepër e vyer çuditit gjidhë botën aresintare, përsë destoj zotimin e njoftesë të gjuhës Shqipe me rrenjë.

At Kola Kamarda, fortë i urtë edhe i dyturi ne Greqistia e vjetëre, cili prej kësajë gjuhë këthey historitë, të Teokrit, e të Tuçditit.

Françesco Saluto, gjikat i dygjuar.

Gabrieli Bukola, shkrimtar i dëgjuar e autori i veprés gjikëtare "Ligja e Kohes në fenomet mëntimëtare".

Giuseppe Figlia i dëgjuar gjikat.

At Kola Ketta, autori i vepres "Historia e maqidonis", ne cila vepër përfundon, se gjuha Maqedone, ishtë Shqipia.

Prof. Giuseppe Sqirò, Vjershitor e Shkrimtar të gjuhës Shqipe.

Dott. Prof. At Gaetano Petrotta-Ganga shkrimtar e konferezjer të gjuhës Shqipe.

Simone Kuççia, avokat e deputatë, në parlamenti t'italis.

Arçiprifti At Onofrio Bukola, shkrimtar në gjuhë shqipe.

### *Shënimë*

(1) Shën Gjergj, në Katundi Piana dei Greçi ishtë krimtuar me gëzime e haree prej popullit me lodhra, me parata, kalrjedhje, vala, kënga, edhe me gjidhë atë lumtësi që populli mëndë ket ne një ditë pa mëntimë.

Po cakona me bukur, me kujtim ishtë kjo. Gjidhë ata njerësh që konë një kalë, një mushkë, ose gomarë, i veshëjen me plashkat më të mira, dhe stolisur me kordella të kuqe, e me lule të gjidhë shkojën përrpara kishës e Shën Gjegjit, te ku ishtë një priftë me një trjesë e një koritë mbushur me uje të Shejtë, cili priftë me një tok lulesh, tue me shkuar kafshat njomë lutet në uji të sheitë e bekon kavalinët, ustajët të kafshëvet pas që prifti i ka bekuar ngjipen mbi kala, e gjidhë tok, gjeshtitiën gjidhë Katundin.

(2) Botojem një copë të bashkfjalimit të At Gjegjit me nën-mbretin don Giovanni Fogliani d'Aragona, markese të Pellegrino.

Kur at Gjergj hiri në konakë mbretorë në saloni, ju kjasë një dialoshe shume bukur veshur cili ishte shëbërtori i nen-mbretit.

Kur djaloshi pa At Gjergjin ju fal me shumë rispektë. At Gjergj ishte njojur në konakë mbreterorë me teprë se kryegjkatës të Qytetit Palermo.

Prifti i thote djaloshit: Dishëronje të flasë me përlartësisë e tji.

Përlartësia e tji — u ka mbledhur tashi; dhe ndodhet në libraria, nuk dy....

Po tue mentuar se At Gjergj Kishte liri të plote, e udhe të hapur, i thotë; Po shkonjë për me ju lajmeruar, djaloshi shkoj, dhe shpete u këthey me lejën të urdhurimit, At Gjergj shkoj në odha mbretore.

Nen-mbreti e priti shumë mirë e i thotë. At Gjergj cila erë e mirë ju shpje sotë në Konak?....

At Gjergj ju përgjegjet me rëndesi:

— Jam për me ardhur për me prurë një kurorë mbretërore të mirit të dashurit mbretë jonë Karlo III, që Perëndja na eruashit.

Nen-mbreti, u-mbet, tue nenqeshur, e mënontnte.

— At Gjergj bje dhuratë një kurorë mbretërore? që ishte i marrë mëndjes?

Po pas mëntoheje:

Po që dot më përqeshur? po jemi në ë kohë të Karnevalit.... Po jo! nuk e mbesonjë një burrë i urtë dhe i Shejtë si At Gjergj!....

At Gjergj prej të gjatës qetësi të nën-mbretit kuptoj që shkojë në mëndja e tje, e kështu i thote.

Përlartësia juajë të dini se unë nuk jam i marrë mëndjes — e nuk ishtë çonë jime për me qeshur!....

Jo, jo nuk them këtë....

Po nuk e ke thënë, po e ke mentuar, ju thomë prap se unë bje kurorën mbretërore, të atdheut t'imi Shqipëris për L. M. Mbretin jine.

— Nën-mbreti, këptoj se at Gjergj

thoshje me të vërtetë, edhe jue lutet tue me urdhuruar.

At Gjergj fillon:

— Të dyni Përlartësia juajë, që kur mbretërojë, mbretë Roberti Guiskardi, në viset Napolitane....

— Po, në fund të sekulit XI.

Po në viti 1082 mbret Roberti me një ushteri mjaftë të madhe u nisë prej limanëvet të Puljës (Puglie) sbriti në bregdetit të Shqipërisë, me qënë në ato koha Shqipëria nén sundimin të Imperatorit Lesh (Alesio) të Stambolit.

Po... Roberti përthënë "Guiskardi" që do më thënë dhelpéri.

Kështu pas që mbret Roberti me ushterin e tji hiri në tokat të Shqipërisë, të parët Qytete që captoj kenë Dureci, Arta, Kastoria, dhe shumë të tjera, pastaj hiri brënda në Epirë, gjer në Maqedhonin, tue me fituar gjidhë mbretërin Shqipëtare.

— Një burrë i madhë aj Robertë!... thotë nen-mbreti.

At Gjergj pérseriti: — Mbret Roberti mbajati me vet fitimet, tue me veshur prej këtyre të birin Boimontin.

— Cili nuk dyti me mbarë.

— Po prapë përgjegjet Prifti — Po mbret Ruggiero i Siçilis, më vonë dhe aj me një ushteri të madhe, e me shume ani unis prej limanëvet të Siçilis, për në Shqipëri, të cilen e fitoj.

— Po mbret Ruggieri — thote nen-mbreti, jo vet fitoj Shqipërin, po edhe captoj Greqinë dhe Tripolinë, dhe shumë tjera vise.

— Po unë vinjë për me kuituar Përlartesisë jajë, që mbretërat, të Napolit e të Siçilis, për dy here kan captuar, e mbretëruar si sovranë në Shqipëri.

— Po nuk thom jo....

— Edhe jur kujtonjë Përlartesis juasë, se mbret Guljelmi I, i biri të Ruggierit, edhe ky fitoj viset që mbeten që në Ragusë njer në Salonik, edhe ky si ati tji u emëruar mbretë të Shqipëtarëvet.

— Po thotë nën-mbreti, përvëçë, me fituar emërin madheshtor si ati i tji, fitoj jatrin të i më pashpirtë.

— Po qe thënë i pashpirtë....

Nen-mbreti sikur i lodhur prej të gjatit bisidim historik, thotë. Po at Gjergj përfundojem....

— Përfundimi ishte ky, në mbretërat, të Napolit, e të Siçilis kjene suvranë të Shqipërise, Këta kanë të drejtën përmë emëruar me këtë titul edhe sot.

— Një titul pà pasury — një tym pa



Nuse shqipetare, prej Katundit  
Piana dei Greci.

të pjekurit — thotë nen-mbreti. Prej këtyre titula mbreti jinë ishtë mjaftë im-bushur.

— Po përsë mos me mbarë dhe këtë, si mbret të Shqipërisë!.... Dhe jipë në dorë nen-mbretit një fletë kartë përshtjelë më katër, dhe i thote: Këtu janë shkruar shkurtur pikat historike mi të drejtat që kanë mbretërat të Siçilis përmë veshur me titulin sikur të janë mbretë të Shqipërisë.



Nen-mbreti mori fleten kartë, tue thë-në në mëndja e tji: I mjerë "At" Gjergjë! ju kan manë trutë!

"At" Gjergji, këptoj atë që shkoj në mëndja të markesit edhe i thotë:

— Po shikur sot ky titul shkone më pakë se ajo fletë kartë, në cila unë kam dhënë mëntimet e mia, po kush e dy në të ardhumin?....

Edhe shkoj....

At Gjergj Shkruati këtë memurandum për me interesuar mbretin i dy Siçilivet për me marë armet e me liruar shqipëri-ne prej duarevet të Turquise.

Shena e pikevet sipër të shënuara të bashkëfjalimit, të At Gjergjit me nën-mbretin Markese Fogliani, nuk ishtë një gjenjeshtër, po ishte e vërtetë, (kopja originale) ishtë në Biblioteka Komunale të Qytetit Palermo, nën shënimin. "Manoscritti, 322, C. 7".

Gabime shtipy në numeri i tretë, në faqe 17 nën pikturën dot liçitet, Kollegj e jo Rollegj. Emeri i Prof. Margianò, ose Marqianò, ishtë Markianò, në faqe 24. Krye XII dotë jetë XI.

## KRYE XII

### LETTERAT' E SHKRIMTARË SHQIPËTARE

Pas thëmëllimit të dy Kollegjivet, fort shumë përparoj aresimi në Shqipëtarët, dhe flaga atdhesore për atdhenë e prindëvet u çelë. Po më parë kishën filuar tue me shkruar Shqipë si shëkonet në disa dokumenta.

Të parët Shqipetarë që shkruajtin në gjuhë Shqipë qene:

*Don Gjoni Buzuku*, cili në 1555 Shkruati il "Risveglio" (Zgjimi) (1).

*Luka Matranga*, nga Katundi Piana dei Greçi, në 1592 shkruajti dhe botoj "Dotrinën Shqipetarë", dhe të tjera.

*Pietro Budhi*, në 1621 shkruajti "Pasqyrë e Refimit".

*Franco Bardhi*, në 1635 nxori në dritë, te parin fjaletor, "Latenishtë Shqipe".

Po i pari shkrimitar i gjuhës shqipe cili e për çoi në populli qe at *Giuljo Variboba*, cili në Romë botoj një librë nën emërin, "Gjela Vjrgjeneshë Shëmri". Libra e të cilit, ish formuar tërë me Kënga Kishërake, këto, kenga u përdorën në pér kishat e gjidhë Katundëvet Shqipetare t'Italisë. Me këtë veprë, gjuha Shqipe mori një frimë dashurie, dhe të shëndoshme, në populli. Kjo veprë, jo vëtëm që idha një përparim të madh gjuhës Shqipe, po edhe një përnjothësi, në të huajit, të cilit thoshin se Shqipia nuk

ish një gjuhë, po ishte një dialektë Grekë, pak dryshuar, dhe e cila nuk kish as një formë abetari për të shkruar.

Po at Giuljo Variboba, kundreshtoj, dhe goditi me shkrimet e tija armiqtë edhe Elenifilët kundreshtarë, të përparimit të gjuhës Shqipe. Tue me dale në driti vepra e këndimevet Shqipë, dëftoj botës se Shqipia ishte një gjuhë dhe e cila kish vepra litterare. Pas at Varibobës shumë të tjerë Shqiptarë tue me dhënë gjuhës Shqip një formë litterare e cila qje kaqë e lartë sa çuditit gjidhë botën. Këta Zoterinjë qënë: *Vincenzo Dorsa*, nga Frashineti, (Kalabri), cili shkruajti dhe botoj në 1847 edhe 1853 "Kërkime e mentime ndër Shqipetarët".

*Piskopi Gjuseppc Krispi*, nga Palazzo Adriano, (Siçili), Piskopë të Lampasko, cili në 1857 shkruati e botoj, "Kërkime dhe mëntime mi gjuhën shqipe", edhe mblodhi shume kenga popullore.


Tjetër shkrimitar i madhe qe *At Francesco Santoro*, nga Shënta Katerina-Albanese, lindur më 16 shtator 1819, e vdekur në Shën Gjakamo-Albanese në 1904. Botoj librat "Jkeshteri i shënteruar", Drama "Emira", "Iburgosuri Politikan", si dhe shumë të tjera mbeten te pa botuara. Ky njeri jo vet qe shkruajti

Shqipë, po idha çestjes atdhesore një përparim të math tue prethikuar dhe e mjuar djemtë dhe vashat në kishë gjuhën amtare.

*Paskuale Baffi*, nga Shënta Sofia d'Epiro (Kalabri) filolog i dëgjuar, dhe cili qe martirizuar nga mbrerteria e Borbonevet në 1792 për mëntimet liredashë, edhe ky la mjaftë botime mbi Shqipërinë.

duar me gjuhë Shqipë, veprat trimerore të Kombit Shqipëtar më pastaj shkoj në Amerikë ku vizutoj shumë vise, u mbet në funt në Shën Paolo Brazile, tek ku u semurë keq dhe vediq i varfer, po me vjershin Shqipe në buzë.

*Dhimitri Kamarda*, nga Piana dei Greçi (Sicili) teologë e filologe, e Prof. në Onoversiteti te Qytetit Palermo, Shkruajti edhe botoj një gramotologji në gjuhë



Kollegi Italo-Albanese ne Shen Demetrio Korone.

*Vinzenzo Stratigò*, nga Lungro (Kalabri) lindur në 1822, e vdekur në 1885, cili mori mesimet në Kollegj Itilo-Shqipë, Shkruati mjaftë Kënga në gjuhë Italiane, po vepra me madhe qe libra, "Il proletario ed il bersagliere", domëthën, Punëtori edhe ushtari.

*Gabriele Dara*, nga Palazzo Adriano (Sicili), Shkruajti e botaj "Kengen e Shprashme e Bales". Një nga veprat vjershetore më të bukura qe janë botuar në gjuhë Shqipe.

*Gjusepp Serembe*, nga Shën Kosmo Albanese lindur më 1843, vjershetor i pa pritur, dhe të cilil ju muar mëndia. Udhetoj tërë qytetet të Italis, tue kën-

Shqipë, edhe një apendi të gratologisë, me vjersha dhe histori të Shqiperisë, dhe shumë të tjera.

Vepra e tji quditit tërë filologët të asaje Kohje.

*Kola Kamarda*, nga Piana dei Greçi, botoj lajme biografike mbi Kostantinim, dhe Maria Kostantini, një biografi mbi at Gjergjin Guzzetta.

*Pietro Matranga*, nga Piana dei Greçi, (Sicili), Prof. i gjuhës Greqishte në Romë, botoj më 1850 Anekdhota Graeka, e më 1837-52. Heorogni de Akademie. Më 1852 botoj një fjalim mbi qytetin de Samo, qendruar në Tëraçina, pas të themit të Homerit.



*Gjergj Matranga*, nga Piana dei Greçi, (Sicili). Edhe ky qe nje nga më të fortit punëtorë të gjuhës Shqipe. Përmos me lënë të hubasin në 1897 botoj në Palermo nje veprë "Kenga Shqipe".

*Għjini Sqirò*, nga Piana dei Greçi, botoj "Mëntime historike Shqipëtarë".

*Kostantino Kostantini*, nga Piana dei Greçi, gjikat i dēgjuar cili vdiq prej səmendjes kolera në Palermo 1837, Shkruajti nē gjuhë Italiane nje veprë vjershëtore "Il Kolombao d'Italia", me këtë veprë, mori një famë aqë tē madhe: sa qe thirrē një nga më të mbedhenjtë vjershëtorë tē asajē kohë.

*Zonja Kristina Gentile*, nga Piana dei Greçi, vjershetore nē gjuhë kombëtare, bashkë punonjës me tē pa vdekurin Girolamo De Rada, e ndihmetaria e fortë e Prof. Giuseppe Sqirò.

*Domeniko Bellushi*, nga Frashinet (Kalabri) Piskope tē Sinopolit. Autori i tē famshesës përgjigje e filosofit Hjressi e tji Piskopit Gargano.

*Angelo Mashi*, nga Shënta Sofia d'Epiro, (Kalabri). Këshiltar i qevërisë, shkruajti nje fjalim mbi Shqipëtarët.

*Luigi Petrassi*, nga Cerzeto Albanese (Kalabri), Këthey nē gjuhë Shqipe "Childe Heroldit" dhe i "Sepolkri" prej tē madhit Shkrimtar Italian Hugo Foscolo.

*Angelo Basile*, Autori i tē pamënduanes tragedhi "Ines de Kastro", mblodhi edhe batoj shume Kënga Shqipe.

*Għjni Drek Bidhera*, nga Palazzo Adriano, (Sicili). Shkrimtar i fortë, shkruati mbi vepren te 40 sekujt tē Mantener, dhe nje roman shqipe nën emerin "Maten eren".

*Saverio Masi*, nga Palazzo Adriano, shkruajti "Kerkime mbi Shqipëtarët".

*At Kol Shpata*, nga Palazzo Adriano, shkruajti dhe ndreqi Historin e Skënder-beut nē gjuhë Italiane.

*Avv. Pietro Kiari*, nga Palazzo Adriano, shkruajti ne gjuhë Italiane "l'Albania" dhe la "Lega Albanese". Në 1879 Ministri i qevërisë Italiane Francesco

Krispi, thirri edhe dërgoi avv. Pietron Kiari-n tē udhetonje Shqiperin.

Avv. Kiari me shumë gezimë shkoj nē Shqiperi, pér me shkuar Atdheun te gjishev, edhe e para shkelë e tok tē Shqipërisë qe Prevesa, tek ku u bashkua me Eseelf bez Dino. Udhetimi im thotë avv. Kiari qe ky. Prevesë, Luro, Artë, Janinë, Gjinokastrë, Tepelen, Berat, Elbasan, Tiranë, Krojë, Lesh, Shkodër. Në shkrimet e tji qe i dërgoj gazetes "La Riforma", cila nē ajo kohë botahejë nē Palermo, thote. Me gjithë dishërimin, dhe dashurin që kisha, pér tē shkuar vendet trimerore e gjishrevet tanë, nē udhetimi që bëra nē Epirë, shkova gjera tē çuditshme!.... pashë njerëzin cilët janë shumë lark nga ndjenjat Kombetare, fjalosen Shqipë, edhe Greqishtë, po kana nē një deshire tē fortë pér Greqinë! a që se edhe mbesonjë as kur, që te humbasinë. Shumë fortë më dhembet zëmera nga kjo dobje, cila prishi qelimin e udhetimin, t'im, cili vate me kot".

*Pasquale Skura*, lidur nē 1791 nē Katundi Shqipëtar tē Kalabris, Vakarico Albanese, Gjikat i degjear edhe fortë i nderçmë. Pér me pasur mëntimet lirëdashje qe zbuar prej Italise.

Në 1860 me hirë Garibaldi nē Qyteti Napoli, Pasquale Skura qe thirrē e i emëruar Ministrë te Faljes e tē Ligjës, e tē Kultit, (Fetare) nē mbretëria tē Napoli. U mbet nē barrë e Ministeris gjer që ardhı Mbret Vittorio Emanuele II, tē cilit i presentoj formën tē plebeshit tē popullit.

Vdiq nē Napoli me 12 Janarit 1866. Batoj artikula mbi shqipëtarët n'Itali.

*Stefano Baffa*, nga shënta Sofia d'Epiro, vjershitor i degjuar.

*Konti Gaspare Manconi*, nga Piana dei Greçi, kryepresidente tē gjekates tē Lartjemes Kortë tē Qytetit Palermo, Shqipëtar fanatic, më përpara se me vdekur bëri dhjatë tue me lën pala-sin (2) e vet që kishte nē katundi pér me bëre një shkollë pér vashat tē varfëra.

(*Shko numerin i pestë*)

At Kol Ketta nga Kontessa Entellina (Siçili), Autori i shumë veprëve në gjuhë Shqipe, e më teprë të nje i hapur dicioner etimoloxhikë, emëruar, "Theso-

*Vellezëria, Kola, Cesare, Alekxandri, Salvaturi Marini, të katrë Profesorë e leteratë të dëgjuar.*  
*Giuseppe Basta, Prof. i leteraturës I-*



ri i gjuhës shqipë, e një histori t'Epirit e të Maqidhonis.

*Imzot Katalani*, nga Mezzojuso, autor i një fjaletori, e një gramatike sqipe.

*At Pomilio Rodota*, cili shkruajti mbi Ritin Grekë n'Itali.

*Vellezëria Dominiku e Rafail Mauro*, përsimitarë e vëtëdashës me Garibaldin.

*Vellezëria Palli e Kol Skura*, leterat të dëgjuar.

taliane, e shkrimtar i famëshmë.

*Dominiku Moro*, Kriminalistë i famëshmë.

*Fraancesko Buljari*, Piskope e Prof. i Greqishtes i dëgjuar.

*Vellezëria Dominiku e Mihali Bellushi*, i pari Piskopë e i dyti Priftë, qenë të dy leteratë të famëshmë.

*Angjelo Sarri*, Kriminalistë i dëgjuar.

*Vellezëria Luigi e Rosario Giura*, qenë

të dy ministrë në qevëria provisore në Napoli me Garibaldin.

*Kola Shales*, shkrimitar, e këshiltar i qevëris.

*Merkuri Dorsa*, vjershëtor i dëgjuar.

*Françesko Saluto*, nga Piana dei Greçi, kryegjikatës e të Lartës-Korte të Qytetit Palermo, cili më përpara se me vdekur bëri dhiatë me lën tërë pasurin e tji, për me hapur një Kollegj për djemtë shqipëtarë të katundit, cilët nuk kan para për të marë mësimet të shkollavet të lartëme. Vdiq në Qyteti Palermo, po deshte me qënë varrosur në ka-

tundi i lindjes, te ku qe varrosur e gritur një monëmentë varri shum të mirë.

At *Kol Brankato*, edhe At *Françesko Parrine*, e At *Giuseppe Kamarda*, që të tre nga Piana dei Greçi, cilët shkruan e botuan mijtaftë vepra në gjuhë shqipe.

*Gabriele Bukola*, nga Mezzojuso, kriminalistë i famëshmë cili çuditit me shkrimet e tji tërë botën. E shumë të tjerë shqipëtarë cilet na vjen shumë rëndë përtë emëruar, dhe cilët kan qënë profesorë, gjikat, eqimera, e me punera të larta në qiveri.

### Shënimë.

(1) Ky duket se isht, për sa dim, e para veprë Shqiptare e shtypër.

Ishtë e këthyer shqip nga gjuha latine, e ka Oficen e Zonjëz Vjrgjëreshë shën Mëri, shtatat msalmet e pëndimit me litanin e shejtarëvet, pjesë të Rritualit, pjesë të katekismit, Meshët e vitit kishëtar të krëmptjet të tundëra e të patundara. Lipsen të parat flet edhe të tjera, ktu e ktie, mbeten vet 94 fleta (faqe 188) dy shtyllash e pak copa fletësh.

Kjo isht vepra çë Hirësia e tji Arkipishopi i Shkupit Imzot Don Gjon Pajëzerii Këlit Kasisit, shqipëtar prej Jakovës, në viti 1740, kish par me çudi në Romë, në Kollegj i Propagandës, gjëth i shqjerë dhe i vjetër, e çë e thriti: *Antichissime Messale Albanese*, (Mesha e Arbreshëvet shumë i motçemë). Deshi me gjërim të dorëshkronjë një shebër në e shprasmes fakje, sa të ja drëgojë dhuratë të shkluamit At Gjergjit Guzzetës. Themëlonjesi të Seminarit të shqipëtarëvet në Palermo, edhe të tjera veprave kombëtare.

Prototipi i shpirtëmadhëvet edhe të mëndjes e të zëmergjerës të kombit shqipëtar. Kjo e dorëshkuame me të tjera shkuan në duartë të binduershmit At Pall M. Parrino, Dreqësonjësi të Seminarit të shqipëtarëvet, si edhe aj kujton

te vepra e vet e dorëshkruame: "De cnsensionibus Albanensis eum Romana Ecclesia".

Hirësia e tji Imzot D. J. Krispi, Piskopë të Lampsakut, edhe Dreqësonjezi të Seminarit të shqipëtarëvet bëri edhe aj shënim në vepra e tji: "Memorie storike di talune costumanze appartenenti alle colonie Albanesi di Sicilia; Palermo 1853. (Përkujtime historike dica caknëvet të katundëvet shqipë të Siçilisë).

Nnde fakje 88 e 89, bënë fjale mbi dorëshkrimin të Arkipiskopit Kasasi.

Kjo veprë ishtë shtypur me shkronja gotike latine. Tashi Hirësia tji Imzot Pall Sqiro, Piskopë i emëruar i Bendës, delegat e i dorëzonjës për priftërinjët shqipëtar të Siçilis, ishtë per me ribotuar këtë vepre e vjer.

(2) Palati i Kontit Manzoni në katundi Piana dei Greçi ishtë një punë artistike. Palati qe edhe vizituar nga mbret Ferdinand II, të Borbonit cili atje u mbet pak kohë. Palati ka qënë i vizituar prej shumë turistëve si Inglesë, Francëzë, Jedhe Germanë, për me shekuar dhomat me piktura të bukara zografisur prej të famëshmit piktor Pietro Novelli.

(3) Kollegj qe hapur në Qyteti Palermo, me emërin, "Konvito Saluto", në udha Korso Pisani.

## KRYE XIII.

## GIROLAMO DE RADA

"Emri yt o Atdhetar i ndjerë  
 Kurrë mos u harroft no një herë  
 Se pate dashuri pér Atdhenë  
 Aqë, sa pak janë që munt t'a kenë"  
*Asdren.*

Cili ish, Girolamo De Rada?.... De Rada ishtë Omeri, Tirteo, Virgili Dante, i Shqipëtarë vet, cili vdiq, si rroj i mjeri vjershitor, luftoj me varfëri, me uri në stomah, e me vjershin në buzë, me robat të grisura e me lirën në dorë! Shtrënguar nga nevoja, kur' nuk' u largua, nga shpresat, nga dashuria Atdhesore.

Në tërë rroitjen e tji e trubuluame, vetëm një Fee, e një shpresë pati *Lirin e dhe indipendencën e Shqipërisë*. Plak 80 vjeç, luftoj, shinë dhorën, erën, të ftohtit, rrëzat e diellit, e tërë të keqiat e natyrës, e pér dy herë në javë, shkonte herë mië kembë, her mbi gomar, që në Maqia katund' i lindjes, gjer në shën Dimitri Korone, pér të vatur me bërë shkollë zënëvet, të Kollegjit t'atjeshmë, ku kishte filuar, dhe hapur të parën shkollë Shqipe me tërë regullimet t' arsimt.

Në një nga këta udhëtime në dimbër dhe në një kohë të keqe plot dborë dhe me një erë të ftohtë, shkonte plaku n' udha e reptë, pushtruar në mallotë, e kaluar mbi gomar. Tue me shkuar në një vent të keq të udhës gomari shket, edhe plaku bashkë me gomarin rrotellojnë në dborë.

Disa fshatarë udhëtarë, kur panë se plakë ra në dhee, rrodhën pér me ndihmuar, tue me thënë. Po si Zotënia juajë në këtë kohë të keqe të udhëtoni? e pastaj njeri i math nga vjeçit si Zotënia juajë? nuk lipset me vun në rrëzik rrojtien? Plaku u grit vehte, dhe ju përgjigjet fshatarëvet, Plak.... unë!.... Po.... kini të drejtë, po unë plak jam nga kurmi, e jo nga shpirti.... Unë.... dot rronjë gjer

sa të shohë të bukëren, të dashurën, *Shqipëri Jonë, të lirë dhe të madhe*, dhe pastaj me gjëzim le të vinjë vdekia. Po fati nuk idha këtë gjëzim pér të shëkuar dëshirat e shpresat e zemër tji.

Shëkon, se ç'farë shpirtëmadhë, dhe dashuri pér shqipërinë, dhe shqipëtarët, që kish ky njeri!

Girolamo De Rada, u lindë fshati Maqia (Kalabri), ne 1815, mori mësimet në Kollegj Italo-Albanese të shën Dimitri Korone, Pas që mori mësimet, zuri të mbledhur rrëfimet të: "Gjakët ynë i prishur" e këta rrëfime i mblođhi tue me vajtur shtëpi, me shtëpi, dhe pér tërë fshatrat shqiptarë, pér të mbledhur nga goja e popullit këngat kombëtare të cilat i botoj në Firence në 1866 nën emërin "Rapsodie Albanesi", me ndihmën e Dot. Kol Jeno të Koronei, nga shën Dimitri Korone eqim të mbretit Ferdinand II, të Borbonit. Po në 1848 kishte filuar të botojë ditarin në gjuhë Italiane, "L'Albanese d'Italia", ditare politikë, e literarë shqipe, e pastaj mië vonë që ndruar në e para gazetë shqipe "Flamuri i Arbris". Kur më 1862 mbret Ottoni të Greqis shkoj prej Napolit pér të vatur pér të marë një nuse në Bavierë, ishte bashkë me mbretin, i biri i Miaulit, cili përcilltë mbretin në udhetim. De Rada, u paraqit të birit të Miaulit e kujtoj se aj ishte i biri i një trim shqipëtar, edhe i dëftoj veprat e tija pér të me ngjalë gjuhën e gjishërvet. Miauli u kanaq tepsë, edhe mjaftë e nderoj De Raden tue me shiguruar, se kur të këthejë prej Bavierës, ndonte me marë bashkë e me shpur bashkë në ania mbretërore në



Greqi. Po puna në Bavierë teprë u ngjat dhe Miauli nuk më e thirri.

Në Kongresi i Berlinit, pas një letrë-thirrje të De Rades shkruar Ministerit English, shtu ju perggjegje Ministri.

Korrik 36, 1880.

E. 10 Dom Street.

Zoteni.

"Unë jam i Zotuar nga Zoti Gladstone për me diftyer me të ngjalat falën-derje për letrën tuajë të 17 të ketji muaji, ju thom se ju mënt të rrini shigur se aj bashkuar tok me shoket e tja deshiron për Shqipérin ato të drejta dhe shiguri, për drejesi qivile, që sot ndodhen përploteruame që lipset nën sundimit Turk veç tek ato vise ku jan shiguruar në mestrë të themelimit mbretërorë për vet Autonomike".

Unë jam Shëbërtori të Zotenis juaje.

Y. A. Godeley.

Istoriani i madh Italian Cesare Kantu, cili shkrojti historin të Botës, në 29 të Marsit 1886, i shkruati një letrë De Radës.

Zoteni.

Mar për herë "Flamurini Arbris", juajë, ma ju thom të vërtetën, nuk më pëlqen ajo thirrie he për he, kundra Greqis. Ngjer 29 neve shëmbëlojmë Epirin me Janinën bashkuar me Greqin sa nuk mund të shëmbëllonjë për me ndajtur një qytet i përvet. Ma nje federatë Balkanike nuk mund ishte e mirë?. Më thoni si ju e shkoni të ardhmen e At-dheut të gjishërvet juajë për me dalë e me këputur përposh sundimit Turk.

Shënojëm këtu përposh pikat më të nevojshme të përgjigjes, Cesare Kantu-it, që i bëri G. De Rada.

Zoteni.

Vjinj të ju vë përposh çestjen e Shqipërisë përlene nga gjidhë, si dhe prej Zotenis juajë në Historia e Botës, nuk bëtë as fjalë. Më parë se të gjitha kombi Shqipëtar me gjith se ishtë afrë të Greqis, nuk ka as farë një bashkim me këtë gjuha shqipe ishtë farë e drishme nga Greqishtia e kurr Shqipëria s'munt

të ket një bashkin me Greqin, nga këta shkake.

Grekët mëntojën për me rilindur e të bërë imperatorin Bizantine, dhe *kafsha pas ambicies e tyre? Ishtë Shqiperia?*

Kur ne 1883 Manovrati Konsul Grek ne nisia Malta, ne di sa numera te gazetes "l'Akropoli të Atena", shkruante se shqipëria e lartëme, në Epir e Maqedhoni nuk ka më tëprë se 700,000 shqipëtarë, nga ky shkak si munt se kishte të drejtën Shqipëria për me bërë mbretëri me vet.

Ne 1850 një gazetë Greke cila botohej në Vienë "Imera" kanaqehet teprë se në disa udhëtime që bëri në Greqi, kishte shkruar se Shqipëria kiste humbur fare.

Unë më 1860 botova një librë, "Të vjetrat e kombit Shqipëtar" tek ku shpjegova se panelenismi ishtë një marrësi, po fajn e ka Turqia cila ka lën Grekët të lirë për të hapur shkolla, e ndihmuar nga kleri e me parat e dy shqipetarevet, Zappa e Zografo, kanë gënjer me an të Fesë popullin. Greqia cila me intrigat e saja në qeveriá Turke, prishi lidhien e Prizrenit tue me burgosur tërë atdhetarët Shqipëtarë. Pas prishjes të lidhjes, Greqia mori frimë e zu me ndjekur me më-nira të poshtra edhe teprë të keqe me ndjekur gjuhën Shqipe.

Një inderçmë shqipëtar prej Greqie, Ana Kolurioti shkoj në Gjinokastrë për të përndar një Abetar Shqipë, po konsuli Grek' i atjeshmë Zoti Komaçio e mori edhe e burgosi, edhe pastaj e shpuri në Korfus.

Qevëria Greke për të nderuar burrimin të Komaçiot emëroj Konsul në Korçë. Në ato koha Shqipëtarët kishnë ardhur në këshilë për të themeluar një gazetë, tue me dhënë mua direksin. Kjo gje nuk i pëlqevi Palinismit, edhe kerkoj me intriga për të pushuar gazeten, "Flamuri i Arbris". Një mision Greke ardhë nga Korfusi në neve tue na kishilluar, për të organizuar një kryegritje kundra Turqis e pas që të fitonin tue me bërë tok me Greqinë. Po komisiona

shkoj prapë në Korfus me "bishtin në për Kembe". Grekerit kërkuan për me mblerë shtypin European për të thënë Gjajen kafshore të Shqiperis. Po "Flamuri i Arbris" i nderçmë, o Zoteni pa pikë, e pa frikë, nuk munt të largohet

Ka kjo gje ishtë për neve shpresa mëmdhetare nga një vent jashta dashurivet e nga bashkimi, e tue me pritur çastin historik të arësimit, dot ç dinë se shpet flamuri i atdheut, dot ngrihet për të shtrihur e për me valuar në ërë,



### FRANCESKO KRISPI

#### Krye-ministri t'Italise

nga program' i vet. Për se largu tërë shëkojnë në Greqia një fuqi, një qytetërim për me urdheruar gjitonët. Po neve cilit ndjejmë tërë gabimin e këti mentimi të keq për neve, do të thomi për të vërtetën se Shqipëria brënda viset e sajë ka më teprë se dy milionë njerësh, pa ata të Greqis dhe të nisivet të Arxhipelagjit, e të kolonivet të Asise, edhe të Italise, e të tjera vende të botes. "Rraca Shqipëtare nga Virtutat, nga Shpirti, nga Trupi, e nga Semlilia, nga Besa, ishtë me lartë se Ellenika.

këtë do te kemë me shpresën të Perëndisë.

Keto janë pikat e përgjegjes të atdhetarit i madh e i pa vdekur Girolamo De Rada, një historiani i njohur e i famëshëm si Cesare Kantu-it.

Dhe botojëm edhe një copë e fundit të një letre që i madhi shkrimatr Nikol Tommaseo dërgoj De Radës, pas që lichti veprat e tia.

— Mua më pëlqen xenia në gojë të cakonëvet: — Me vaturit të vashëvct për ramiqe; me thierë lëmshin në shpii,



me qepërit linjët, edhe të pjekurit e bukës: — Këto kujtojën me dashuri familjën e atdheun: — Kronjet e katunde t'ona: — Qe mëndë thresiën me embël-zirën tepërlore të e thënies e Virgilit: "Hic inter flamina nota et fontes sacros". Ishtë me kthellë se në "Dorotea" të Goethe — it, vasha që shkon për me marë ujë, e në mestrë të udhës mbetet për me shkuar katundin.

Një trim që me shpirtin ruan bukurin mbretërore të mëmës.

Testi të përdërimit i Zonjë mëmë, ishtë dhe ky në kjo kombësi patriarkale e luftëtare, ishtë një dukumentë historikë: Dy zëmëra që këptohen, janë si dy goja që hapen në gazi.

Shum të tjerë thonë se këngat tuajë janë të përziera, po Zotënia juajë që dëfton të pa vdekurën pllëmbë të Anakreontit, me jepë aber që nuk ishtë për me qehur me spagë retorike: Njatrë lidhje tashi shkonjë që shtrëngoj Zotënia juajë në 1839.

Shkonjë me bashkimin e mprojtes e mëndimit të zëmërës, në cila ishtë mieshtrë. Në zëmëra juajë një ambicie vet shkonjë të mirën.

Përse ishtë me dashuri pasurore, për kombin gjer në fundi i rrojtjes.

Urimet e mia me dashuri.

N. Tommaseo.

Në një 1844 të Shtatorit i madhi vjershëtor francës Lamartine kishte vatur në Napoli, për të bërë banjo në bregjet e nisisë d'Istria. E. G. De Rada i dërgoj veprat e tjia shqipe, "Milosao, e Serafina Thopia". Vjershëtori francës si i pa e i liçiti i dërgoj një letrë falderie De Rades, cilën letrë e botojmë në gjuhë orixhinale e saj Francese.

"Monsieur;

"Je suis bienheureux de ce signe de fraternité poétique et politique entre vous et moi. La poésie est venue de vos rivages et doit y retourner? Je m'ai en autre manière que de le présenter et de faire les premiers vœux pour la liberté, et pour la

resurrection de l'Albanie. Vous m'en recompensez trop.

"Je m'afflige de la cause que m'empêche de voir; et je vous prie di agreeer mon remercinment e mes felicitations".

Lamartine.

Në 1891 gazeta "Stampa Ester" e Berlinit botoj një artikull kritike mbi dramën "Sofonisba". Artikulli qe shkruar prej te famëshmit kritikan Herman Bücholtz.

"Girolamo De Rada, më i miri kompozidor i Shqipëtarëvet, këngat eroike të cilat venë që në Milosao gjer në Skënder-beu, ka më teprë se gjismë shekulli që madhon popullin e ty, e bujën gjëzimin të filologëvet, mblodhi tërë këngat e popullit e farës e ty. Dhietë vjet më përparrë deshte të bashkojë zëmërat e gjindjes e ty të perndara. Për këtë gje nzozi në dritë një gazetë politike e letrarë në gjuhë Shqipe, tue me shkuar i dyturi filologë thot: "Sofonisba e Trissinit, të Alfierit, e të Gjebelit, janë gjidh një, si ajo e Alfierit, (tragjedhia të lë ftohtë. pjejëm: Si bën De Rada? cilit më teprë prej të treve i gjetë? Si pas nomit drama historike, vete në përkëthymi dreq historik, po shëkojëm se nuk ishtë miaftë për me shtruar edhe më sbluar hartimin të vjershit. Po ispirazia miafton në filimi, e në bashkimi i vendit, e të kohës".

"Po ndron shenën si Shakspiri, me hatuar me madhëni si ky, edhe si i vjetri Eshkilo, edhe me rën mirë mbi kohën e sotme, me shumë aktrative për gjerat e bucura të i spireshëvet l'Italisë, e të Europës e tërë.

Shëkojmë në vepra e De Radës shenja, mare nga vërteta, atë që, nuk kanë tjerë autorë, si Alfieri, e Giebeli. Prej të tëra Sofonisba (1) ka pastri, e bujëreshe të madhe, të vërtetën me besën të Annibalit.

Orixhinali Shqipë i tragjedhisë ishtë shkruar me një gjuhë aqë të vërtetë edhe të bukur e me pasuri, me idhera shumë Orientale.

Gjuha ishtë e çuditeshme, bujare, dhe e vjetër".

Prume këta shënimë të shkrimtarëvet të ndrishmë e të famëshme, për më dëftuar në cila shkalë e lartë qe konsidheruar nga bota e huaje i pa vdekiri atdhetar G. De Rada, cili punoj me gjidh shpirtin për me dritesuar e naltësuar Kombësin Shqipëtare.

Pati edhe për miq vjershëtoret dhe atdhetarët, Nain be Frashiri, edhe Nasim be Premeti, si edhe të famëshmen Shqipëtare e shkrimtare të popullit Shqipëtar, Princesa Elena Gjika, përjohur përmbi emërin, Princesa Dora d'Istria, cila miaftë ndihmoj De Raden, për botimet të vepravet e tji.

Pati dhe për mike vjershëtoren Austriake Baronesën Giuseppina Knorr.

Mbreteresa Margerita t'Italis, shum e nderoj vjershëtorin tënë.

G. De Rada qe mi forti punitor përtë me njohur qevëria Italiane Zyrtarishët gjuhën Shqipe, edhe për me hapur një shkolle zyrtare dhe qevëritare me shpresë të ishte aj thirrë përmësonjes. Po pas që qevëria Italiane njohë gjuhën Shqipe zyrtarisht si një prej gjuhavet e vjetra, hapi një shkollë Shqipe në Universiteti Oriental të Qytetit Napoli. Pas filimit

të shkollës Ministri t'Italis i shkruati De Rades, dhe me bëri të njohur se aj ishte shum i madh e nuk do të munt të mirtë barën emësimëvet.

Kjo lajme e zëmeroj fortë teprë plakun, dhe duke gritur syte në qjelli e shekoj yllat, tha: "Fati të yllit tim ishte lidhur me fatin i keq të Shqipërisë. Vdiq i varfrë në katundi i lindjes Maqia ne (Kalabri) në moshë 90 vjeç.

Ky qe burri i cili përhapi çështjen Shqipe, cili me veprat e tjit shtiri flagnët atdhesore në djelmeria, e cila flag idha një përkrahje e fortë në lufta politike për shpëtimin e Shqipërisë.

Veprat me të degjuara të De Rades janë. "Rapsodie Albanesi", Kenga e Serafines Thopia, "Skender-beu", Anna Maria Kominate, Nata e Krishtelindjes, "Sofonisba", "Milosao" e shumë të tjera.

(1) Sofonisba e bia e Xheneralit Kartaxhinesë Astrubale, pati dhënë Besën përtë vatur nuse me mbretin Massinisa. Po shkoj për me martuar mbretin Sifaje të Numidis, cili u perdaa nga Romanet. Tuc me rarë Sofonisba në duartë t'armiqevet, u farmakos, 235-203, Perpara Krishtit.

#### *KRYE XIV.*

#### FRANCESKO KRISPI

Në fshati Ribera (Siçili) prej zotit Thoma Krispi, e zonjës Josefa Genova, që të dy Shqipëtarë prej Katundit Shqipë Pallazzo Adriano, cilet Kiskën shkuar në fshati Ribera, për se zoti Thoma Kishë pasur një punë qeveritare në aj fshatë.

Më 4 Tetorit 1818 u-lindë Francesko Krispi (1). Prindërat që në djalëri e dërguan në Kollegj Italo-Shqipë të Qytetit Palermo, në cili mësoj ligje. Pastaj shkoj në Napoli për me dhënë funtë mesimevet. Në 1839 botoj një e përkoshme Italiane me emër L'Oreto, në e cila

gazete më 7 të Tetorit 1839 botaj një artikull thirrë Shqipëtarëvet të Siçilisë mbi veprat e G. De Rada (2).

Ne një 1841 qe shkruar në albumi i gjkatëvet të Qytetit Napoli.

Në 1843 në Napoli u-shtë në lumi i lirëdashëvet kundra Mbret Ferdinandit II. të Borbonit.

Në 1849 përmëtimet lirëdashie, Krispi qe sbuar nga mbreteria e dy Siçilivet, e shkoj në Francë, e pastaj më vonë në Torino, në cili Qytetë u-mbetë pak kohë, si redaktor i shumë gazetave.

Në atë kohë u vu në letërë shkembim



me Gjusepin Mazzini, me të cilin bashke preqatitën kryegritjen në Lombardi. Qevëria e Piemontit sbloji komplotin e qit jashta Krispin, i cili q'atje shkon pér në nisia të Maltës. Po në 1854 qe dhe sbuar prej nisise Malta, dhe shkon pér në Londrë.

Në cili Qytetë pér me rruar u bë i msonjes të gjulies Italiane. Në Londrë, bashkonet pér të parën herë me të madhin persimetar Giuseppe Mazzini, më të cilin shkojnë tok pér në Paris. Në Paris mbetet tri vjet 1856-59. Nga Franca qe qitur jashta si përzimëtar, e Krispi prap, shkon në Londrë. E që në Londrë prap shkon pér në Torino, po prape Qeveria e Piemontit, në moj i Shëntadreut 1859 qit Krispin jashta prej Torinot.

Krispi, shkon në Genova tek ku bashkonet me përsimëtarin siçilian Rosolino Pilo, cili, pas një fjalim që kishte pasur me Giuseppe Mazzini, kishën arthur në Kuptim pér me gritur popullin të Siçilis, tue me dhënë sundimin e kryegritjes Giuseppit Garibaldi, cili ndodhejë në ato koha në nisia Kaprera. Garibaldi e morri pelqimin e sundimit të qetavet të kryegritjes, po tue me vun kondicie që flamuri qe dot valonte dot ishte me këtë thënie: "Italia e Vittorio Emanuele II", Garibaldi shkon në Torino, pér me preqatitur pér me shkuar në Siçili.

Më 7 të Prilit 1860, Françesko Krispi, me një e truame (rakomanduar) prej përzimëtarëvet Agostino Bertani e Rosolino Pilo, përparaqitet në Garibaldi, cili pas që liçti letrën, shumë e nderoj Krispin.

Krispi tok me Garibaldi shkojnë në Genova, ku gjejën Bertanin, e Pilon, e me nje mjë vetëdashur, s'andej me vetëdashurit shkojnë pér me marë Siçilinë.

Garibaldi bashkë me volontarët dualle në shkela e Qytetët të Siçilise Marsala; Populli kur shkoj vetëdashurit, tok u bashkua me Garibaldin kundrejt qevërisë, e me ndihmën të popullit Garibaldi captoj Qytetin. Që në Marsala shkuau në

Palermo, të ku edhe atje gjeti popullin i preqatit, e shtu Captuan Qytetin.

Pas captimit të Krye-qytetit të Siçilis, Garibaldi emeron Franceskon Krispi sekretar, e pastaj më vonë, ministër të qevërisë provizore. Pas që Garibaldi liroj téré Siçilinë, tok me Krispin shkojen në Napoli, te ku pas captimit te atjë Qyteti, Francesco Krispi emërohet ministër i asajë, qeveri provisore.

Më 21 të Tetorit 1860 Françesko Krispi shkon në partia pér bashkimin të Italisë, nën sundimin të mbret Vittorio Emanuele II. Më 15 të Nëndorit, 1864 u zgjoth pér të parën herë deputetë në katundi i Siçilisë Kastelvetrano, e hyn pér të parën here zyrtarishtë në Parlementi t'Italisë, teku del me të famshen e thenie: (Monarkia na bashkon, dhe Republika na ndan). E ketu Krispi hiqet prej partise të kryegritjes. Më 1878 hyn pér të parën herë ministër i qevërisë, e pastaj më vonëdy here kryeministrë. Qe i fuqishmë në keto koha: 1887-91-93-96. Françesko Krispi me Politiken e fortë e tje frikesaj Francen, aj bashke me Bismarkun i Germanise judisen, "Tri Lidhjen", Germania, Austria, dhe Italia.

### FRANCESKO KRISPI në çestja Shqipëtarë

Në çestja e politikës Shqipëtarë më 2 të Tetorit 1887, Françesko Krispi me një bashkë-fjalim që pati mbi, çëstjen e Balkanit me Princin German Ottone Bismarke tha: Në qoftë se ndrishime, dot kyhen në qevëria Turke, edhe në keta vjëne me përpara dod miren prej Turkis, gjithë ato dorëzime e ujdisime autonome të visevet drishe, si Maqedonia, Shqipëria, edhe Serbia e vjetër, me themeluar këta Kombe, mbi formën që kanë, Rumania, edhe Bulgaria, dhe tjerë qitete të Balkanit.

Në një banketë qe pati dhene prej parës së tij Qytetit Torino, me 25 te Tetorit 1887, tue me folur mbi politikën

(*Shko numerin i gjashtë*)

Orientale, tha: Atë që kërkojëm ishtë rispekti mbi të drejtata të popullevet, atë që shpresojëm, ishtë që nga dale, nga dalë, për me pasur autonomin e vendit, pa derdhje gjakë.

Krojën në Balkanë katër Kombësi të ndrishme, që do kombësi ka gjuhë me vet, edhe zakonat sekullore, e të vjetra,

rinjë. Nuk ishtë kjo politika me mirë e me nderçme për Italinë!

Më 3. të Shkurtit 1879, me mbajtur fjalë në Parlamenti të Italis, mbi çestien Adriatike tha: Zotenira, unë jam i mendjes qe Pënesula Balkanike mende jetë e themeluar mbi qindrimin të kombësive, me gjidhe sundimin të Turqis, ne Pe-



*Shqipëtarë prej Katundit, Vakarizzo Albanese*

edhe në zëmër kan ndjenjat edhe idhealin, e shpresën të Indipendencës të kombit!

Po mirë keta populle që dishorojën të rrojën si kush do të lirë, këta populle ishtë nivoja; për me ndihmuar, për me fituar vetjen e tyre, pa luftë, pa prishje gjaku, pa me marterixuar njerësh. të

nisula Balkanike; kan mbitrojtur katër kombësi; të cilat, me gjidh të 'qeqiat' përdërtuar për me rrrenuar, u kan mbetur trimërishtë, edhe tue me protestuar kundra egerzivet te mundesit.... Keto kombësi, janë, ajo e Rumenëvet, të Slavëvet, të Shqipëtarëvet, e të Grekëvet....

Cilat jan interesat të Italisë në mbarimë të çëstjes Orientale?....

Zotëni, jemi shum afrë të Penisulës Balkanike, tue me qën vet, ndajtur, prej një deti i gushtë, edhe i vogël, historia na provon që në kohë të motçmë, kur e, do herë emirgeziona e dy Penisulavet, Balkanike, e Italiane, u-ka shkëmbier.

Për shkak politike, edhë për livërti ekonomike, ishtë nivoja që Qevëria jonë nuk mos me lën çëstjen Orientale, e nuk lipset për me lën mos më përpara ushtruar influencën e sajë. Në fati në jipë rastin neve edhë Qevërivet, që s'jona të ken dashurin e livërtisjen për me shkuar triumfin fillimitar, për lirimin të kombëvet, ishtë nivoja për me zën këtë rastë, për me dhën ndihmën e nivoshme për lirimin, e triumfin të këtyre kombësire.

Në rasti të krimtimit për te festuar në Berlini (Germani) shkuamen të Kronprint-it, në moshë më të madhe, Françesko Krispi më 5 të Majit 1900, në gazeta e përditëçme "L'Ora" që botohet në Qyteti Palermo, shkruaiti një artikull, mbi, çëstjen të *trilidhjes*, e të Balkanit, e me teprë për mbi Austrin, shtu thotë për Shqiperin:

Shqipëria nuk ishtë Slave, ishtë një kombë që ka një personalitet me vet, ka gjuhë e zakona me vet, ishtë me kujtuar s'ishtë prej fisit të farës të Pelasgjvet.

E-shtu tue me marë kuptimin, e për me të mbledhur kustin të gjatë e të vjetrë, cilli ishtë aj për me dhën konçesie Shqipërisë, për me proklamuar indipendencën të sajë. Dod jetë një dobi e madhe, ajo për me dashur tue me bashkuan bashkë me viset Slave.

Shqipëria qe ajo që më teprë se ç'dojatrë villet për-mbajti hirjen Turke. Po se në shekulli XV pas vdeqies e ardhur të trimit Shqipëtar Gjergj Kastriotit qe ë mundur, po nuk qe e poshtuar nën heqien të sgjedhjen Turke. Ajo kur qe e sbutuar, e shum Shqipëtare mas me ndejtur nën sundinain të sgjedhjes të mundesit preferuan për me emigruar në Italia Verore, e në Sicili.

Po natyra hekurore të ke-saje farie,

në gjatën shkuari të kohës, nuk humbi prej sojit. Edhë në ky shekull qe e para Shqipëria që doli kryelartë.

Me dhën Krispi përgjegje a tyre njëresh që thoshin se diplomacia të Vienës, kërkonte për me captuar Shqipërin, shtu thotë. TUE me dhën lejë sot Austrisë për me njit Shqipërin, nuk ishtë një fitim për këtë perandori, po dod jet një dëm i madh për Italinë, se shkonte humbjen e ç'do shenjë të sajë në Adriatiku.

Fyemia jonë dod jetë a që të madhe, mbi arsyen e të drejtat tona që lumërishitë traditat të Shejta kemi për-mbajtur, nuk dod mbarohen.

Në 1900, prapë në parlamenti të Italisë deklaroj: "Shqipëria ka dhe ajo tërë elementat për një qevëri Autonomike, më mirë se së atë që nuk patën, Serbia, edhë Bulgaria.

E tue me i dhen, "Qeverimin Autonomik". Europa bunte një veprë qivile.... Në marëveshjet të afrime me dashuri, e miqesi pe pesë shekell për-mbajtur me këtë kombesi, cila afrohet më teprë npeve se imperatorisë Austriake, në ardhë njitia të Shqipërisë me këtë imperatori, kjo dod ket më teprë Shkatarime e trubulime në përzimi i sajvet, e te gjuhevet.

Në 1888. të Shkelqiemit Atdhetarë. Zoti Mehmed Ali Viro, e zoti Abdul Frasheri, me mezuar se Françesko Krispi ishte Shqipëtar i drezesuan një memorandum, mbi çështjen Shqipëtare, memorandum qe gjendur në dukumentat private te Krispit, memorandum ishtë në gjuhe Francese, dhe ishte ky.

Excellence,

Ayant eu l'honneur d'être présentés à Votre Excellence en 1879, à Rome, comme délégués de la nation albanaise pour protester contre l'annexion d'une partie de l'Epire, c'est-à-dire de la Basse Albanie à la Grèce et pour demander à l'Europe civilisée l'intégrité de l'Albanie et l'amélioration de son état, nous prenons la liberté de nous adresser à Votre Excellence pour vous exposer le désir et les sentiments des Albanais.

Nous ne doutons pas que Votre Ex-

cellence a autant d'amour et d'affection pour la mère patrie de ses Aieux que pour l'Italie; aussi l'état et les intérêts de l'Albanie ainsi que le désir et les sentiments de la nation albanaise ne doivent pas Lui être inconnus. Les discours prononcés par Votre Excellence et le politique actuelle du Gouvernement Italien nous donné à comprendre suffisamment que Votre Excellence dans les occasions politiques d'aujourd'hui n'a pas oublié de ranger, auprès les intérêts du grand Etat qu' Elle dirige, les intérêts de la pauvre nation qui se glorifie de savoir que son sang coule dans les veines du plus grand Diplomate et du plus grand Patriote du monde. Intérêts de vie ou de mort, car il s'agit de la résurrection ou du démembrément de l'Albanie.

Nous n'ignorons pas les efforts tentés contre nous par nos voisins qui pour arracher un lambeau de notre pays ne reculent devant aucune intrigue et veulent nier jusqu'à l'existence de l'Albanie et de la nation albanaise.

Mais cette nation est la seule qui ait opposé, pendant longtemps une énergie résistance aux conquérants Turcs.

Cette résistance héroïque s'est maintenue jusqu'à nos jours; et si les Schkipetars par leur caractère fier et belliqueux ne se sont pas laissé subjuger aussi vilement que leur voisins, ce sont eux qui ont senti le plus le fardeau du Jong et ce sont eux qui ont les plus souffert à la suite des insurrections réitérées qu'ils ont été obligés de soutenir pour obtenir leur indépendance, alors que les Grecs, les Bulgares et les autres nations du presqu' île des Balkans, n'avaient pas même conscience de leur existence.

En conséquence l'Albanie mérite l'indépendance plus qu'aucune nation des Balkans, et nous espérons qu'elle se montrera la plus digne de la faveur de l'Europe et la plus capable de se gouverner elle-même.

Les Albanais n'ont jamais cessé de manifester leur mécontentement à l'é-

gard du Gouvernement Ottoman et leur désir pour l'indépendance.

Anjourd'hui même à Kosovo, en Miridite et dans les montagnes de Scutari, Musulmans et Chrétiens sont en pleine révolte.

Nous sommes heureux de voir la question d'Orient prête à être résolue pendant que Votre Excellence est l'un des principaux Diplomates qui dirigent la politique générale, et nous ne doutons pas que ce que nous entendons sur l'avenir de l'Albanie est vraie et n'est dû qu'à ses sollicitations, et soyez sûr, Excellence, que l'Albanie n'oubliera jamais que c'est à Vous qu'elle devra son existence et son indépendance.

Agréez, Excellence, l'assurance du dévouement et de la reconnaissance de vos très humbles serviteurs.

*Mehmed Ali Virio  
Abdul Fraschery*

Costantinople, le 25 Septembre 1888.

P. C. — Le 5 Novembre 1887 j'avais eu l'honneur de Vous adresser une autre lettre, qui, je n'en doute pas, serait parvenue à Votre Excellence.

*Abdul Fraschery*

Si mirë shkonet, Françesko Krispi u-përpoqë fortë shumë pér shpëtimin e lirimin të Shqipërisë; F. Krispi e kiste pér nder të ishte prej farës Shqipëtare, edhe këtë kryelartesi e dashuri, e dëftoj, në gjidhë rastety që u-dhan mbi çështien kombëtare.

Më 17 të Janarit 1898 tue me qën' në Qyteti Palermo, deshi me visitojë Kollegjin Italo-Shqipë, në cili Kollegj Kishte marë mësimet, dyturin, edhi dashurin pér Atdheun të gjishëvet. Françesko Krispi tue me shkuar Kollegjin, e vendet kujtimëtare q'aj në djalëri kish-te shkuar vetjën, kiat prej gezimit, e më përparrë se me shkuar, deshi me nën-shkruar me dorën e vet, në albumi të visetorëvet: "Kami visituar me dhembje shpirti vendin te ku shkova vjetet të djalëris e të edukatës t'yme". Françesko Krispi fliste shum bukur gjuhën Shqipe, edhe shum herë pér qefë bunte ndo vjershë në gjuhë amtare.



Me luftën e Afrikës dhe me humbjen e sajë ardhur me i të Matzit 1896, faj të humbjes ja detëruan Krispit, cili qe luftuar a që fortë ashpërishtë nga politikanët, a që sa qe i-shtrënguar për me lën rrojtjen politike, e shkovi për të rrojtur vetësishtë në Napoli. Françesko Krispi qe një prej më të mbëdhenjtë statistë të Italisë. Nuk ka qënë burrë aqë teprë i luftuar në politikë, cili nuk është burrishtë në gjidhë reziket.

Një ditë në parlamenti të Italisë, Deputeti Onn. D'Arko, itha: "Ti je shum i math për Italinë".

Vdiq në Napoli në 1891, e trupi i tij qe shpur në Qyteti Palermo, dhe në varrimi e tij mori piesë tërë populli i qytetit dhe qenë përfaqesuar katundet Ssqipë të Sicilisë, Piana dei Greçi, Shënta Cristina Gela, Pallazzo Adriano, Kontessa Entellina, e Mezzojuso.

Kufoma qe gurëzuar e varrosur në Kisha Panteon të Shën Domeniko, në cila kishë janë varrosur gjidhë burrat të Shkëlqier të Sicilis. Brënda në kishë i-gritun një fortë i bukur monëmento prej mermëri.

Qyteti Palermo me dash të nderuar burrin i math, në 1905, i griti monëmentë prej brunzi shum fortë, të bukur, monëmenti qe gritur në një prej më të bukura udha të qytetit *Via Libertà*, dhe vendi te ku ishtë monëmenti ishtë emëruar *Piazza Françesko Krispi*, dhe udha prapa *Via Giorgio Castriota*, për me dhën kujtim se Krispi ishte Shqipëtar Krispi, pati edhë gritur një monëmentë në Germani, në qyteti Dresden.

Veprat e shkrimet qe mbeten të Krispit janë keto: "La legge 17 Korrikut 1890", mbi Operat Pie, "Kodice Sanitaro", "La riforma della Polizia e dei costumi", "La legge di Publike Sikurezza", "La legge komunale e Provinçiale". La dhe shume të shkrojtura për mbi mentimet të 40 vjet rrojtje politike, e letër shkëmbimin me Giusepin Mazzinin, e Giusepin Garibaldin.

(1) Botojëm për zotimin e vertetimit mbi vitin të lindjes të Françesko Krispi-t, marë prej kopjes të zotim — pa-

gëzimi, gjëndur prej Priftit të shfatit Ribera, At D. Nikolò Likata, cili zotim se Krispi u-lindu e qe pagëzuar prej një Prifti Shqipëtar vatur prej Katundit Pallazzo Adriano në 1818 e jo në 1819 si thonë disa autore, kjo ishtë kopja orixhnale.

"Anno Domini 1818 Die 6 8 bris Ego Saec. rithus Greci D. Franciscus Alessi Regalis Commende Palatii Adriani, de licentia Rev.mi Parochi, baptizavi infante natum die quarta mensis currentis, hora vigesima quarta circiter, ex D. Thomasa Crispi et D. Josepha Genova, jugalibus, juxta rithum S. Ecclesiae Orientalis, cui nomen impositum Franciscus.

Susceptoribus, D. Baldassare Castelli et D. Maria Anna Gaçto, uxore D. Joannis Gatto.

(2) Kjo ishtë thirria që Françesko Krispi botoj në gazeta "L'Oreto".

*Shqipëtarëvet të Sicilisë, bashkë Kom-bëtari juajë Françesko Krispi-Genova lajmëron.*

Që në gjentilesha Napoli, në shtypesh-kronja "Salvator Rosa", ishtë me pregatitur, e me vun në punë për me shtypur një vjershë Shqipëtare prej Girolamo De Rada, autori i këngës "Milosao" cila ishtë e për — njobur prej botës, edhë ishtë konsidheruar si përfaqesimi orixhinal të një dashurie të fjeshtë e të pastrë e të vërtetë. Kjo vapër e rë ka për emër "Odi Storike di Serafina", kjo veprë ka kushtim përse drishon e kalexon pikturat, e me duar me shpirtë djallesorë, në mestrë të shkonies të jetimit familjar, e nën influencën e kohës e trubulluame e të dashurive qytetare. Fea dashuria, të bashkuara me jetën kalore të "Kohes e Nëmestre", cila përlindi Romantiçismin, atë që gjen në vjershet të Girolamo De Rada, cili përmban zakonat të shtrënguame, e me qyshket bukuore të Spartës a të Atenës.

Për me thënë zana Shqipëtare në vëtëtimi përblyethë me një shpirtë kohat të vjetra e të rea.

Ishtë një letteraturë e rë, cila ishtë në pëlqim për me njobur tërë njerësia Aré-

simtare, që tashi me se kurr në Katundet tane mbretëron rrojtja dashuria e çvtilimi. Në Paris për mbledhjen veprat Polake, në vienë kërkojën me dhën përparimë shkrimëvet të gjuhës Shkiavone.

Po Italia cila bujarishtë ka në tërë

kohat ka për-mbaptur të tretunit të kësaje kombësie, me cilët mbashkë ka ndajtur mëntimet të mbretërimit.

Tashi kam besim se nuk dot me melhonjë për me dhënë mirë-pritjen letteraturrest të biejvet të kombit Shqipëtar.

### KRYE XV

#### SHQIPETARET NË KRYEGRITJA T'ITALISE



Një tok autoritet e Profesorë të Kollegjit Italo-Shqipë në Shen Dimitri Korone (Kalabri)


Kur doli prej popullit, të visëvet t'ITALISË e para frimë lirore, Shqipëtarët u deftua e u rëfyen më të parët e më të flaktit të mprojtes të idhealit i ri, të lirimit. Një prej të parët shqipëtarë që lagu me gjakun i vëtmëtimëvet të idhealit të ri, qe i dëgjuari shqipëtar Prof. Paskuale Baffa, prej Katundi Shënta Sofia d'Epiro, (Kalabri) shkollar i kollegjit Italo-Shqipë në Shën Demetrio Korone, tek'u mori mësimet littérare, dhe idhealin i lartë të lirimit.

Ky njeri qe Prof. i dëgjuar, një prej më të mëdhenjtë Profesorë të Greqishës, të asajë kohë. Pati kathedrë në Universiteti të Qytetit Palermo, të gjuhavet Greko-Latine, qe edhë Profesor të

umanitetit Greko-Latinë, në kollegj ushteriak të Qytetit Napoli. Qe anetarë të akadhemisë, të letterëvet e të diturisë t'asajë kohë. Ky për-mblodhi statiket të shpisë — Shejte, këthej tridhjetë pergamenë të gjetura në kisha mbretërore të qytetit Palermo; Ortak i të famshëmvet Italian Kontit Chesare Galeani-t edhe Matei-t Stanislao.

Ky burrë aqë i urtë e i dyitur, në mëngjes të shekullit 1799, qe i burgosur e i martirizuar nga mbretëria Borbone. Për me qënë vetëm fajtor se kishte marë pjesë në qevëria provizore sgjedhur prej Xheneralit Championnet (1).

Kje marë nga qevëria Borbone e futur ne burg, dhe më pastaj qe i gjëkuar për



vdekie për me qën var në laikut. Pas gjikimit një mik, mos me shkuar vdekur në laik, i dha farmak. Po Paskuale Baffa, falendëroj mikun për dashurinë qe aj deshte, po me një ftohtësi i-tha mikut se Shqipëtari kurr ka frikë nga vdekia. Paskuale Baffa vate në laik me kurajo e filosofi të madhe.

Kur prape hyri qeveria Borbone në mbretëri të Napolit, Kardinali Ruffo për te forcuar mbretërin, organizai shum çeta prej syrgjinëvet. E filoj këto çeta për të ndjekur e frikesuar popullin. Prej këtire çetave qen marë e shpur në burg Shqipëtarët Bianki Kostantino, e Kastrion Antonio nga Kiuti.

Një çetë kusarake e famshme qe formuar kuntra qevërisë prej Shqipëtarit Gaitano Vardarelli, nga fshati Ururi, i cili më përpara kishte qënë ushtar në ushteria e Mbret Murat-it, po me lën ushterin shkoj për në Siçili. Po pas disa kohë që u-mbet në Siçili shkon prap në Kalabri, te ku bashkonet me vëllezërit e tij Xheremia e Gjini, edhe bashkë me tjerë Shqipëtarë formuan një çetë kusarake, prej dyzët njerësh.

Qillimi i kësaje çetie ishte për me shetitër tërë mbretërin, tue me frikesuar e bërë vrasje në të pasurit, e me marë pasurin, e këtëre e me ja dhën fukarenjëvet. Cheta u-bu e famshme me punerat therore. Vardarelli u-bu popullor me veprat e tja trimnore edhe shpirë dashmirie.

Qevëria e Borbonit, u trubulua shumë e kerkoj për me marë masa të repta kundrejtë e Vardarelli-t, edhe mori e dërgoj kundrejtë kësajë shumë ushteri, po ushteria në shum ndeshime që pati me çetat, që vun poshtë. Qevëria prej këtire humbasie, u deshpërua teprë, e kërkonte shkakun si mënt t'iptë funt kësaje, çëstje të rëndë.

Kur qevëria shëkoj se nuk mënti me fuqin qevëritare me poshtuar çetën e Vardarelli-t, ardhi me kondicje paqesore, thote : il Kolleta (Shkrimtar të historis të mbretëris e Napolit) Vardarelli deshte nga qevëria falje të plotë për tërë çetën edhe tue me dhënë rogen si armixherët

të qevërisë. Qevëria pas paqes i dha Vardarellit sundimin për të qeruar mbretërin prej tërë çetavet kusare. Qevëria për disa mot mbajti besën, po pastaj e prishi, e me tradheti bëri të vrasin Vardarellin me disa shokë të tjerë në fshati Ururi. Pas vdekies e Vardarellit, qevëria përdori në çeta prëmtimë gënjeshtare, e urdhuroj çetës për me vatur në kalaja e qytetit Foggia.

Cheta u gënje nga prëmtimet të rrematë qevërisë, e shkoj për në Kalan e Fogjiës.

Kur hyn brenda kalas të qytetit, dolli ushteria e cila ishte fshehur më parë, cila rrëthojoj çetën, komandanti lipi rënien e çetës në dorë të tij. Po Shqipëtarët me gjithë se ishën një grusht njerësh, ju përgjegjënë tradhetimit, tue me zbruzur fishekët mbi ushterin e cila u-pergjig, kundrejtë Shqipëtarëvet. Shqipëtarët luftuan si luanë kundrejtë ushterisë mbretërore, edhë kërkuan për me ikur, po nuk mënte nga shkaku se tërë kalaja ishte e rrëthuar me ushteri, dhe shtu teprësia qe mbijtur në gjak vetëm 17 uzunë robë, dhe të tjerët u vranë. Dy vellëzërt të cilët ranë në dorë të qevërisë u vranë vet njeri pas tjatrit, po edhe qevëria humbi mjaftë ushteri. Eshtë ju dha funt të famshmes çetë të Vardarellit. Koherat vejn tue shkuar, e populli Italianë me teprë vejë tue me sgjuar në idheali përparimetar të lirisë kombëtare. Tue me rarë Napoleone I e bashkë me atë ra influenca e Francës.

Tërë mbretërite e vogla, nga frika rrembejen njerësin lirdashe dhe i futin në burg, njerë sa kishën burgje të bushur, po keto masa të trepta më teprë egërsojën popullin. Nga trazimet të qevëritet u-lindën shumë shoqerira të fshehta të organizuara prej Genovesit Giuseppe Mazzini. Nja nga këto shoqerira kishte për embër "Karbonari". Qevëria e cila trazojë me teprë popullin me mjera barbarizma ishte qevëria e dy Siçilivet, mbretëruar prej Mbret Ferdinandi I të Borbonit. Shqipëtarët të cilët rronin nën zgjedhjen e kësajë qevërie barbare, nuk rinin me kokë unjur

po edhe këta muar piesë në shoqerirat e fshehta, 1843 Përzimetari Shqipëtarë Dominiku Mauro nga Shën Dimitri Korone, ardh-zen e i burgosur për s'ishte kryetar'i një kryegritje organizuar vet për në fshatrat Shqipëtarë. Po me gjith se aj ardh i burgosur, ortakët e tij qe u-mbetin, dhe cilët qene afër një qintë, më 15 të marxit 1844 u gritën e duallën tue me rën pallatit të prefeturës të qytetit Kosenca.

Po qeveria për se shpeiti dërgoj ushteri dhe è mbyti kryegritjen me gjakë, edhe mjafëtë njerëshën muartin robër, e futur në burg, prej këtyre qenë marë edhe Shqipëtarët, Mihal Muzaqio, Emanueli Mashiaro, nga Shën Benedetto Ullano, e të tjerë 47 qytetarë Italianë cilët u gjikuan për vdekie, prej Shqipetarevet cilët qenë edhë gjikuar për vdekje qenë këta: Francesc Giuseppe, Francesc Ferdinandi, Petrasso Françesko, nga Cherzeto, Mashiaro Karlo, Tavolaro Francesco, Bara Vinçenzo, Tavolaro Giuseppe, Manes Gjini, Gaitano Petrossi, nga Shën Benedetto Ullano, Rafail Kamodeka nga Kastroreggio. Me 18 të korrikut të gjithë a tij viti, me urdherim të mbretërisë pëndesa ardhi që për vdekie, ndrishuar për me imbetur tërë rrojtjen ne burg.

Vetën tetëve ju dha pëndesë ndryshore, cilët qenë këta: Dominiku Sarri nga Shën Giakamo Albanese, Gaitani Toçci, Manes Lazaro, e Mihal Chendrone, nga Shën Benedetto Ullano, qen gjikuar për trithiete vjet burg. Josefi Pallera, Rafail Matrangolo, Mihal Matrangolo, nga Cherceto-Albanese, këtyre ju dhanë njëzet-epesë vjet burg. Josefi Petrosi, e Josef Minesetti nga Cherceto-Albanese, i pari ju dhan 6 vjet e te dyti 5 vjet burg.

Në 1844 të qershorit vellezeria Attilio e Emilio Bandiera nga Venezia gënjer prej lajmevet të rrema që ju kishën dhën, e me të mbesar, se Kalabria ishte gati për Kryegritje u nisnë nga Venezia me ortakë për në Kalabri.

Bashkë me vellezerit Bandiera ishën edhë 18 Shqipëtarë prej katundit Shën Benedetto Ullano, të cilët dëshën tue me shpërbler e me liruar ortakët e tyre


që kishën rënë në duart e qevërise, tre muajë përpara.

Ishte edhe baskë me këta Veneziani Gjini Manesse prej familje Shqipëtare që rronin në Venezi. Trupi të vetëdashëvet doli në limani të qytetit Kotrone. Po një shok i tyre Pietro Bokeçiampe nga nisia Korsika, i tradhitoj tue me kalxuar planin qevërisë, e Borbonit, cila me ushteri të madhe rethoj vetëdashurit, në këtë luftë prej ushterisë e vetëdashurit shumë ran të vrarë, dhe të tjerët u zënë robë, dhe shpur në Kosencë, te ku 12 Shqipëtarë bashkë me vellezerit Bandiera qenë gjikuar edhe dhenuar për me vdekur fushekeshuar në valla (lugu) të Rovito, edhe të tjerët qenë gjikuar për rrojtje në cilët ke dhe Gjini Manesse.

Më 15 të majit 1848 ardh e madhia kryegritje në qyteti Napoli, cila qe shuar me shpejtësi nga qevëria mbreterore Lufta, çvile u nis në shumë vise, Prej katundëvet Shqipëtarë, rrodhën shumë vetëdashur tue me bashkuar me kryegritësit, cilat kërkuan për me prerë udhën xheneralit Buzaka në Kampo Tenesse, tue me ju dal përpara. Në kjo luftë ran trimerishtë Shqipëtarët Vinçenco Mauro, e Dimitri Kiodi nga Shën Dimitri Korone, Saverio e Françesko Toçci, nga Shën Kosmo Albanese.

Pas kësajë kryegritje, qevëria u egërsua me teprë, tue me filuar një mbreterrim i rëndë me trazime me ndjekje, për me frikesuar popullin, burgjet i bushi me njerësh, prej 170 njerësh që qenë shpurë në gjikatoret të qytetit Kosenca 40 ishën Shqipëtarë.

Përzimetari Dominiku Mauro qe i gjikuar dy herë për vdekje, një herë në Napoli, e jatrën në Kosenca; Xhenaro Plako nga Chivita, qe i gjikuar për rrojtje, në burg njohë të madhin vjershëtor Luigi Settembrini, me të cilin lidhi mjesi vellezënore. Qenë të gjikuar për një-zet-epese vjete edhe Shqipëtarët, Rafail Kortese, Dominiku Damis, Rafail Vakaro, Paskuali Bilici nga Lungro. Kapparelli Ferdinandi nga Lungro gjikuar për 8 vjete burg. Konforti Oliferno, Miljano Nikodemo nga Shën Ben-



detto Ullano pér nje-zet-epese vjet; Paçe Muzio, Paçe Giuseppe, nga Perçile pér nje-zet-epese vjet; Belici Kostantino, Belici Françesko nga Shën Basili, pér nje-zet-epesë vjet; Baffa Luisi, Baffa Attanasi, Karamone Dominiku, nga Shënta Sofia d'Epiro, pér një-zet-epesë vjet; Dorsa Françesko nga Frashinet, pér nënte-mbedhjetë vjet; Luçi Dominiku nga Specano Albanese, pér një-zet-epese vjet; Kanadë Nikola nga Shën Gjergj Albanese pér nente-mbedhjetë vjet; Tarsia Nikola nga Firmo pér dhjete vjet; Pisarra Nikola nga Shën Dimitri Korone pér dymbedhjet vjet; Macioti Dominiku, e Kiodi Mihalëngjihi nga Shën Dimitri Korone, pér shtate vjet. E shum të tjerë me gjikime të ndrishmë e më të vogëla.

Pas t'rreziguemit të jetës e mbretit Ferdinandit i Borbonit, ardhur në "Kampo di Marte", në Napolit, në 1856 prej studentiti i kollegjit Italo-Shqipë të Shën Dimitri Korone, Axheslao Milano. Mbret Ferdinandi pas t'rreziguame, te jetimit e tij, me teprë u egërsua edha urdhur pér me zënë gjithë liberalët Shqipëtarë si bashkë shkaketarë në vrasia, qen marë Shqipëtarët Attanasi Dramis, Françesko Mashi, Guljelmi Toççi, Orazio Rinaldi, Giuseppe Markianò Euxhenio Konforti, e tjerë. Deshi edhe pér me mbyllur kollegjin Italo-Shqipë në Shën Dimitri Korone, tue me ju dhën fajn këtjë pér me zimet liredashe dhënë djelmërisë, tue me thirrë Kollegjin, "çerdha e shtrigavet, e farka e-dja-jevet".

Kur në 1848 Sicilia u-grit kuntra mbretërimit barbarë pérderuar prej qevërisë të mbret Ferdinandi i Borbonevet. E më teprë qyteti i Palermos, cili u-grit më 12 Janarit, në cila kryegritje pushuan poshtë qëvërinë Borbone, me proklamuar qevëri me vet, tue me sgjedhur pér kryetarë liberalin *Ruggiero Settimi*.

Nëkëtë kohë Shqipëtarët të katundit Piana dei Greçi, kishën pérberë (formuar) komitetë të fshehta kuntra qevërisë, me pasur marëveshje me komitetet të Palermos, komitetet ishën kryesua prej Shqipëtarëvet lirëdashjes, Josefi

Stassi pérthënë Barrakasa, e Natahi Kamarda, të cilët qënë sbuar prej qevërisë. I pari shkoj në Livorno ku vate u bashkua me tjere lidashë, e i dyti shkoj ngjekte. Komiteti ishte i-perbërë prej këtire Shqipëtarë, Spilidoni Petta, inxh. Agr. Josefi Karnesi, Kal. Gjergj Zalapi. Notari Josefi Karnesi cili qe marë prej qevërisë e mbyllur në kalaja e Palermos. Notari Donisi Massi, Gjergj Piediskalzi, Françesko Alesi cili qe marë e vun ne burg, e shum të tjerë, këta me trupe të organizuara muarti pjese në kryegritja ardhur më 12 të Janarit në Palermo.

Në 1849 qënë sbuar prej qevërisë Shqipëtarët Notari Josefi Karnesi, avv. Gjini Sulli, cilët qën të shrënguar me i-kur prej Siçilisë.

Në 1860 prapë Shqipëtarët të Katundi Piana dei Greçi, kur degiuau se Garibaldi kishte me ardhur me vetëdashur pér me liruar Siçilin, prapë përbën komitete me dhën kryesin Baronit Françesko Petta pér thënë çikarelli, nën kryetar Dr. Gaitano Sklafani, komitet Notar Josefi Karnesi, Josefi Stassi, avv. Gjini Sulli, avv. Petro Piediskalzi, inxh. Gjini Karnesi, Kal. Gjergj Zalapi, cili pastaj qe major te gardëvet (ruasit) kombetare, Josefi Kamarda shkrimtar i fortë i shum veprave Shqipe, Notari Donisi Massi, Luisi Kuççia, vëllezëria Josefi Dimitri e Gjini Milaco, Bartolomeo Kurtisi, Serafini Lo Greko, Haspani Filpi, Shaveri Saluto. Gjithë këta u-mbetin vratë në një luftë që ngjau në mestrë trupet, afrë fshatit Shënta Kristina-Gela.

Përsimitari Palermitan Rosolino Pilo mirtë pjesë në mbledhjet e komitetet e tij të fshehta të Shqipëtarëvet në Piana dei Greçi. Pér lojmetar të komitatet kishën sgjedhur Shqipëtarin Ndriza Soldano, i cili mjaftë herë rrezigoj jetën e vet, pér me shërbyer çeshtjes.

Kur në 1860 më 27 të majit Xhenerali Giuseppe Garibaldi hiri e zaptoj qytetit te Palermo, e shkoj pér në Katundi Piana dei Greçi, pér më vatur prapa ushturis mbretirore, populli intejasimuar (*Shko numerin i gjashtë*)

trupe u-përbën nën Kryesin e Barunit Françesko Petta, avv. Petro Piediskalzi. Në këto trupe muarën anë Shqipëtarët, avv. Gjini Sulli, Gjini Karnesi, cili pastaj u-vra në lufta e fortë në mestre të vetëdashurevet urdheruar prej Xheneralit Giuseppe Garibaldi, me ushterin mbretore të Borbonit perposhë Kapua, Prof. Josefi Beniçi, i cili pastaj u-bë ndihmetari ushteriak, i Xheneralit Nino Bixio, Gjini Beniçi, Josefi Dorëngriqia

Mandalà, Josef Gervasi, Gjini Virga, Françesko Di Giuseppe, për-thënë nasuni. Dimitri Karnesi Dorankriqia. Te gjithë nga katundi Piana dei Greçi.

Në një luftë të repte të vetëdashëvet në 1860 në udhë të Katundit Monreale, afrë qytetit Palermo me ushterin mbretore, qen vrarë bashkë më përzimetarit Palermitan Rosolino Pilo, avv. Pietri Piediskalci, Françesko Di Giuseppe, i plagosur, e avv. Gjini Sulli qe marë



*Priftë Shqipëtar prej Kalabrie, me gjithë familjen.*

për mi thenë roçi, Josefi Dorëngriqia pér mi thene naskarini, Gjergj Kristiano, Gjergj Vodusi, Nini Stassi, Gjergj Kuççia, Françesko Kuççia, Stefani Grafeo, cili u-vra në luftë në 1860 në Palermo, Vito Grafeo pér mi thënë kahili, Josefi Kuççia, Luigi Kuççia, Salvaturi Norçja, Françesko Karnesi, cili pastaj qe bërë ispektor i ruazvet pylltare, Domiani Karnesi, Gjergj Grafeo, Ndrica Soldano, lajmetari i komitetevet, e pastaj i ushtarëndihmes i Rosolino Pilo, Serafini Lo Greko, Lorenci Struholo, cili pastaj shkoj bashkë me Xheralin Giuseppe Garibaldi në nisia Kaprera, Filipi Parrino, Haspani Filpi, Josef Barbato, Spizieri Vartuhi

robër e gjikuar pér vdekje, po me kurajo iku prej burgut. Edhe Shqipëtarët të tjerve 'e fshatrave Shqipë 'muarti pjesë me shumë vetëdashur, si Mikkelangelo Barone nga Mezzojuso cili ishte organizuar një trup te madhe te vetedashive, elet luftuan trimërishtë në hiria e Garibaldit në Palermo. Edhe Palazzo Adriano, Kontessa Entellina, e Shënta Kristina Gela, lëftuan trimërisht pér shpetimin e lirimin e Sicilisë, pér me bashkuar tok me gjithe viset t'Italisë.

Xheneral G. Garibaldi falënderoj Shqipëtarët pér trimërinë e tyre e destnair në gjithë luftat. Pas që ushteria mbretore ishte forte e humbur në 1860, të

ku humbi luftat tē mëdha tē Kalatafimi-ni, Palermo, e Milazzo, Xheneral G. Garibaldi me ushterin tē vetëdashëve, shkoj nē Kalabri. Xënasit tē kollegjit Italo-Shqipë tē Shën Dimitri Korone, kur dëgjuan se Garibaldi ishte nē Kalabri, të-rë shkuan vetëdashjes nën urdherimn e kryemesonjesit tē kollegjit Prof. Mar-kianò. Për gjithë fshatra shqipë tē Kalabris rrodhën Shqipëtarë vetëdashur, cilët pér-bënë një tabor me vet prej 500 njerësh, urdhruar prej kolonelit Josefi Pace nga Perçile e dhe tē tjerë nën urdhurin e majorit Thanasi Dramis. Këta pastaj u bashkuan me vetëdashurit e Kolonelit Françesko Sprovieri, e tē vellain Vinçenzo nga Akri.

Shqipëtarët rëfyhen trimëri iroike nē luftat tē mëdha tē Kapua e Volturno. Xhenerali Giuseppe Garibaldi i kënaqyr prej trimërit. tē Shqipëtarëvet tē def-tuar, mbajti fjalë tē mirë pér ata. E kur zaptuan qytetin Napoli, qevëria proviso-re qe formuar prej tre Shqipetarëve Françesko Krispi, Paskali Skura, e L. Giura. Garibaldi pas qe hyri nē Napoli e mori nē dorë qevërimin pér me njojur shërbimet trimërore, deftuar prej Shqi-

pëtarëve nē çeshtjen tē rilindjes e bash-kimit t'ITALISÉ, nē qyteti Kaserta Xhenerali Garibaldi dërgoj këtë urdhurim.

### ITALIA E VITTORIO EMANUELE

Dittatori i Italise meridionale, pér me kujtuar shërbimet qe i dhanë çështjes kombëtare trimat dashmorë Shqipëtarë, *Urdhuron*. Tue me dhënë funt nevojat e luftës e u themëluar Italia me *Vittorio Emanuele*. Arka e pasurisë tē qytetit Napoli, dot paguanjë me shpejtësi një sumë prej dymbedhjete dukatë pér tē madhuar Kollegjin Italo-Shqipë tē Shënt Adriano.

Un'e vë nën kujdesjen e kombit, dhe tē miresinë e Suveranit pér me dhënë urdhurime përparishtë.

Kaserta, 20 Totorit 1860.

*Giuseppe Garibaldi*

(1) Championnet qe një i famshë Xheneral Francese, cili nē 1799 me luftë fitoj mbreterin e Napolit, tue me resua poshtë qevërine e Borbonevet, tue me proklamuar "Republikën Partenopea".

### KRYE XVI

### AXHISLAO MILANO

*O jibujarshmi Exhislao Milano  
Kur ç'do herë tē mentojmë e tē  
(naltësojmë).*

Matteo R. Imbriani

Axhislao Milano, u lind nē fshati Shqip tē Kalabrisë Shën Benedetto Ul-lano, nē 1830, prej përsimëtarit Gabriele Milano (1), e Madalena Russo. Në dja-leri qe vun pér me marë mesimet nē Kol-legj Italo-Shqipë nē Shën Dimitri Korone, nē cili edhe mori mëntimet lirëda-shje.

Në 1856 djalë i ri prej njëzet-ekatrë vjetë, vate u radhua ushtar i vëtdashjes

pér me ndruar një vella tē tij, cilit i ngiste ushtarleku (2).

Qe i vun nē radha e tē shtatës kompani, e nē i treti battaljon kaçiatore (gjitorë) i këmbesisë. E pas pak kohë shpet mori gradhin prej kaporali. I lodhur nga tē keqjat, e trazimet, prej qevërisë Bor-bone, nē populli, mëntonte si mënte me ngjetur rastin, pér me liruar, populli, edhe njerësinë lirëdashje futur nē bur-gjet prej egërsirës me fytyre njeriu tē Mbret Ferdinand II i dy Siçilivet. Më 8 tē dhietorit 1856, Axhislao Milano dhuroj tē madhin shpirt tē tij pér mbi Altarin tē gjalim dhe lirimin t'ITALISÉ. Në dita

8 të dhjetorit, Mbret Ferdinand II ishte në *Kampo di Marte* në Napoli, për me ruar e me shkojë rivistën ushtériake.

Axhislao Milano, kur i shkonte përparrë Mbreti, i ardhë për se bashk njëherie mëntimi, se ishtë çasti për me liruar popullin prej këtij mbreti e me dërguar shpirtin e tij në pisë.

Axhislao ishtë në a treta radhë të ushterisë, e kur mbreti ju afrua afrë, ngriti pushkën e armatosur me bojanetë (kor-dhe e vogel) e i bje mbretit ne gji, po, për fat të keq, nuk e plagosi nga shkaku se mbret Ferdinand II, nga frika rinte i armatosur me koraze hekuri.

Ofiserët kur shkuan mbretin në rrezik shpet e rrrotulan, edhe tjerë shpejti muartini Axhislaon dhe nga inati e rahin trimin, e pastaj e shpijen në burk.

Kur qe qehur përparrë keshillës luftëre ushteriake për me qënë i gjikuar, i pjetën për cilin shkak kërkoj për me vrarë mbretin, Axhislao ju përgjig: Më ardhë mëntimi në dita që ky ardhë i pas besë, në dita që tradhetoj popullin, tue ju marë të Drejitat, përsë ky ropi trupin të kombit, përsë vravi pa ndo një fajë atin t'ím, edhe turperaj familjent'ime.

Në cila shoqeri e fesht ëje anetarë? Në as një.

Kush janë artakët tate?

Nuk janë më teprë se tre.

Me çudi tërë hapën syt, cilët janë?

*Shpirti, zemera e krahe t'ím:* Thotë Axhislao. Gjakëtar i poshtre: Thirri me inate gjikatesi, dy ty se je përparrë Këshillit luftetar, e që me një dorë shtrëngonë rrojtjen tënde?

Unë nuk shohë në juve se vet burra me uniforma, të shitur *trupë* e *shpirtë*, thotë Axhislao me ftohtesi. Si gjikatesit t'ím ju përposhonjë, përsë nuk ruanjë jetën. Krye-gjikati tue me kuqur njerësy, ugre me këzitur dorën në triesa, i urdhuroj me qetur. Pas improjetimit të avvokatit i Axhislout, gjikatesit e dhu-nuan për vdekie, me lajkë, si njeri tradhitor e at vrasie.

Më përparrë se me qehur për në laikë, një Xheneral Shqipëtar, nën sundimin e qeverisë Borbone, i qojtor Dimitri Leka, vate e gjeti në burg Axhislaon, dhe tue me ju fjalosur shqip, kërkoj më parë me fjalë të buta për me konfesuar, cilët ishën shkaket, që e shtrënguan për me bërë këtë marresi tue me vrarë atin e popullit.

Axhislao Milano ju përgjig në gjuhë amtare, edhë i thotë; se aji nuk kishte as një shkak, po i vetemi shkakë, ështe për me liruar popullin nga barbarisma, dhe egërsirat të mbretërisë Borbone.

Pas gjikimit të trimin i denuar prej keshillës luftetare. Me ditën 13 të shenëndreut 1856, jashta portës Kapuana në Napoli qe i ngritur kanopi për të varrur trimin besnik.

Axhislao Milano mveshur me robën e të denuarvet, e me këmbë zbathur, e me mjë kartë vënë në gji tek ku ishte shkruar "*Aturasie*". Vate në kanopë kryelartë, edhë me ftohtesi të madhe.

E më përparrë me njur kryet në kanopë, thirri popullit me sa zë që kishte "*Rroftë liria e popullvet, rroftë Italia*".

Këto qen fjalët e fundit të ketji trimi Shqipëtar, cili dha rrojetien për shpëtim t'Italisë.

### Shënimë

(1) Gabriele Milano, ati i axhislaoit që një i flaktë përsimetar kundra mbreterisë Borbone, shumë hërë, qeveria Borbone e ndoki edhe e futi në burg. E në funt kur në 1844 qe kryegritia në Kosenzë Kalabri, policia e Borbonit, me gjithë se ishte i zemur, mori e vravi, e ndjeki familjen.

(2) Në kohat që imbreteronte qeveria Borbone një vella mënde vente ushtar, për njatrë vella.



## KRYE XVII

I PARI KUVEND PËR GJUHËN SHQIPE PREJ SHQIPËTAREVET  
T'ITALISË.

I pari kuvend që unis prej popullit Shqipëtar t'italisë, zyrtarishtë qe përbajtj në katundi Koriliano-Kalabro. Pas mjaft thirrje e zëdhenje të zjarta, prej tē pa vdekurit atdhetar Prof. Girolamo De Rada, mbledhja qe mbajtj në dhomat tē mbedha tē Shkolles e lartë Xhinasio Galipoli në tē parën ditë tē tetorit 1895.

Katunde Shqipë tē Kalabrise cilët qenë përfaqesuar prej këtyre zoteneve. At Luisi Landa, nga Greçi (Avelino) Teologj Prof. Gerardo Konforti, nga Greçi; Ancelmo Lorequio, e Kapedani tē ushterise Italiane Luisi Lorequio, nga Palagorio. (Katanzaro) Kal. Prof. Girolamo De Rada, nga Maqia-Albanese; Dominiku-Antoni Markese, nga Maqia-Albanese; Luisi Petta nga Maqia-Albanese; Dott. At. Angelo Ferrari, nga Frashineto (Kosenza).

Arçip. Benardi Bilotta, nga Frashineto; Notari Alesandri Dorsa, nga Frashineto; Arçip. Petro Kamodeka, nga Kastroregj; Dr. Dominiku Manjelli, nga Shën Kosmo-Albanese; Josefi Noçito, nga Spezano-Albanese; Françesko-Saverio Toççi, nga Shën Kosmo-Albanese; Gjini-Ndreka Toççi, nga Shën Kosmo-Albanese; Prof. Akile Toççi, nga Spezano-Albanese; Avv. Salvaturi Kasiano-Ribeko, nga Spezano-Albanese; Arçip. Antonio Argondiza, nga Shën Gjergj-Albanese; Nazario Lonigro, nga Ternova di Polino (Kosenza); Notari Luisi Frega, nga civita Salvaturi Liguori nga Shën Dimitri Korone; Antonio Skura, nga Vakarizzo-Albanese; Françesko Dragoshi, nga Koriljano-Kalabro; dhe Prof. Josefi Jorizzo, cili rronte në qyteti Akri, edhe shume tē tjere.

Sala ishte e stolisur me flamure Shqipë edhe Italianë, në mestrë tē salës mbretë ronte nje fytirë tē Skënder-bent.

Mbledhja qe hapur prej kryetarit provisor Z. Prof. G. De Rada, cili pas që falenderoj tē ardhemit në kuvendi, nisi fialen në gjuhë amtare "Shqipe", me një formë oratori tē bukur. D:ftoj qellimin tē kuvendit, edhe foli mbi pikat trimërore tē popullit Sqipëtar, që nē ç'do pikë — pamje t'istorisë ka bërë veprat tē çuditeshme, po tē historianët kan lën nē erësirë veprat trimerore tē kombit Sqipëtar. Idha funt fjalimit dyke thënë. Neve *Shqipetarët t'italisë*, cilët rrojem nē një vent te lirë e tē qyteteruar, kemi më teprë dëtyrën tē dëstojëm e tē drithëzojëm përpara botës e qyteteruar veprat trimerore tē historisë tē kombit Shqipëtar. Fundi i fjalës qe pritur me duar trokitje e me thirje tē flakta, *Rrof-te, Rrof-te Shqiperia*.

Po pas mjaftë bisidimesh ardhë nē përfundim, që më përpara se tē gjitha, ishte nevoja pér me zgjedhur një pleqesi zyrtare pér me reguluar kuvendin. E me vota tē përgjitheshme, qenë zjedhur pér kryetar Prof. G. De Rada; shkronjes G. A. Toççi, silët shpejti muar zyrën. Kryetari hapi mbledhjen zyrtarishtë, tue me dhën leje sekretarit pér liçit, letrat tē dërguara prej tē mos arhesit nē kuvendë. Zoti G. A. Toççi liçiti këto letra e telegraama, dërguar prej ketyre Zoteneve, cilet bashkoneshin nē puna e kuvendit. Z. Zorojanni Effendi, konsul Turk nē Bari; Prof. Josefi Shqirò, nga katundi Piana dei Greçi (Sicili); Arçipräfti At Stefan Varipapa; Kal. Federiku Ferriolo; Prof. Alberto Stratigò; Kal. Gjini Damis, Z. Beniamino Posteraro; Z. Josefi Parapunja; Prof. Vinçenzo Lusi; Avv. Françesko Loreqio; Z. Karmine Greko; Zoti Rafail Prato, Z-i Z-i Antonio Berardi; Z-i Donato Morelli; Z-i Karmine Ferraro; Dr. Françesko-Saverio Lamen-gó; Prof. Vinçenzo Pagano; Edhe De-

puteti i Parlamentit t'Italisë Konti d'Alife; e shume të tjerë. Dërguar telegramë, me urime përparimtare edhë tërë kryekatundaret të katundëvet Shqipë t'Italisë.

Pas të lëcëties të letrave e telegramëve, kryetari Z-i G. De Rada, falendero-

bjite të Shqiperisë kalore e trimerore, fjalet e fundit qen të mbluara prej të fortë trokitje duarishit.

Pas shume bisidimesh kuvendimet ardhën në mareveshje për me dërguar telegramë L. M. T. Mbretit Umberto I t'Italisë; kryeministri t'Italisë, Shqipetar



*Shqipetare prej Kalabrie.*

ne përparasiti e kuvendit edhe ata që dërguan bashkimë. Në këtë çastë, hyn një komision prej katundit i kuvendit, Korigliano-Kalabro. Komisiona ishte i përfaqesuar e kryesuar prej Profesorit Luigi Patari, cili pati një e bukur mirëpritje, cili me fjalë të bukura më përpara falenderonë Shqipëtarët për të bukurën mirëpritje, pastaj falenderon zyrtarist nga ana e katundit, cili pati nderin të ishte i pari të ndërohejë prej një kuendi me qillime të Larta, falenderonë të

prej Italisë zoti Françesko Krispi, Ministrit t'arisimit Zotit Guido Baçcelli, edhe Konsulit Turk në Bari Zoti Zoriojanni Effendi.

*Telegramet që u derguan qenë këta  
Mbret t'Italisë,  
Madhesisë e tje Umberto I.*

— Kuvendi i gjuhese Shqipëtare, mbledhur në Korigliano-Kalabro, nje dalldij emëron protektimin të Madhesisë juajë.

Kryetari: *G. De Rada*



*A. S. E. Françesko Krispi,  
Krye Ministrë,*

— Kuvendi Shqipetar i gjuhes Shqipe, mbledhur në Koriljano-Kalabro, juliçiti si më ishkelqyeri bir i Kollonivet Shqipetare, Kryetar të nderit, me shpresë të kemi perkrahje morale për arisimin tënë.

Kryetari: *G. De Rada*

*Ministri G. Baçcelli, Roma,*

— Kuvendi, gjuhetar Shqipetar, mbledhur në Koriljano-Kalabro, kërkon të lartëmen ndihmë tuajë, për përparimin të gjuhës-tonë.

Kryetari: *G. De Rada*

*Z-i Zorojanni, Bari,*

— Kuvendi gjuhetar i Shqipëtarëvet, falenderon Zoterin tuajë, për përkrahjen dashmore, e për përparimin të arisimit tonë.

Kryetari: *G. De Rada*

Në dita e dyite e mbledhjes, u kuvendua për me formuar një shoqeri *fjesht Kombëtare Shqipetare*. Pas shum bisedimesh, u formua resoluta e kanunoria, te cilat sekretari leçiti përparrë popullit, kjo ishtë kanunoria.

Nja. I. Të filuarit e një shoqerie komitetare Shqipetare:

- Për të ujdisur një Abetarë Shqip.
- Për me formuar një fjaletorë.
- Për me botuar një gazetë Italo-Shqipë.
- Për me hapur e marë marëveshje me Mëmën Shqiperi.

Nja. II. Shoqeria të ket qendrën në Shën Dimitri Korone, edhe të jetë e qeverisur prej një keshil direktë, formuar prej një kryetari, një nen kryetar, një sekretar, një Arketar, e tetë pleq.

Pas ardhia zgjedhia e zyrtarevet e Shoqerisë Kombëtare Shqipëtarë, cilet qenë keta zotërinj. Kryetar i nderit Shkelqelqysia e tij krye-ministri Italisë z-i Françesko Krispi; Kryetar Prof. Girolamo De Rada, nen kryetarë z-i Petro

Kamodeka, nga Shën Dimitri Korone, z-i Luisi Landa; edhe kalori Anselmo Loreqio; i shkronjes Prof. Akile Toççi, Arketar Zoti Salvaturi Liguori. Pleqesi Zoterinjtë Benardi Bilotta; Prof. Gerardi Konforti; Dr. Angelo Ferrari; Dr. Agostino Ribeko; Dr. Vinzenzo Frega; Kal. Pali Muriqio; Lorenzo Skutari; Prof. Angelo Marini; Qe edhe zgjedhur nje komisionë për me për me filluar, për me ujdisur një fjalëtorë të gjuhës Shqipe, komisiona qe zgjedhur prej këtire zotërinj. Z-i Luisi Laudo; Petro Kamodeka; Notar Luisi Frega; Kal. Gjini Damis; Prof. Gerardo Konforti; Arçiprifi Benardi Bilotta; Z-i Orazio Kapparelli; Z-i Aleksandri Dorsa; z-i Angelo Belushi; z-i Antonio Bruno; z-i Gjini Kapparelli; Prof. Alberto Stratigò; z-i Alberto De Luka.

Shollejimi për me dhenë emerin i Gazetës qe ky. emër. "Yll'i Arbreshëvet". Në dita e fundit të kuvendi, ardhën në zyra këta telegramë cilet qen të liçitur prej sekretarit.

Monza, 3 Tetor 1895

M. E. Mbreti, Falenderon këtë kuvend, për deshurin e mentimet qe me trefeni për fillimin e puneve tuaje.

Ministri i shtepire Mbreterore,  
Tenente Xhenerale,  
*Ponzio Vaglia.*

Ministero Roma, 3 Tetor 1895

Gezonem me juve qe kinë hapur kuvendin, e jam i per gjidheve i përnjohjes, për nderin qe me dhatë. *Shqipëtar, prej gjakë e prej zëmëre!* unë gëzenem teprë, për këtë fillim, me shpresë që dot jetë i nevojshmë për historin e qevërimin Shqipetar, edhe një e madhe përhapje Aresimi.

*Françesko Krispi.*

Keto pak radhë per mbajen tërë dashurin që i madhi statiste kishte për kombesinë e tijë. Me këta përfundime, u mbyll i pari kuvend i gjuhës Shqipe, ne Koriljano-Kalabaro.

## KRYE XVIII.

## KUVENDI I SHOQERISZ KOMBETARE SHQIPETARE

Shoqeria Kombetare Shqipetare nën kryesin e kalorit Uff. Anselmo Loreqio kishte urdhuruar dalien e një gazetë Shqipe, per te improjtur të drejtat te kombit Shqipetar përparrë botës.

Në një 1897 në moj të janarit doli në dritë në Pallogorio-Katanzaro, nën dreqesimin e Kal. Uff. Anselmo Loreqio. Gazeta Shqipe nën emërin "La Nazione Albanese" me thenien "Shqiperia Perpara".

Kuvendi i dyte përbajtura nga Shqipetaret t'Italisë, për përparimin e çështjes Shqipetare, si edhe për aresimin, që përbajtura në Katundi Shqipe të Kalabrise, Lungro, me 20 te Shkurtit 1897. Ne ky kuvend mori pjesë atdhetari Shqipetar Zoti Pandel F. Evangjel, Kryetari i Shoqerisë kombëtare të Bukareshtit (Rumani) si edhe disa Shqipetare prej Austrie, edhe Shqipetarofilia austriake zonja Baronesë Giuseppina Knorr.

Në të parën ditë të mbledhjes, u shollëgjna më përparrë të me dërguar telegramë kryetarit të nderit, krye-ministrin Françesko Krispi, e pastaj edhe për tërë gazetat.

Ne dita e dytë qenë zgjedhur zyrtaret e rinjë për Shoqerinë Kombetare Shqipetare, cilet qenë këta zotërinj.

Kryetar Kal. Uff. Anselmo Loreqio, nën-kryetar Kal. Luisi Landa, sekretar Kal. Gjini Damis, arketar Prof. Kamilo Vakaro, Pleksi, Zoti Josefi Aronne, Dr. Rafail Korrado, Prof. Françesko Kington; Prof. Kostantini Bellushi. Pas që zyrtaret e rinjë muarën vendin, kryetari Zoti Kal. Anselmo Loreqio, më përparrë falenderoj gjindje, ardhur në kuvendë, edhe i falenderoj për barrën e rendë që i dhan, tue thënë, këtë barrë cilën kam shpres; me përkrahjen tuajë, të bush qellimin i shejte, për cilin sot jemi këtë të mbledhur.

Pastaj shkojnë në bisidime për çëstjen

e abetarit me përdorimin i përgjishmë, edhe për botimin e një fjaletori, si edhe për me kerkuar nga qeveria Italiane e hapjen të një shkolle Shqipe në Istituti Orientale të qytetit Napoli, si edhe njojhen zyrtare prej qeverise Italiane të giuhën Shqipe. U bisedua për me përhapur, një marë veshje me gjith vellezerit Shqipetarë të Shqiperisë, të Rumanise, e të Misirit, për një bashk punim, për pre-gatitjen, arisintare, e lirore të Shqipërisë.

Për çëstjen e Abetarit, ardhë në përfundim për me përdorur Abetarin me shkronja Latinë. Për botimin e fjalëtorit ja lan në dorë komisionës e zgjedhur në i pari kuvend, për mbi çëstjen e shkolles Shqipe, u zgjoth një komision për me pranuar e vun në vepërim punën e shkolles, s'edhe përnjohjen nga ana e qeverisë gjuhën Shqipë zyrtare.


Për marë veshjet me tërë atdhetaret në e para e majit 1897, komisiona e zgjedhur prej Shoqerisë Kombetare, botoj e dërgoj një lajmerin thirrje, për në tërë anët ku ishën vellezër Shqipetarë prej të cilës qiarkëtore botojem shtyllat me të nёvoshime.

*Vellezer të Shqipërisë*

Sa jemi Shqipetarë në botë jemi të gjithë prej një gjak, e një farë, fjalose mi tërë një gjuhë, kemi të gjith ato trashegjime, dhe ato dëshira.

Kush ju thot juve vellezer të Epitet, se jini Grekë? Ky emërim për juve ishtë një turpërim të gjakut jonë bujar.

E juve që lëpë-mbani qetesimin për shpëtimin, të atirëve mëntime të trashegjmëtarevet tanë, cilët vdknë tue me luf-tuar një qintë herë për idhealin, e përvet qeverimin e lirimin të mëmdheut i dashur jonë. Për neve ishtë tashi nivoja për një bashkim i përgjishme, për ne ç'do vent që ndodhemi të botës, në duam verteta Shpëtimin e mëmës Shqipëri.



## KRYE XIX.

FILLIMI I TË PARËS SHOQERI KOMBETARE  
NË QYTETI PALERMO

Pas një zëdhënie prej një komiteti Shqipëtarë, cili komitet kishte qënë i filuar prej zotit Kal. Françesko Musaqia, prej katundit Shënta Kristina Gela, më 13 të korrikut 1902 në shtepia e Shqipëtarit nga katundi Piana dei Greçi, z-i Rosolino Ferranti, në cillat dhoma u mbledhën e vun të parin gurë e themilit për një shoqeri Kombetare, prej kolonivet Shqipëtarë të Sicilis.

Dhoma e madhe të palatit të zotit R. Ferranti ishte mbushur me Shqipetarë të dëgjuar, në mbledhja muartine piese, edhe Shqipëtarët prej Kalabrie. Zoti Kal. Federiko Ferriolo, krye-gjikat e të Lartës Kortë të qytetit Palermo, edhë kapedani i ushterisë Italiane z-i Milano, se edhë Shqipetarofili kapedan, komm. E. Portal, autori të një biografi mbi katudin Biankavilla, në Provinca të Katania, në cila biografi dëftون me dokumenta se aj katundë qe themeluar prej nje trupë Shqipetarësh kryesuar prej kapedanit Chesare Masi.

Hapi mbledhjen z-i Kal. Françesko Musaqia, i cili dëftoj nëvojat për një shoqeri kombetare Shqipetare. Për më dëftuar se Shqipetarët të Sicilisë kurr s'kan mbetur prapa në tërë çëstjet atdhesore, edhe thotë; sot ky bashkin është teprë i nevojsnimë përsë ajo gjuhë e cila ka qënë monumenti i prindëvet tanë, ajo gjuhë që na ka mprojtur për pesë shekuj e na ka dhënë përnjohje si komb i huajë në ky i dyti atdhe, është për me humbasur? Shekoni vellezer katundet Mezzojuso, e Maxaro, edhe të tjera benda kesajë nisie, cilat kan humbur farë. Edhe neve po mos marim ato masa që duhen, dal nga dal monementi i pëlqehur njer me sot prej trashegimitarëvet tanë, dot rëzohet farë. Qellimi jinë o! vellezer ishtë për me filluar këtë shoqeri, ishtë për me bashkuar fuqin e gjith Shqipetarëvet të Sicilis, gjer me sot të përndara,

ishtë qellini i Shejte për me grejtur (sal-vuar) gjuhën Shqipe, tue me përihapur shkolla në katundet tanë për me të mesuar djemvet të rii gjuhen amtare, e tue me dhën një përparim literatyres, për me qën gati në çasti që atdhen të fitonjë *"lirin e independentecën e vet."*

Ishtë nivoja për të bëre një marëveshje me vellezirit tanë brënda në Shqipëri, si edhe me ata që janë përndar për tërë viset e botës, për të pasur një bashkëpunim, për me preqatitur "*"lirin e independentecën"*" të Attheut, fjalët e fundit u mbaruan me fortë trokitje duarshë, edhe me thirrje rroftë, rroftë, Shqipëria!....

Pas mori fjalën sekretari he-për-he z-i Dr. Gaitani Ferrara, i cili leciti tërë punën që kish bëre komiteti he-për-he, që në kohë të fillimit, gjer ditën e mbledhjes, për çëstjen e Shqipetarëvet të Sicilisë.

Pastaj mori fjalën Kal. Gjergj Magjakamo i cili leciti memorandumin përbërë prej komitetit provisor për me ja përparaqitur (presentuar) Ministrit të arisimit Onn. Nunzio Nasi; s'edhe ministrit të brendeshme Onn. Giovanni Giolitti.

Memorandumi dëftonte deshirën e Shqipetarëvet për me patur themeluar një katedrë të literaturës Shqipe në universiteti, edhe në kollegj Italo-Shqipë të qytetit Palermo.

Pastaj mer fjalën Shqipetari prej Kalabrie.

Krye-gjikatesi te Lartes Kortë të qytetit Palermo Kal. Ferriolo, i cili truan (rakomandim) për memorandën që të jetë jo vet për Shqipetarët e Sicilis, po edhe për ata të Kalabrisë. Kapedani i ushterise z-i Milano, çfaq deshirën që qendra e shoqerisë të ishtë në qyteti Palermo, i cili përbante Shqipetarë prej tërë katundet shqipë të Sicilisë. Pas shu-

(*Sko numerin i tetë*)

më tjerë bisidime për mbi themellimin e shoqerisë hapet çëstja e zyrtarevet, të cillit me vota të për-gjishme u-zgjodhën, Kryetar z-i Kal. Françesko Musaqia, nën kryetarë z-i Kal. Uff. Gjergj Magjakkamo, edhe z-i Dr. Gaitani Ferrara-Gandolfo, pleqesi, Prof. Girolamo Franko, Avv. Françesko Lojakano Saladino, Avv. Kristoforo Masi, Avv. Salvaturi Dara-Krispi, Sekretar. Avv. Ernesto Sartorio, Arketar Zoti Françesko Musaqia-Mistreta. Për kryetar i nderit u-

*Kal. Françesko Musaqia  
Palermo.*

Chirkolo çivil, Piana dei Greçi mer anë ne bashkimin e Shqipetarevet të Sicilisë, tue me deshiruar që kjo shoqeri me mëntime të larta, me qellin për lirin e për independencën e Memedheut.

Përlidhje shkëmbimi miqësore ne mesë të Italisë e Shqiperisë, Kemi zgjedhur për delegat për të na përfaqesonjë Dr. Gjinin Sqirò.

Kryetari: *Gjergj Stasi*



Fusha e Arbreshëvet (Piana dei Greçi) Udha qentrore Gjergj Castriota

zgjoth ish Ministri i aresimit, e dhe deputet të parlamentit të Italisë Onn. Finoqiaro Aprile.

Pas të zgjedhurit e zyrtarevet këta muartin vendimin zyrtarishtë. Sekretari këndon letrat e katundevet Shqipë cilet dërguar bashkë punimin e tyre në tërë shollëgjimet kombetare të Shoqerisë, cilët qenë, Piana dei Greçi, Kontesa Entellina, Palazzo Adriano, Shënta Kristina Gela, e Mezzojuso.

U leçiti një telegram dërguar për përkrahje e bashkim prej shoqerisë të katundit Piana dei Greçi. (Chirkolo dei çivil).

U leçiti edhe një letrë dërguar nga Shoqeria e Katundit Shqipë Palazzo Adriano.

"Chirkolo Skanderbeg", Palazzo Adriano, mbledhur për kuvendin, nën Kryesin e Zotit Vinzenzo Dara-Mankuso, në përhapia e bisidimevet, mer fjalën z-i avv. Alessi, i cili fillon fjalën, tue me pergëzuar nga thepli i zemer, për shkoniën e përparimetare të çëstjes kombetare, aqë të fortë deshiruar të zëmerës e tij, dëshirë injaftë herë e dy ftuara me artikulla për në shtypi i vendit. Thote: Neve Shqipëtarët e Sicilisë, kemi gjith ata mëntime që kanë vellezerit tanë të

kalabrisë, vet nuk kemi një marëveshje për një bashkëpunim. Po themellimi i një shoqerie në qyteti Palermo, cili ishtë krye-qyteti i nisise, edhe krye-provincës, në ku bashkonen tërë katundet Shqipë. Kjo qendër ishtë i vetimi vent për me përhapur në populli ndjenjat atdhesare, e për me pasur mareveshje me vellezerit tanë të Memedheut.

Për këtë qellim të shejtë i falemi nde-rit themellonjesit të komitetit Kombetar, e më teprë punitorit i palodhur zotit Kal. Françesko Musaqia. Me deshira e urime shpresore për me dalë faqe bardhë, në pun-nisje për shpëtimin të Memdheut. Letra binte shum nëneshkrime, edhe kiske nënshkrimin e Hiresisë e tij Gjini Barçia, Piskope i Krojës (Shqiperi). U leçit edhe një letre prej Princit Aladro Kastriota, s'edhe një fytyrë e tij me këtë nënshkrim.

*Perëndia bashkë me nee  
Shoqerisë Shqipetare të Sicilisë  
Për kujtim miqesi.*

Paris, 14-6-1902.

*Ghani.*

Pas leçtiturit të letravet u shkua në bizetim e proponua për me dërguar një telegram kryetarit i nderit, ish Ministri Onn. Finoqiaro Aprile. U bizedua për me zgjedhur edhe tjerë kryetare të nderit, e me zera të përgjishme u zgjodhën për kryetare te nderit, Kal. Prof. Giro-lamo De Rada, e Kal. Uff: Anselmo Loregio, e Kal. Prof. Josefi Sqirò.

Pastaj u shtruan bisidimet, për me ujdisur kanunoren e Shoqerisë, e pas shumë bisidimesh u vendos kanunoria.

*Kanunoria*

I) Për të ruajtur të drejtat që kanë pasur Kollonit Shqipëtarë të Sicilisë.

## KRYE XX

### ISMAIL QEMAL BEY VLORA N'ITALI.

Në Maj të vitit 1909, Ismail Qemal bey Vlora, e Xhafer Effendi Mbreshtani. Në udhetimin e tyre n'Itali, vizituan edhe kryeqytetin e Sicilis Palermo, e

2) Për me përhapur gjuhën Shqipe, edhe më teprë në ato Kollonira që janë për me humbasur gjuhën.

3) Nevoja për një abetare i pervet, për me këpetuar me gjith Shqipëtaret.

4) Për me themeluar një arkivë (libreri) të aresimit Shqip, edhe të botohen mentimet të shejta të atdheut, edhe tue me shkelqyer historinë kombetare.

5) Nevoja për një thirrje, në për të terat Shoqerit Shqipëtare, të Kalabrisë, të Napolit, të Korfuzit, t'Athenës, t'Egyptit, të Stambolit, të Bukarestit, s'edhe të Sofjes.

Telegrama cila ju dergua kryetarit të nderit, ish Ministri Onn. Finoqiaro Aprile.

*Onn. Deputato Finoqiaro Aprile,  
Roma.*

Shoqeria e Shqipëtarevet të Sicilis, sot e themeluar, proklamon Z. T. Kryetar i nderit, tue me kërkuar mirë-dashjen e mirë-njohjen tuajë për me mprojtor interesat e kollonivet tona.

*Kryetari: F. Musaqia  
Ish Ministri përgjigjet  
Kal. Françesko Musaqia  
Palermo.*

Falenderonj nga thelp'i zemer këtë shoqeri Shqipëtare të Sicilisë, e jam teprë i gëzuar e nderuar për bashkpunimin, për qellim bujar për të cilin ishtë themeluar.

*Finoqiaro Aprile*  
Eshtu pati dhën funt i pari kuvend fillimetar të Shqipëtarëvet të Sicilisë. Me themeluar Shoqerin Kombetare Shqipëtare, cila Shoqeri, ka dhen shembime të medha çëstje kombetare, cila Shoqeri u-ka mbetur trimerishtë gjer diten e sotme.

zun dhomë për prëhje në Hotel Centrale, në udha Korso Vittorio Emanuele. Ardhja në kryeqytetin të nisise e të çkëlqyret Atdhetarë Shqipëtarë,

u bë e njohur në e madhja Kolloni Shqipëtarë, e bërë prej Shqipëtarë lindur prej Katundevet Shqipë rrotull të qytetit Palermo. Edhe i pari Shqipëtar që shkoj për me vizituar të përnjohurit burra që Zoti Kal. Françesko Musaqia Kryetari i Shoqerisë Shqipëtare të Siçilisë *Lidhja Kombëtare Shqipëtare*, cili me gjëzim të math i përshtendoj edhe i uroi mirë ardhjen e tyre në mestrë të vëllazërevet Shqipëtarë të Siçilisë, të cilat kishën rastin e fatin të mirë për me bashkuar përtë parën herë, pas më teprë se 400 vjetë të përpinqeshin me dy vëllezër të çkëlqyer të Atdheut Shqipëri.

Ismail Qemali, e Xhajafer Effendi, me kanaqesi të madhe mirë pritën të gjëzuar falenderuan për urimet e vizitën që i bëri i flakti Atdhetar Zoti Kal. Françesko Musaqia, me të cilin mjaftë bisiduan përtë mbi çëstjen, si edhe për nivojat të Shqipërisë.

Kal. Françesko Musaqia ju dëftoj çkëlqyesis tyre, tërë punën për interesat kombëtare që kishte bërë *Shoqëria Kombëtare Shqipëtare*, që në kohë të fillimit të sajë.

Ismail Qemali imbeti teprë i kënaqyr prej veprëvavet e dyshirat Kombëtare të Shqipëtarëvet të Siçilisë, e nga thelli i zëmër falenderoj kryetarin, e me baskë anetaret të Shoqerisë, për ndjenjat atdhesore, e të nalta për kombësin e tyre.

Zoti F. Musaqia invitoj çkëlqyesën e tyre, për me bërë një vizitë katundit Shqipëtar, Piana dei Greçi, në cili ishte një preqatitje për një mbledhje të Shoqerisë, për mi çëstjen Kombëtare Shqipëtare.

Të dy Atdhetarët me gjëzim axemptuan, e falenderuan zotin F. Musaqia për nderin e rastin dhën për me mbushur dyshirat e vet, cilat ishën për vezituar katundet Shqipë. Zoti F. Musaqia shpet lajmëroj në kollonia Shqipëtare ndodhjen në qytet të dy vëllezërevet Shqipëtarë të Shqipërisë.

Kur tërë paresia Shqipëtare cila rronte natë qytet, dygjoji lajmen gazmore me shpejtesi vrapiuan, për me vizituar të dy burrat të çkëlqyer të Shqiperisë.

Për tërë ditën në Hotel që një vaturardhje prej Shqipëtarësh për me pasur nderin përvizituar e nderuar edhe bashkuar dy burrat e Shqipërisë.

Ismail Qemali, e Effendi Mbreshtani, u-çuditën për shëmbëlimin atdhesore i dëftuar prej Sikulo-Shqipëtarë, e falenderuan gjith vizitorët për ndjenjat kombëtare, e mirepritjen e dashurin e dëftuar. E se aj ishte mjaftë i kanaqyr dhe i lumtë për me ndodhur në mestrë vellezërevet Shqipëtarë të Siçilisë.

Në Katundi Shqip Piana dei Greçi, pas një telegrami që kishte dërguar zoti F. Musaqia zyrtanshtë nga ana të *Shoqerisë Kombëtare Shqipëtare*, paresisë bujare të Katundit këta filluan tue me preqatitur mirepritje për me nderuar të dy çkëlqeyermit Atdhetarë Shqipëtarë.

Chëllqyelqyesia e tyre Ismail Qemal bey Vlora, e Xhajafer Effendi Mbreshtani, bashk me zotin Kal. Françesko Musaqia edhe zyrtarët të Shoqerisë Kombëtare Shqipëtarë, s'edhe shumë tjerë bujare Shqipëtare, u nisen për në Palermo, per me shkuar në Katundi Piana dei Greçi në mëngjes të 19 te Mait 1903, me shume Korroca (Araba). Në mestrë të Shumisës të Shqipëtarevet që përseljen dy Atdhetaret, njohëm. Këta Zotenira. *Avv. Saverio Masi* deputet i parlamenti Italianë, *Prof. Stassi-Petta* Director të shkollavet mbretërore teknike Kagini, të qytetit Palermo, *Avv. Josefi Kamalò, Kal. Gjergj Maxhiakamo*, zoti *Gaitan Ferranti*, *Avv. Ferriolo* kryeqykatës të Naltës Kortë të qytetit Palermo, *Dr. Matteo Xhenusa*, *Dr. Gaitan Ferrara-Gandolfo*, *Prof. Girolamo Franco*, *Avv. Françesko Lojakano-Saladino*, *Avv. Kristofaro Masi*, *Avv. Salvaturi Dara-Krispi*, *Avv. Ernesto Sartorio*, Zoti Françesko Musaqia-Mistretta, At *Gaitan Petrotta*, e shum te tjerë.

Populli i katundit Piana dei Greçi, kishte dalë jashtë katundit, me flamure Shqipë edhe Italianë, me bandën muzikale Katundare (1) për me pritur ardhjen e të çkëlqyervet Shqipëtarë një vent i përthënë Shën Meria e Boshit.



Bashkë me popullin ishën tërë Shoqeritë të Katundit me flamuret e tyre, Shoquerite ishën Këto. *Cirkolo dei Cibili, Shoqeria Agrikola, Klubi Skënderbeu, Cirkolo Socialista*, banda loste Kënga Kombetare. Kur për se largu u-panë Karrocat, populli me zë të fortë, thiri rroftë Shqipëria. Kur Karrocat u afruan muzika lojti ymnin Shqipëtarë, e pas ymnin Italian. Populli si karrocat u afruan e njohi të dy Atdhetarët të cilët ishën në e para karrocë, thriti, Rroftë Shqipëria, Rrofshin vëllezërit tanë Shqipëtarë.

Zotenitë e tyre, Ismail Qemali, e Xhajafer Effendi falenderonin popullin dyke nxjerë shapkat, (Kapelat) e dyke derdhur lotë nga gëzimi. Muzika udhetonte përpara, e populli u për-nda në dy krahtë të udhës, e karrocat në mestrë popullit, ishtë tue me kenduar kenga popullore u nisën pée në katundë. Kur Karrocat hjinë brenda në katundi, dy Atdhetaret i priti një çuditje, përsë shkuan gjera të paharuame, gjith balkona e dritsoret ishën të stolisur me bukuri të madhe, e mbreterojnë bojlat kombëtare, balkonat e dritsoret ishën të mbushur me zonja, të cilat tue me shtur lule mbi karrocat e me thirë, Kroftë Shqipëria, Rrofshin Vëllezërit tanë të Shqipërisë. Ismail Qemali me lotë në sy e me zëmërin prej gëzimit falejë popullit, kur karrocat arrinë në shtëpia të Zotit Kal. Gjergj Zalapi ishën bushur me lule.

Zoti Kalor Gjergj Zalapi priste në derë të ardhëmen e bashknjereves (tevabi) kur çkelqyeqyesia e tyre zbritën prej karrocavet, Zoti G. Zalapi, uroj dy atdhetarvet mir-ardhjen në mestrë të popullit Shqipë t'Italianë.

Hjinë brenda në dhomat të bukurë e stolisura, muarti prehje në dhoma e madhe te ku ishte preqatitur një darkë për ndër të Ismail Qemalit, në darkë mori anë tërë paresia të katundit, edhe kleri.

Pas darkës u-mba mbledhja e *Shoqerisë Kombëtare Shkënder-beu*, në cila mbledhje u bisiduan gjer e gjatë rrifforma gënjeshtare të Turqis urdhuruar nga Rusia, e Austria, e që ato rrifforma nuk

kan të bëjen me *Kongresin i Berlinit*. E që rrifformat të dashura prej këtyre qeverira janë shumë të demçme, dhe të cilat kane qellim prishien e Shqipërisë, tuë me lindur një pseudo Maqedhoni e tue me këptur më të mirat vise, si Kosovën, Monastirin, bashkë me një miljone e gjumëzë shpirtëra, lulja mbi lulja e popullit Shqipëtar, tue me ja dhene Slavevet.

Edhe u-fjalua se Shqipëtarët, nuk duajnë farë humbjen të Turqis, për të cilën kan prishur gjakun e tyre për me përmbar këtë Imperatori, po vetem kërkojën ato të drejta të cilat janë njohëra në sinisi i Balkanevet, tue me dhën Shqipërisë një administrat Autonomike.

Që në Turqia kishte për me humbasur nën mestrë të marrësivët e gabimevet e saja, nuk lipset neve Shqipëtarët të humbjëm e të qajmë gabimet e saja.

U bisedua çështja e Italisë cila edhe ajo ishte në rrëzikë në Shqipëria humbaste, me hyrjen e Slavevet në Adriatik, të cilët Slavë janë të parët ruajsit të Panslavismes. U solligjua për me dhënë kurajo, e me ndihmuar moralishtë dhe materialishët, me propagandë për me mbajtur në zgjimë Shqipëtarët në c'do vend të botës që janë, këtë barrë ju dha "Shoqerise Kombëtare Skenderbeu" të qytetit Palermo.

Cila donte të mirte masat, e për me interesuar për me mbledhur arxhet të duhura, e me vun në praktik programin të-çëstjes Kombëtare për me dhën atë përparrim që ishtë i nivojshmë.

Pas dhën fund mbledhjes, Zotenitë e tyre Ismail Qemali e Xhajafer Effendi, shkuan për me vizituar sinakun (Kryekatundarin). Si dualën jashtë nga Palazi i Zotit G. Zalapi. Ku i priste populli me muzikën katundare drejtusuar prej Atdhetarit Prof. Gjergj Sqirò, cila bandë si shkoj Ismailin luajti ymnin Shqipë edhe pastaj a të Italian. Populli me zërë të fortë thriste Rroftë Rroftë Shqipëria, e tue me përcjelle të dy Atdhetaret në gjith vizitat.

Më përpara vizituan Sindakum, pas shkuan për me vizetuar Shoqeritë.

*Chirkolo dei Chivili, Chirkolo Skanderberg, Soċietà Agrikola*, e me nē funtë vizituan Atdhetaren e flaktë Zonjën Sqirò, mema e tē degjuarit Atdhetar, Shkrimtar e vjershëtor Shqipëtar Zoti Prof. Josefi Sqirò, e cila priti tē dy Atdhetaret me nderime tē nalta. Po cu-

Te dy tē nderçmit burra, falenderuan popullin pér mirpritjen, e pér Atdhetarismi tē flakte tē kesajë kollonje. Pastaj muartin karrocat pér me shkuar prapë nē Palermo, Populli, me muzikën, tue me kenduar kënga kombëtare percoli dy Atdhetaret gjer jashta katundit.



*Priftë Shqipëtar*

dia me madhe tē Ismail Qemalit, qe kur Zonja Shqirò i pérparaqiti dysà Vasha Shqipëtare veshur me robat me tē bu-kura tē zakonës Shqipëtare tē Katundit. Zotenite e tyre Ismail Qemali e Xhafer Effendi, shumë fortë tē kanaqur e tē gëzuar pér Atdhetarismen e Kombëtare dëftuar prej Zonjës Shqirò tue me pas kujdesin pér me ruar relikuat Kombëtare.

(1) Banda muzikale, tē Katundit Pianina dei Greçi, ka qënë një prej mëtëmirevet tē qarkut tē e Provincës Palermo. Fitoj shum Konkursa muzikale, edhe ishte e thirë pér Krimtimet që do beshin pér nē Katunde Sicilian. Qe evetema bandë qe lojti ymnin Shqipëtar, edhe shume Kenga Shqipë tē muzikuara.



## KRYE XXI.

## PIANA DEI GRECI

Kolonia Shqipëtare e Siçilsë *Fusha e Arbreshëvet*, pa drejtesi e thirrë edhë e përnjohur nën emërin i pa drejtë "Piana dei Greçi". Gjografikët e shkrimtarët të shekulit XVIII, thirrën ë shkruan, fjalën *Greçi*, prej shkakut e *Fesë Ortodoxe*, e përdorër prej Shqipëtarëvet (1).

Kjo Koloni mban lark qytetit Palermo 24 kilometra, e lindet nga leshnjani të këtji bukur kryeqyteti të Nisise e Siçilise. Edhë mbahet sypër kodrinavet të *Shkumbit* e *Sheshi*, të cilët ndadhen përposhë malëvet *Pizzuta*, e *Saravuli*, të cilët me lidhjen e tyre, përbëjnë, e të thënës, *La valle dell'Inferno* (Lugimi i Pizezës) (Ferrës), e të lumit *Gjoni*, i cili perhinë e pérndan Katundin, e vete bashkonet me lumin *Striti*, e tue me rrjedhur del në Krahina *Xhaferria*, e me shty brenda në e madhja bukur-shkonie panoramike e rrafshinës *Fusha*, e cila ishtë e mbushur me vreshta e me pemë.

Në *Fusha* ishtë lumi *Beliçë*, cili a tje ka rrojtje për me rrjedhur për në brigjet të papërduruane e të pa mënduare të shkretës, *Honi*, në mestrë të rrizikuamet shkajë të malëvet, *Kometa* e *Malanuçë*, (Arra-eligë), i cili tue me rrjedhur, largohet e pas një udhetim i mënduashmë afrohet afrë Katundit *Shaka*, e del për me vatur të zbrazet në deti *Afrikanë*.

Ky Katundë qe i themeluar në 1488, me lejën e Krye-Kishës Katolike të Katundi Monriale.

Lejë e dhënë të nderçmevet e Bujare familje Shqipëtare: Ales, Barbato, Brusari, Burleshi, Bua, Kalimëni, Kaliva, Kamalò, Kamizi, Karnesi, Kësesi, Chiulla, Kleshiri, Kostantini, Kuça, Dorangriqja, Dragotta, Golemi, Guzzetta, Jpsari, Lazi, Makalusi, Mandalà, Masi, Matranga, Musaqa, Parrino, Petta, Reres, Rio-lo, Shklizzi, Sqirò, Sklifò, Sirqa, Stassi, Suli, Zalapi, edhe shume të tjera.

Vendësit e këtje Katundi, përbajën me dashuri të madhe njer me sot gjuhën

e zakonat Shqipëtare, edhe jan Krye-lartë të emërohen Arbreshë.

Kjo koloni për-mban dy Kisha Familië. Një në Fenë Ortodoxe me priftarinjë Shqipëtarë, cilët me shojën në gjuhë Greke, po gjith tjerët sherbime të kishës, përdërojën gjuhën Shqipe.

Për kryetar të Fesë njohjën: Shejtësin e ty Papën i Romës. Kisha Familie Katolike u themëlua pas shumë kohë, përsë kishën me shkuar me rrojtur dy sa familje katolike në katundi, këto familje shkuan se kishën nivojën për një kishë me vet. Edhe kurkuau lejë për me gritur një kishë katolike. Kjo kishë qe ethemeluar në shekuli XVII, me emërin *Shën Viti*.

Kolonia Shqipëtare *Fusha e Arbreshëvet*, ka qënë dhe ishtë kolonia me Lartë në ndjanjat kombëtare. Kjo koloni ka nderuar e dritesuar në ç'do kohë emërin madheshtorë Shqipëtar. Kjo koloni cila ishtë me madhja e të pesave koloni Shqipëtare rrëth qytetit Palermo.

Per-mban 12.000 shpirtera, kjo koloni ka dhenë gjindje shumë të Chkëlqyer njerësh, të cilët me mëndësin e dytërin, e urtësin e tyre kanë nderuar e naltezuar emërin Shqipëtar, dot shënojëne më të vjerit, cilët janë keta:

Hiresia e tji Piskopi Stassi, i emënar Piskopë i Lampasko, Hiresia e tji Guzzetta Piskope e Lampasko, At Gjergj Guzzetta, themelonjesi i veprëvet, të Kollegjit Italo-Shqipë në qyteti Palermo, të shpis-lutjes te Filippinëvet në Katundi Piana, e të Kollegjit i vashëvet Shqipëtare në Katundi Piana, At Serafini Guzzetta, At Gjergj Matranga, protopapa te dy anëvet, e të dy Ritevet Ortodoxe-Katolike, të Katundit Piana, At Petro Matranga, i famshë arkeologë, e sekretarë i Bibliotekës të Vatikanit në Romë, i bashkë pënonjës me Kardinalin Mai, At Dimitri Kamarda, autore i shumë veprave, edhe një gramatoloxhi bashkë me historin të Shqiperisë, në

gjuhë Shqipë, edhe Arkimandritë të kishës Ortodoxe të qytetit Livorno, At Kola Kamarda profesorë të letteraturës Greke në Unëversiteti të qytetit Palermo, icili këtheu veprat të *Tuçiditit*, e të *Teokritit*, edhe shumë tjera vepra. Françesko Saluto gjikat i famshë e autorë i shemë veprëve gjiktare, Gaitani Sklafani eqim i famshë, Konti Gaspare Manzoni gjikat i Chkëlqyer, Gjini Maria Kostantini, vjershëtor e gjikat, e djgjuar, i cili shkruati në gjuhe Italiane veprën vjershëtore, "Il Kolombao d'Italia", Fusha e Arbreshëvet ose Piana dei Greçi, ka një Kollegj me emërin *Shën Meria*, ky Kollegj ishtë për edukatën, e stërvitjen, e vashëve Shqipëtarë. Ky Kollegj ka qënë dhe ishtë *Vatra e djeba* e Atdhetarismës Kombëtare, përsë vashat që atje marëjën mëzimet, janë të mëzuara, në gjuha, e dashuria Kombëtare, në zakonat, e në virtutat të familjës (2).

Ky katundë përmban shumë Kisha Shqipe, cilat të janë e emërohen. Shën Meria Ethitries, e cila ishtë ethemëluar në bythë të malit Pizzuta (3). Shën Dimitri Krijekisha e cila ishtë mjaftë e madhe, edhe ishtë cougrafizur prej të madhit Piktori *Pietro Novelli*. Shën Gjergj e cila ishte lidhur me shpi-lutjen e Filipinëvet. Shën Meria e cila ishtë lidhur me kollegjin i vasheve. Shën Gjoni edhe kjo ka piktura të Pietro Novelli. Shën Koli, e cila ishtë lidhur me monastirin të Kalogjerevet, Shën Nikola Tolentino di Bari. Te Patri edhe kjo kishë ishtë lidhur me Monastir (4). Shën Meria e Rusanit, edhe shumë të tjera më të vogla, të gjitha këto kisha përderonen prej klerit S hqipë. Katolikët kan vet Kishën Shën Viti, e tashi më vonë i kan thënë edhe Kishën e Shën Kolit. Ishtë për me kujtuar se Kolonia *Fusha e Arbreshëvet*, dha një ndihmë e madhe, për lirin e Independencën Italiane.

Në kjo koloni qe e para livizie e çëstjes Kombëtare Shqipëtarë. Prej gjindjes të sajë kolonie u-bë e u-themëluar Shoqeria me ndjenjat të larta Atdhesore, *Lidhja Kombëtare Skënderbeu*. Kjo shoqeri ka luftuar burrisht e trimerisht

për çëstjen Shqiptare, ka përdëruar gjith mëmirat për me fituar opinionin publik të Europës, e me teprë atë t'Italisë. Kjo shoqeri ka mbajtur Konferenca, kan botuar artikula për gjith shtypin t'Italisë, memorandumi qeverivet alliate. Ka përfutur dashurin në populli për Shqiperin, kjo koloni ka punuar edhe punon për të mirën e Shqiperisë, gjer sa fitoj emërimin, *Korça e Shqipetarevet t'Italisë*. Në lufta e madhe e përbotëshme "Fusha e Arbreshëvet qe qentra e livizjes të çëstjes Kombëtare, nën kryesin shoqerin. "Lidhja Kombëtare Skënder-beu, kryesuar prej të flakti e të palodhurit Atdhetar Kal. Avv. Gjergj Maxhiakamo, i ndhihuar e Krahuruar prej të ziarti nacionalistë Shqipëtar Prof. Thoma Karnesi Russotto, sekretari i Lidhjes.


Nuk shkon shumë kohë e kolonia "Fusha e Arbreshëvet dot bënët një qytete shum fortë i bukur, përsë *Fusha* dot ndrishohet, e në ajo dot bënët një *Kënat* e madhe për të mbledhur ujerat të gjith qarkut të Katundit.

Në kjo *Kënatë* dot svilupohet fuqia edhe energjja eletrike, për me udhetuar trenat. *Kënata* do tjet e madhe për 9000 metra katrë-kjoshe. Katundi vjen lidhur edhe prej një udhuhekuri, e cila dot nisi prej qytetit Palermo.

### Shënime

(1) Kur në të parat kohë Shqipëtarët emigruan n'Itali. Ishën të njobura vet prej populli Fea Greko-Latine, Me besuar Shqipëtarët në Ritin të Fesë Ortodoxe qenë prej popullit Siçilian shkëmbjer për Grekë, gabimi i emërit vjen nga ana e Fese, e jo nga kombesia.

(2) Janë vashat të këtji Kollegj qe janë e qëndizëën flamurin, i math, që zonjat Shqipëtarë të Katundit Piana, kan me falur qevërisë Shqipëtarë, në kongresi që dot mbahet në prindvere në Shqiperi, prej Italo-Shqipëtarëvet. Ky flamur dot falet ditën e kuvendit prej zonjëvet qevërisë Shqipëtarë, përkujtim dashurie, efat-hardhezin, e lumtesin



të Shqipëris, për me ket fituar *Lilir e Independencën*.

(3) Kjo kishë qe e para, ose e para shpi që u-grit prej Shqiptarëvet në kohën që emigruan, e në ato vise, kur muartin prëhje. Shqipëtarët kishën, sjetur bashkë një pikture Shejtare e cila ishtë kjo Shën-Mëri emëruar *Ethiitrjes*. Shqipëtarët ishën shumë besnikë kësajë Shëmëllëshe, përse thoshë s'ekishte shpëtuar në shumë rresike. Kjo pikture ishtë

edhe, sot, edhe ishtë i vetimi kujtimë historikë.

(4) Në ky Monastir Kalogjerët, qenë hequr në 1860 kur hiri Garibaldi në Sicili. Sot ishtë Shpi-prëhje për pëleqët të varfrë të Katundit. Në kjo shpi-prëhje u-mbet për shumë kohë si kryetar amindistratës një Shqipëtar Shokodran për emër Agustini, i cili ishte jikur prej Shqipërie.

## KRYE XXII.

### SHËTİM KOMITETASHË

Pas filimit të "Shoqerisë Kombëtare" të qytetit Palermo, e ardhia në mestë Italo-Shqipëtarevet, të Atdhetarevet Ismail Qemal bey Vlora, e Xhajafer Effendi Mbreshtani, u ndezi me tepër flakën Atdhesore në Arbreshët.

Në për Katunde Shqipë të Sicilisë, u për-hap një zgjim filimesh shoqerie e nën komite, si në katundet, Palazzo Adriano, Mezzojuso, Piana dei Greçi, e Kontessa Entellina. Pas një artikull të botuar të gazeta Austrofile *Il Popolo Romano*, në cili artikull shaje e kritikojë çëstjen Shqipëtare, e Shqipëtaret, tue me thënë se kur në këta njerës mund të formojën një çëstje Kombëtare, pse nuk kanë ndjenjat, e mentimet për me formuar një vëtdje, dhe nga këto shkake nuk mund të jenë të zotërit të formojën opinionin (mëntimin) e publikit European.

Po thotë artikullshkronjasë *Mëndimi për një Shqipëri të lirë, ishtë vet në mëndjet të marra të Shqipëtarëvet të Katundit Piana dei Greçi*.

Ky artikull, aqë teper i ashpër, çuditit Kollonin Shqipëtare të katundit të Pianës dei Greçi, të cilit me 25 të Majit 1903 mbajtin një mbledhje protestimi kundra gjuhës të ashprë përdoruar tek ajo gazetë.

Mbledhja qe mbajtur në e madhja odhë të "Chirkolo Sozialista". Mitingua e hapi Zoti Dr. Gjini Sqirò, i cili me vjershë oratori mbajti fjalim mjafte të bu-

kur mbi Shipërin, dhe trimërin e Shqipëtarëvet, e tue me përgënjeshtruar shkrimitarin të artikullit botuar në *Il Popolo Romano*, i cili dot ket qënë i gënjer prej armiqevet të Shqipëtarëvet. Tue thënë se çëstja Shqipëtare nuk mbetet vet në mëndjet tona të këtë katundi, po ishtë e përhapur në tërë mëndjet të Shqipëtarëvet, Neve Shqipëtarët e kësajë kollonie, *nuk jemi mendjemarrë si thotë Zoti Shkrimitar*, po kemi një dashuri të lartë, për kombin e shtërgjyshëvet tanë, të cilit vdiknë në rrobëri.

Neve duam që një popull trim e kalor të ket edhe aj vent në mestë popullivet të çivilizuar, dhe i jep funt fjalës tue me thirur *Rroftë, Rroftë, Liria e Indipendenca Shqipëtare, përposhë rroberia, e barbarisma*. Fjala e fundit u prit prej popullit me duar trokitje, e tërë gjindja thiri me njezë *Kroftë Shqipëria*.

Pas mori fjalën Zoti Trifon Guidera sekretari i "Chirkolit Sozialista", cili me fjalë të bukura, e të zjarta dëftoj historin e Shqipëtarëvet që në kohë të vjetëra gjer më sot.

Tue shënuar koherat më trimerore thotë Shqipëria tepre herë ka dalë nga errësia, tue drituzuar botën me burra të Çkëlqyer, si Pirron, i cili la famë trimerore tue me luftuar Romanët, Skënderbeu, i cili qe thirur nga Papa, Championi i Krishtesimit i cili me punët trimërore mbajti përparimin e barbarit. Eméri i Gjergjit Kastriotit, përbleth në zëmërat (*Sko numerin i nënde*)

e Shqipëtarëvet, më të madhin ideal. Ky emër i shejtë e lartë, mban tërë ato gjera me të shenuara në një komb. Dashurin, Vellazerin, Fenë, Kombësi, Bashkim. E me këtë emër në buzë Shqipëtari dotë jepë gjakun e shpirtin, për lirin e independentencën Shipëtare. Fjalët e fundit qenë kuroreuan me duar trokitje, dhe me thirje rrroftë Shqiperia.

tet për me punuar e pranuar çëstjen kombetare Shqipëtare. Në mbledhje muartin pjesë anetarët e "Chirkolit Skënder-beu", e mbledhja qe hapur nga atdhetari i flaktë Zoti Françesko Lojakanano, cili përfaqesonte kolloninë Shqipëtare e qytetit Palermo. Zotenia e ti foli mbi nevojat e kombit Shqipëtar, cili rron në sklaveri, e në rrrobërin të qevërisë bar-



Në themelimi të Kishës Shën Marie në 1644, në Piana dei Greçi, u sol brënda në kishë me Krimtime të madhe sytira mërakulore Shën Marie ë Dhritries që Shqipëtaret sualën nga Shqipëria në 1488.

*Kjo pikturë qe urdhuruar prej Kontit D. Federiku Manzoni qytetar të Katundit Piana dei Greçi në 1814.*

Pas mjaftë bizetimesh u përfundua, për me dërguar një protestim gazetës *Il Popolo Romano* edhe për me formuar një komitet për me imprejtur të drejtat, nderin, e emërin, Shqipëtar.

Në mbledhja qenë zgjedhur një kryetar e një sekretar provizorë. Zoti Dr. Gjini Sqirò kryetar, e Zoti Trifon Guidera sekretar. Mbledhja ju dhapërfundim më zëré thirje: *Rroftë independencia Shqipëtare*.

Më 4 të Gjunit 1903, në Katundi Shqipë Kontessa Entellina, u fillua një komi-

bare Turke; e që dëtyra e ç'do Kollonie Shqipëtare ishtë për të mprojtur, e me punuar e shpëtuar vëllezërit e tyre nga durimi i rro-beris, tue me i dhenë ndihmën e nivojsime për me fituar lirinë, e deshuruar shume. Neve lipset të i thomi botës e qyteterur, se jemi një komb trim i cili kërkon të drejtat për me dalë dhe neve si të tjerët kombe në dritë. Muaratin sjalë dhe të tjerë oratorë, të cilat folën gjith mbi çëstjen atdhesore.

Pas shumë bizetimesh u zgjodhë një komitet i formuar prej ketire zoteneve:

Kryetar Zoti Prof. Alexandro Sqirò, n n Kryetar Zoti Salvaturi Lojakano, arketar At Josefi Kassisi, sekretar Zoti Nndrek Parrino, Plegesi Zoti Luka Sqirò, Zoti Fran esko Lojakano, Zoti Teodhor Kissesi, Zoti Josefi Musaqia, Zoti Gjini Fa-

ta, Zoti Luisi Xhenovese, Zoti Kol  K ta, Zoti Nunzio Lojakano.

Gjith zyrtaret qen  zgjedhur me duartrokijene, dhe keshtu ju dha funt mbledhjes.

### **KRYE XXIII**

#### **KLERI ITALO-SHQIPETAR PER VELLEZERIT T'EPIRIT**

Shkaku i mos bashkimit n  Shqiperi t  Shqip tar vet, isht  ndryshimi e Fevet, n  mest  t  tyre, t  cilit p rdahlen ne tre Fea, Ortodoxe, Katolike, e Muzulmane.

Po shkaku i mos bashkimit nuk jan  vet Fet, qe prishin dashurin vellazerin t  Shqip tar vet, po m  tepr  isht  propaganda e influenca e huaj . K to fuqi losin rollin me an n e Fevet p r interesat e tyre, njera prej fuqivet me te medha q  los  rrollin me t  math isht  Austria, e rila k rkon me an n e klerit Katolik t  p rhapnj  Katholicizm n p r interesat e saje.

Rusia n  tjet r an  per me ndihmuar Slavet e Balkanivit. Greqia *ku adra* me rrezik shme, dhe ajo kafsh  e vdekur prej urje, k rkon p r me shkyer Shqip rin, e me an n e Fes  e t  Klerit, cili lot nj  role t  math, e me pralla g njeshtare k rkon p r me g njejhur popullin e varfr  e t  pa dijtur p r me shiguruar madhumin e Elladh s  mbi kuris t  Shqip ris . Nnga gjith k to gjera q  ngisnin n  Shqip ri, t  cilat trazonin dhe vinin n  rr zik *bashkimin* dhe *lirimin* e Shqip tar vet.

Kleri Italo-Shqip , t  Sicilis , p r me mbajtur t  drejtat kombetare, mbajti nj  mbledhje n  katundi Shqip  Piana dei Gre . N  k t  mbledhje p rfaqezoshin dhe Kollonit , Kontessa Entellina, Palazzo Adriano, e Mezzouso. N  mbledhje muar pjes  dhe shum  par si t  Katundit. Kleri qe i Kryezuar prej At Gjergj Dor griqia, Ar ciprifte i Kishes madhe Sh n Dimitri, edhe k ta prifteri-

n . At Josefi Muzaqia, At Paolo Sqir , cili m  von m  1904 qe zgjedhur p r Piskop  t  Shqip tar vet t  Sicilis , At Josefi Petrotta, At Damiani Karnesi, ispektor i Konvitet-Saluto, si edhe shum  t  tjer  t  cilevet na mungj n em rat. U bizedua ngarjet dhe vojtjet e Shqip ris  e me tep r ishte p r me shar  Klerin Shqip  t  Ipirit, i cili si i verbuar prej Patrikan s, lot interesat e armikut p r d ni t  Atdheut.

Tue me p rbledhur t r  shkaket e mbledhjes, u p rfundua m  par  p r me b r  nj  thirje p r nj  bashkim, e nj  program t  p rgjishm  mbe t r  klerin Italo-Shqip , t  Sicilis , e t  Kalabris , p r me punuar p rbashk  p r qellimin i Nalt  e i Shejti, p r me shp tuar prej thonj vet t  duarav t t  r zishkme Greke.

Edhe u-sholegjua p r me d rguar priftenj Italo-Shqip , n  Shqip ri Verore, p r me mar  nj  mar veshje me at  kler  Shqip tar. U-sholegjna edhe p r me thirur Atdhetarin Shqip tar i cili ndodh sh  n  Itali, Zotin Gaspar Jakova Merturi, dhe p r me kerkuar keshilla prej zotenis e tij, p r form n m  t  mir , dhe me t  shpejt , p r me mbytur propagand n Greke. Edhe p r me dh n Fes  madhenimin e form n e vjetur si n  koherrat trim reore t  Atit ton  Skenderbeut.

Edhe p r me kerkuar nj  form n m  t  leht  p r me prur  nj  bashkim v llaz ror  n  t r  Shqip tar t. Me k to pika u imbill mbledhja e klerit.

## KRYE XXIV

## THIRRJE SHQIPETAREVËT MIESDITARE

Zoti Petro Skagljone, në Qyteti Palermo më 24 te Qershorit 1903, bëri një lajmerim-thirrje popullore, për me zgjuar e dhën kuptim edhe punitorëvet Shqipetarë, qëstjen Atdhesore, e Kombëtare, e për me dhën edhe fillim në populli komitete, për me punuar për shpëtimin e lirim të Shqipërisë.

Ky ishtë lajmerin-thirrje.

Vellezër Shqipetarë

Neve vellezër Shqipetarë të qytetit Palermo dhe të tjerëve vende (vise) kemi dëtyrë për me ndihmuar vellezërit tanë të Shqipërisë, të cilat pë shumë vjet kan qënë edhe janë ndjekur nga qeveria Turke, edhe nga ambizia të fuqivet të imbezha, të cillat kërkojnë për me ja rëmibjekur, për me rroberuar ato.

Neve o! vellezër! me ndihmën tonë, me kurajon, edhe dalldisien jonë, dot mëndë të ndallojmë këtë forcatë (katillek). Neve jemi të dëtyruar për me bërë të njohtur fuqivet të medha tërë përpjekjet trimërore të Shqipetarëvet, për me dalë nën roberin të qeverisë Ottomane. Historia jonë ishtë nijaft e mbushur me shenja trimërore e të çuditme, të tepra për të njohtur kombësinë e një populli. Tue me filluar prej kalorit trimërorë *Akile*, cili qe thirrrur prej vjershëtorevet kryetari i luftës, edhe marë e lidhur dorë, me dorë që në kohë të Maqedhonisë me *Lekën e Math*, cili rrëfeu botës e njohtur trimërin e tij tue me shtruar e me shbutur kryenaltësinë e Persianëvet edhe Asiatikevet. *Pirrua, Skënder-beu, Ali Pasha i Tepelenës*, shekojmë tri emëra të përbledhura në tri kohera që dot rëfejmë me shpejtësimin e flutërimin e zogëvet. Në i pari falë mundasin madhështorë të Romanëvet, e të Maqedhonëvet, të Karaxhinësevet, i cili për dy vjetë mbretëroj Sicilinë, në ky trim përnjohim të flaktin Shqipetar i cili, çkëlqen dhe naltëson kombësin e tij, të cilën e shkulli nga

erësira me luftat e tij të pa përmundura, nën hien e emërit tij të pa vdekur. Në i dyti shekojmë me nder dhe dashuri të çkëlqeje si çampion i qytëtërimit' Europës, kundra barbarizmit Asiatik, edhe i shtrenjti ndihmëtar i Krishterimët kundra invadhorevet barbarë.

Emri i tij zgjon prej gjumit Shqipetarët, ju fut dashurin kombëtare në zëmrat e tyre, ju ep virtutat Atdhesore. Emri i tij ishtë i njohtur si shejtori i lirisë, të kombësinë, edhe të shpëtimit përpara të ardhurit e të trashgimëtarëvet, emri i tij lipset të jetë i shtir n'ezemër që do Shqipetari.

Në i treti, në i fuqishmi zot i janinës, gjejmë një embëlsirë të bashkuar në mestër të egërsiravet.


Nuk dua farë të dreqësonjë përbajtjen e keqe. Po në kjo fletë vetëm dot shigurojmë një fjalë nderimi, përsë një ambicie e madhe me griu shpirtin, një naltësi, mëntimi me çau kryet, *Ali Pasha Tepelena*, dash me dhën Shqiperisë. *Liri, Bashkim, e Independencecën*.

Edhe për shumë të tjerë ishtë për me çkelqyer rrojtja. Shtu shkruan Biondelli (1) për Popullin Shqipetar. Në për shkuit bëri çuditje trimërore, përposhu-soj kryenaltesin të Republikevet Greko-Romane.

Të mbretërvet të Persisë, e të Babilonisë, edhe me krahiruar princerat Maqedhonë, shtrëngoj fuqimin e Romanëve për me ndihmuar të mjerët Tarantinë.

Griti thronin të mbretërvet të Siciлиsë, edhe të Grekërvet, dhe akoma nuk pat një historian të bënje fialë mirënjohie, as ndo shkrimitar të vjetër o se të ri, se i kanë përmirënjohur, po vet ndo një vjershëtor udhetar, tue me ju dhën titullin barbar i kan zënë pak në gojë.

Provat më të teprat trimërore të këtij kombi janë të përlidhura bashk me historinë e tyerë kombëve. E sot aj popull aqë madheshtor poshtërohet prej një



qevërie tirane e barbare, edhe kur do herë erre me në prëmtimet. Ky popull aqë i fortë edhe trimë ishtë i shtrenguar të rronjë nën kondizieve të një i Zot'i egër e pa kujdesi, e cila ishtë qevëria Turke.

Shqipëtarë! Vellezërit tanë të Shqipërisë, pas gjith këtyre ngjarje, janë të shtrënguar për me shkruar nën sundimin të fuqivet të huaja, për me shpëtuar nga ngjarjet.

Gjuha jonë, gjuha e të vjetërve Pelasgë, prej neve përmajtur gjer me sot me kujdesi, munt të thuhet afrë humbjes; Pse Turqia, jo vet që nuk hapi shkolla në gjuhën amtare, po edhe ju dha lejë fuqivet të huaja për me hapur shkolla në gjuhërat e tyre. Si prej Slavëvet, Austriakevet, Grékëvet, të cilat më shumë këta të fundit përdorin këtë mënyrë për me humbasur gjuhën edhe i-dhealin kombëtar në Epir.

Po Atdhetarët e vërtetë Shqipëtarë, tue me shëkuar rezikën i kan bërë mjaftë protestime Qeverisë Turke; Po kjo, kur do herë ka bërë vesh të shurdhur; pra

nga këto shkake Atdhetarët Kom:bëtarë bejnë preqatitje për me liruar Atdhenë.

E neve Shqipëtarë të Italisë që ndjemë rrjedhjen e gjakut trimërorë të prindërvet tanë, jemi të dëtyruar të bashkohemi edhe për me lëftuar me vëllezerit tanë të Shqipërisë.

Edhe për me pasur bashk-punimin në çëstjen e shpetimit t'atdhent tonë Shqiperi. Tani vellezëri Shqipëtarë të Sicilisë, s'edhe të tjera ave visive pa ndrishim *Feje*, or se *Parti*, lipset të bashkonemi tërë nën slanurin madheshtor të Atdheut, e tue me thirrur tërë prej bashku me një zë. Rroftë!.... Rroftë!.... Liria e Independencia Shqipetare!.... Porposh Barbarizma.

*Petro Skaljone*

Palermo, 14 Gusht 1903.

(1) Biondelli Bernardo, Shkrimtar, e Arkeologë e glotologë Italian, shkruati veprën: "Atlante linguistico d'Europa", edhe "Letteratura popolare d'Epiro". U lindë në Verona 1804 — vdikë 1886.

## KRYE XXV

### FILLIM'I KOMITET POPULLOR SHQIPËTAR NË QYTETI PALERMO

Pas thirrjer të botuar prej Z. Petro Skaglione, një livisje e madhe u-bë në mestër popullit, edhe qe mbajtur një mbledhje në shpia e atdhetarit Z. Nini Borgia, më 23 të Gushit 1903. Dhomat qenë të mbushura më Shqipëtarë prej popullit, cilat rronin në qyteti Palermo, po teprësia e këtyre ishte prej Katundit Piana dei Greçi.

Hapet mbledhja e sekretari i komitetit he-per-he, leçiti mjaftë letra prej shqipëtarëve që nuk mënde me ardhur në mbledhja, po bashkoneshin, në qellimi të çëstjes e shejtë.

Pastaj mori fjalën Zoti Petro Skaglione, i cili më përparrë bëri të njohtur dëgjonjzve, shkakun e qellimin të mbledhjes e tue rrëfjer historin e Shqipërisë, e ngjariet e saja që shkonte nën sudim barbar

të qevërisë Turke. Thote: Vellezëri Shqipëtarë, qevërite Balkanike futjën spica në populli i pa dyturi, për me pasur rastin për me rrembjer viset m'ëtë mira të Shqipërisë. E që mjaft atdhetarë, Shqipëtarë të Shqipërisë, tue me shkuar rezikun të Atdheut, kanë filluar mjaftë shoqerira, e kërkojën për me preqatitje kombin për një kryegritje të afrme.

Thirrja dhëmsore të vellezëreve për atej Adriatikut, shkundi dhe dhëmbi zëmërat e Shqipëtarëvet të Kalabris e të Sicilis, të cilët kan themeluar shoqerira kombëtare, s'edhe këtu në këtë qytet prej klasës vështore u themelua një shoqeri kombëtare, për me mbrojtur të drejtat e vellezëreve të Shqipërisë: Po unë thote; Zoti Scaljone, nuk ju kam thirrur juve në kjo mbledhje për me kundreshtuar

këtë shoqeri. Io! fare; unë ju thirra juve pse, tërë liritë e kombëvet në botë kan qënë të fituame prej popullit. Populli ishtë aji që derth gjakum e vet për me dhën lirin e shpëtimin kombit. Për këtë shkak, kam thirrur juve të popullit, për

ljone, cili bën me njohur s'ishtë nëvojë të madhe për me bashkuar e bashkpuuar, me *Shoqerinë kombëtare Skënderbeu*.

Për me bisedua këtë, çëstje ish e mira për me zgjedhur një komision për me




*Prof. Antonio Skura*

me ju kujtuar, se andej nga Adriatiku, rron një kombë vëlla në rroberi, dhe i cili fortë i lodhur prej egërsiravet të një qeverie barbare dhe e rremë në prëmtimet e saje: Vëllezër sot ky komb, ngrit kryet prej pellorit, dhe kërkon shpëtim e liri. Ky komb trim' ishtë vëllaj jonë. E ne si vëllezër që jemi, kemi dëtyrë për me bashkuar e ndihmuar, për me shpëtuar prej thonjëvet të një zoti pa besë. Fjalët e fundit u-pritën me duar trokitje, e me thirrje: Rroftë, Rroftë, Shqiperia, pas pushimit, prap zë fjalën Zoti Ska-

përparaqitur në zyrtarët e "Shoqerisë Kombëtare", tue dhe ju dëstua nëvojën për një bashkëpunim, po mos me ardhur në marëveshje, mund të ujdisemi në mest neve.

Pas shumë bizëtimeve, qenë zgjedhur zyrtaret e komisionës të cilët qenë këta: Z. Petro Skaglione kryetar, Z. Nini Petta sekretar, Z. Francesco Brankacchio, Z. Kolë Sqirò, Z. Josefi Kuççia, komisione. Edhe u-solligjua më përparrë me shkuar komisiona me dërgua letër kryetarit të "Shoqerisë Kombëtare". E këtu ju dha



funt mbledhjes. Pas letrës që i dërgoj Sekretari i Komisionës, Zotit Kal. Françesko Musaqia, Kryetari i "Shoqerisë Kombëtare Shqipëtare", të qytetit Palermo, cili pas me marë e me kënduar letrën, me shpejtesi, ju përgjegjet, Zotit Petro Skaglione, kjo ishtë letra.

*Assoċiazione Albanese della Sicilia  
con sede in Palermo*

Palermo, 5-9-1903

Z. Petro Skaljone.  
Via Montalbo, 18, Palermo.

Të dashur Atdhetarë

Thirrja dhëmsore e vëllezërvet tanë andej prej Adriatikut me deshirën për një Atdhe të lirë, nuke munt të ishte mos me shkundur zëmrat të Shqipëtarëvet t'Italianisë.

E ju Shqipëtarë Punëtorë të Sicilisë tue me mbledhur në nënkomitet kini mbushur një dëtyrë të vërtetë Atdhesore.

Jam kryelartë të ju shtrëngonj dorën. Ju thresë për të hënë mbrëma që vjen më ora  $9\frac{1}{2}$  në zyra provizore të kësaj shoqerie.

Ju falenderonj.

*F. Musaqia*

Piazza del Cancelliere No. 7.

Pas kësaj letrë, komisiona punëtore Shqipëtare formuar prej ZZ. Petro Skaljone, Nini Petta, Françesko Brankaç-

cio, Kolë Sqirò, Josefi Kuççia, u-për paraqit natën e shënuar në zyra e Shoqerisë Kombëtare.

Kryetari Zoti Kal. Françesko Musaqia, priti komisionën me nderime, e bukur mirëpritje, e me falenderuar me fjalë të bukura komisionën për Atdhetarizmën e dëftuar. Veçanërisht falenderoj Z. Petro Skaljone, për punën e propagandën e madhe që bëri në mestrë të Shqipëtarëvet punitorë, për me ndihmuar çëstjen Kombëtare. Z. Skaljone, i falet nderit kryetarit, për fjalët e bukura, e tue me thënë s'aj vet kish bërë dëtyrën si Shqipëtar, e që këtë dëtyrë dot e ketë dhe ç'do njeri që ishtë prej sojit Shqipëtar. Pastaj u-shtruan bizitimet për bashkimin.

Z. Kal. Françesko Musaqia, thotë s'aji ishtë shumë fort i kënaqyr për një bashkim e bashkëpunim, dhe që e ka për nder, dhe dëtyrë për me bashk-punuar me Shqipëtarët punitorë, për mbrojtjen e Memdheut.

Z. Musaqia ju detyrua komisionës, qe aj kishte për me thirrë një mbledhje të veçante të Shoqerisë, për me shtruar në anetaret deshirat e komisionës, për me ardhur bashkimi. Komisioni popullor, u mbet, e shkoj fortë e kanaqyr prej mirprites të Z. Musaqia.

Pas pak dite u bë mbledhja dhe ardhja bashkimi.

## KRYE XXVI

### I KARTERTI KONGR

Tërë shtypi Italian, shkruati e foli shumë teprë, për mbi çëstjen e të katertit Kongres Shqipetar, mbajtur në ditat 14, 15, 16, 17, të Qershorit prej Shqipëtarëvet t'Italis, në Qyteti Napoli, në 1903.

Shtypi Italian më teprë foli mbi përgjariet e kuvendit, ardhur mbi shkatet të lakminit të tronit të Shqipërisë. I pari Princi Don Giovanni d'Aladro Kastriota, cili rronte në Paris, e i dyti Markesi Giovanni Kastriota Skanderbeg, i cilli rronte në Napoli.

### ES SHQIPETAR

Në ky kuvend, gjith katundet Shqipëtë të tërë visavet t'Italisë dërguan që do njeri përfaqesonjezin e tyre. Katundet Shqipëtë Sicilisë, Piana dei Greçi, e cila që përfaqesuar prej Profesorit të gjuhës Shqipe në Onoversiteti Orientale të qytetit Napoli Z. Josef Sqirò. Katundi Kontessa Entellina, prej zotit Luis Xhenovese. Në ky kuvend edhe muartin pjesë mjaftë Atdhetarë Shqipëtarë, të Shqipëris, që rronin jashtë Mëndheut, si në Francë, në Rumani, edhe në Svicer.

Prej atyrëve që ju dimë emërat emërojëm këta, Zoti Prof. Dervish Hima, direktori i gazetës Shqipe "L'Albanie". Zoti A. M. Parthenis, Zoti Gaspar Jakova. Në dita e parë të kuvendit, mbledhja që hapur nën kryesin e Zotit Prof. Malio Beniči, prej Katundit Piana dei Greçi. Më parë se të hapen bizetimet, sekretari liçiti letrat, s'edhe telegramet që kishën ardhur në zyre të kuvendit. Dërguan telegramë, Princi Don Giovanni Aladro Kastriota, kryekatundari të qytetit Palermo, Deputeti Onn. De Marinis, e shumë të tjera.

Pas leçitjes u shkua në bizetimet, në e para nye të kanunoresh, e cila ishte përmë bashkuar, në një federatë të Shqeritë Kombëtare Shqipëtare t'Italiane, s'edhe në mënçin dhe ato brënda, dhe jashtë të Shqipërisë.

Mbedhjet të sesionit të ditëvet 15-16 janë mbajtur nën kryesin e të fameshit Shkrimitar Zoti Akile Torelli, kryetar i Shoqerisë Gjergj Kastriota.

Pas shumë bizetimesh ardhë në një marveshje të pëlqyer për kanunoren s'edhë përmë formën e bashkimit të gjith Shqerivet Shqipëtare, në një Federatë, me qendrën në qyteti Napoli. Kur ishtë përmë të mbyllur mbledhja, ardhë një mosmaveshje e reptë, në mestër përfaqesonjesit, nga shkaku se një nga delegatet e kuvendit vu përparrë në preponim, që të falenderonin nga ana e kuvendit zyrtarishtë Princin Don Giovanni Aladro Kastriota, përmë punrat Madhështore që ky njeri ka bërë përmë kombin Shqipëtarë. Kryetari Zoti Akile Torelli, nuk e pranoj, dyke u thënë se, Kuvendi nuk lipset zyrtarisht të falenderonjë këta njerësh nga shkaku i lakimit të kë tyre mbi thronin e Shqipërisë, e falia nga ana e ku-

vendit, i cili përfaqeson Shqipërin ishtë përnjohja e tyre.

Për këtë shëmbël u çel një luftë e reptë në mestër të mbledhureve, të përkrahesit të Princit çsaquin veprat e nalta të Princit, me të cilat ka përkrahur çestjen Shqipëtare në diplomatët Evropianë, e fitimet e bucura që kjo përkrahje i pruri Atdheut.

Kundreshtarët përnjohnin shërbimet të Princit, po vet kundreshtoheshin përmë lakinimin e Princit mbi thronin e Shqipërisë.

Pas shumë kundreshtime, u ardhë në marveshje, tue me dërguar një falenderje jo vetem Princi Aladro Kastriota, po edhe tërë përkrahesve të çestjes Shqipëtare.

Në dita 17 e fundit ju dha leçitje mbi tërë punrat e kuvendit, që kishte bërë në ditat e shkuara, si dhe mbi lakinimin e thronit të Shqipërisë, edhë në këto pikat, mbi zgjedhjen e zyrtarevet, mbi formën të judisjes të Federatës, përmë përdorimin e perhapjes të çestjes Shqipëtare, dhe me përkrahur me dashuri shtypin Shqip, i cili ishtë arma me fortë të mbrotjes kombëtare. U fol e u bizidua dhe mbi çestjen e një abetari i përgjithshmë, po pas shumë fjalimeve nuk ardhë në as një përsfundim.

Pas që mbledhja mori pëllqimet, kryetari Zoti Akile Torelli, falenderoj tërë përfaqesonjesit, me shpresën të madhe që dot me mbushur dëtyrën e tyre përmë të ardhmit e parparimit të Atdheut i tyre, e tue uruar që përmë se shpejti ky kuvend të mblidhet prapë, po jo në këtë qytet po brenda të Shqipëri të lirë e endependente, mbarimi i fjalinit u-prit me duar trokitje.

Kuvendi u mbyll me thirrje rroftë, rroftë Shqiperia e lirë e endependente.

## KRYE XXVII

### ATDHEUTARE, SHKRIM'TARE DHE ARTISTË SHQIPETARE

Kemi mjaft Atdhetare, në Shqipëtarët e Italis, po vet dot shenojëm më të nevojshmit, me qënë që emerat e tjereve na mungojën.

*Prof. Josef Sgirò*, lindur në katundi Shqipë i Siçilisë Piana dei Greçi, i parnjë që kje i njojur zyrtarishtë prej Qeverisë Italiane profesorë i gjuhës Shqipe



në Universiteti të gjuhevet Orientale Qytetit Napoli.

Profesori Sqirò, ishtë një nga më të fortit e të mbaruarit Shkrimtarë të gjuhës Shqipe, edhe vjeshëtor i madhë, Jane për të kuituar veprat e tja, *Rapsodie Albanesi*.

*Kal. Anselmo Loregio*, lindur në katundi Shqipë i Kalabris Pallagoria-Katanزارو.

Themeljeni e Direktor i gazët Shqipe "La Nazione Albanese", i për 25 vjetë po ncjer me regull, me ketë gazet ka sjetur vepra të medha çëstjes kombëtare, e ka përhapur dashurin në mestër Shqipëtarëvet. Pas pushimit të luftës e për-botshme, "Shoqeria Pan-Shqipetare vatra" tue me njohur veprat kombëtare, edhe Atdhetarismen të kulluar është emëroi delegate, për me përfasuar shqipetaret t' Amerikës, në konferanca e paqes, e me kerkuar të drejtat të Shqiperisë.

*Prof. Orazio Irianni*, i cili ç'do Shqipëtar i dhëmbet në zëmër, dhe me vdekjen e tij, ardhur në 1917 në Katundi i lindjes Lungro, Shqipëria humbi një Atdhetar të rralle, më teprë në këto koha të nëvojshme. Prof. Orazio Irianni, ishtë forte i përnjohur në Shqipëtarët e Shqipërisë për vepra Atdhesore në South e North Amerika.

*Avv. Terenzio Tocci*, prej Katundi Shën Kosmo Albanese. Udhëheqës dhe shkrimtar i fortë, i cili mori pjesë në Kryengritjen e Malësoreve, e më në fund të në lufta Europiane, për me ket kundreshtuar politikën Italiane kundrejt Shqipërisë, që mbajtur shyrqjin në Katundi i lindjes.

*Zoti Gaitano Petrotta*, prej Katundi Piana dei Greçi, Shkrimtar, e konferencier, i fortë, me artikulat e argumenta, të botuara në shtypi Italian, i soli një fitim te math çëstjes kombëtare.

*Prof. Thoma Karnesi Russotto*, prej Piana dei Greçi, Atdhetar e shkrimtar i rrallë, e sekretari i shoqerisë Shqipetare të qytetit Palermo, "Lidhja Kombëtare Skënder-beu".

*Avv. Francesco Krispi Glaviano*, prej

katundi Palazzo Adriano (Siçili), vjeshëtor e Atdhetar i flaktë.

*Avv. Onn. Saverio Masi*, prej Piana dei Greçi, Deputeti në qeveria Italiane.

*Kav. Françesko Musaqia*, prej Shënta Kristina Gela, një nga më të larti në ndjenjat kombëtare, e themelonjesi i Shqipërisë, kombëtare shqipetarë të Palermos.

*Zoti Guidera Trifonio*, prej Piana dei Greçi, Atdhetar i flaktë.

*Dott. Angelo Leotti*, me diplomë profesori të gjuhevet Orientale të Institutit Orientale, të Napolit. Botoj në 1916 në Milano një gramatik fjalimi, Shqipë e Italian, e Italian-Shqipë, emëruar "L'Albanese Parlato".

*Zoti Feliçe Toççi*, lindur në katundi Shqipë Vakarizzo-Albanese (Kalabri), lindur me 7 të gushtit 1840, mori mësimet në Kollegj Italo-Shqipë të Shën Dimitri Korone. Në 1872 emigroj n'Amerikë, e pas pak kohë në qyteti i New York ut, hapi oficë bankë. Në kjo degë, në puna përparaj me shpejtësi, dhe më 1880, bleu gazetën e përditeshme "L'Eco d'Italia", edhe u-shtu në fusha gazetëris. Pastaj dërgoj e mori të degjarin Profesor Giuseppe Kadikamo, për me drege ruar gazeten "L'Eco d'Italia". Dihmoi njëastë herë Kollegjin Italo-Shqipë, e më ne funtë më përpara me vdekur bëri dhjatë (që gjith pasuria me vet) (private) që mbihet pas vdekjes e të nderçmes zonjë Rosina Toççi, tërë pasuria të jepet Kollegjit Italo-Shqipë të Shën Dimitrit Koronit, për kërkimet etimologjke të gjuhës Shqipe. Vdiq në "Staten Island". N.Y. Më 27 të Marsit 1918.

*Dott. Nikola Barbato*, prej katundit Piana dei Greçi, për shumë herë deputetë në qeveria Italiane.

*At. Prof. Gerardo Konforti*, Atdhetar dhe shkrimtar i Shkëlqyer, e sekretar, të komitet qentror Italo-Shqipë të qytetit Napoli.

*Avv. Kal. Paskal Dorsa*. Atdhetar i flaktë e kryetar i komitetit qentror Italo-Shqipë te qytetit Napoli.

*Kal. Gjegj Maxhiakamo*, prej Piana dei Greçi, Atdhetar i Shkëlqyer, e krye-

tar, i "Lidhjes Kombëtare Skënder-beu, te qytetit Palermo.

*Prof. Mario La Piana*, prej Piana dei Greçi, Officer i Ushterisë Italiane, edhe shkrimitar i fortë në gjuhën Shqipe.

*Hiresja e Tjë Pali Sqirò*, Piskope të Shqipëtarëvet të Sicilisë, lindur në katundi Piana dei Greçi, Atdhetar i flaktë dhe i Shkëlqyer, cili në Kollegj Italo-Shqipë të qytetit Palermo ka dhën kon-

*Dott. Gaitano Sqirò*, prej Piana dei Greçi, Atdhetar i flaktë.

*Avv. Francesco Mauro*, prej Kalabrie, Atdhetar i flaktë dhe kryetar i kuvendit, edhe Shoqerise Kombetare Shqipëtare, të qytetit Napoli.

*Zonjeza Kekina Bidera-Barçia*, prej Palazzo Adriano, Atdhetare e shkrimitare e shkëlqyer, edhe kryetaria e komitetit semërorë që u-themelua në qyteti Pa-



Tenor Shqipëtar Josefi Mauro

kurse në nxënësit për dorëshkrimin më të bukur në gjuhë Shqipë.

*Prof. Gjergj Kostantini*, prej Piana dei Greçi. Shkrimitar, e Atdhetar, dhe konferencier i degjuar.

*Prof. Stasi Petta*, prej Piana dei Greçi, Direktor i shkollevet mbreterore Tenike (Piazz) të qytetit Palermo, Atdhetar edhe shkrimitar i dritsuar.

*Prof. Antonio Skura*, lindur në katundi Shqipë, Vakarizzo Albanese (Kalabri). Atdhetar e shkrimitar, edhe artistë i zo-grafimit, dhe autor i nji libri, "Gli Albanesi in Italia" me mbledhjen të këngavet Shqipe të popullit, Shqipëtar.

lermo, prej gjith zonjavet shqipëtarë. Për me bërë një flamërë i mëndafshë, shum-fortë bukur i qëndisur, për me ja dhu-ruar qevërise Shqipëtare, për-kujtim të Shqipëtareve t'Italisë, për me ket situar Shqiperia "Lirin endependëncën".

*Zonjeza Maria Musaqia*, e Atdhetare e flakte, sekretaria e komitetit femerorë i flamurin.

*Zonjeza Nikolina Karuesi*, Afdhetare e vyer, e Sipresha e kollegjit Shën Maria, në Piana dei Greçi. Ësila ka kërkuar prej qeverisë Italiane për me njojur kollegjin, e me dhën leje zyrtarishtë, për me dhene mesimet në gjuhë shqipe.

*Prof. Manlio Benici*, prej katundit Piana dei Greçi, Gazetar i famshë, e atdhetar i flaktë, Botoj për mbi çëstjen Shqipëtare mjaftë artikulla me rëndësi në shtypi Italianë, për imrojtur interesat kombetare.

*Giovanni Di Maio*, nga Greçi di Puglie, përsimëtar, e bashkë luftonjesi me Xheneralin Garibaldi.

*D. Ludoviko Lusi*, nga Greçi di Puglie, gjykat i shkëlqyer, i cili për me pasur mentine liredashje qe mëre prej qevërisë Borbone e futur në burgë, te ku vdiq.

*Akile Torelli*, Atdhetar, e shkrimtar i degjuar, autor e shume veprave dramatike, e artiste i famshë me vet. Kryetar i Shoqerisë qentrore Shqipetare të qytetit Napoli, edhe kryetari i kuveneve Shqipetare që u-mbajtin në Napëli.

*Zonja Berti Masi*, grua e perëndeshme në shenat dramatike, e famshe në mjeshteria për me veshur natyrisht pjesën një-rësore. Kryetaria e Kompanisë që përndorin qjith atë emër. Kjo grua e dëgjuar ka lojtur drama në më të mbëdhenjetë theatro të botës.

*Josef Mauro*, lindur në Katundi Shqipë i Sicilisë Piana dei Greçi. Atdhetar i flaktë, e fortë i mirnjohur në kollonitë Shqipetare t’Amerikës, për dashurin e tij kombëtare Artistë e Tenor dramatik, i cili nderon shumë fortë emërin Shqipetar.

Mori mezimet në qyteti Palermo, e pastaj shkoj në Milano të ku mbaroj mezimet, për Tenor dramatik të “Grand Opera”.

Lluati në shumë theatro të medhenjë të botës, me triunfe artistike-këngëtore, Operat muzikale me teprë të lluata prej Z. Mauro janë: *Othello, Aida, Trovatore, Kavaleria, Pagliacci, Ballo in Maskera, Rigoletto, Toska e Forza del Destino, L’Ebrea, Norma*, e shumi të tjera.

Kënton edhe në gjuhë Amitare Shqipe, e tashi në funt ka këntuar kënka shqipe në plakat e Kampanivet Fonografike Kolumbia e Victor.

Tashi imbetet në New York te ku ka

hapur një shkollë zeri, e cila shkollë përparon, shum bukur, perse ishte e mbushur me teprë zenazë.

*Zoniza Karlota Karnesi*, grua fortë e bukur e vallëtore e famshme, edhe e para vallëtore të theatrot “Grand Opera” të Parisit.

*Prof. Gjergj M. Sulli*, prej Piana dei Greçi, Muçiqistë i dëgjuar edhe mësonjës i zerit, me zyrë në theatro i New York-ut Opera House. Vdiq në Majë 1918 në Qyteti New York.

*Prof. L. Ferrari*, mësonjës i muzikës, s’edhe piano e vjolinos.


*Prof. Francesco Skura*, prej Vakanizzo Albanese. Pianistë, e kompositor, muzikje.

*Prof. Petro Petta*, një prej më të mëdhenjët zografis të sojit Shqiptar. Tërë kishat e katendit Piana dei Greçi janë më teprë të zografisura prej dorës e tij. Vjerat me të vlera janë Shën Mitri (1). Shpirtrat e burgatorit në kisha e vendvarrimit. Vepra me vjer ishtë Shën Pietri i burgosur, në Kisha e Shën Gjergj (2), edhe shume të tjera. Lindi e vdiq, në Katundi Piana dei Greçi.

*At Gjini Stassi*, lindur në katundi Piana dei Greçi, në cili mori të parët mesime, prindërat tue me shkuar, mindjen e gjerë e tji, e dërguan për me marë mesimet për priftë në Kollegj të Grotta-Ferrata (3), afër Romës.

Tue me marë mesimet, deftoj një dashuri të veçantë në zografimi, në e cila mjeshtri shumë fortë bukur u mbarua. Një prej pikura më të bukura ishtë një Shën Trifon.

*Prof. Gjini Bidera*, prej Palazzo Adriano (Sicili) Artistë e shkrimtare dramatik, shkruati, dramën aritstike-muzikale Shqipe “Euritmia”. Shkruati edhe “Napoli ed i suoi dintorni”, edhe veprën “Matner” në cila veprë dëfton se pelasgjitet qenë të parët ndjenjasit të Sicilisë, tue me dëftuar me argumenta të forta, që vendesit e parë të Sicilisë fjalosin Shqipë. Thotë se qyteti “Trapani” qe i themelluar prej Pelasgjvet, prej shkakut se an deti i qytetit isht me formën i nje



"drapéri". Shtëpia e madhe libërore të qytetit Napoli, Vellëzeria Bideri, janë trashgjmetarët e tji.

*Prof. Mihal Trota*, lindur në Shën Benedetto-Ullano (Kalabri), Artist, i skulturës, cili me artën e tji dëftoj botës e huajë zakonat Shqipëtarë, më përparradoll me ujdisur prej duaravet e vet, ftyrën e trimit Shqipëtar "Akhislao Milano".

Kjo statue qe primuar prej komisionit

artistike, në e madhja artë, në Istituti të bukurevet artë të qytetit Napoli.

Më vonë ujdisi "Nusia Shqipëtare" "Delëruashmin Shqipëtarë", (çobani Shqipetar) s'edhe shumë tjera monëmenta me karakter Italianë. "Il Pezzente" (i pabukshmi), "Il Pescatore" (peshkëtar) edhe "Dantin" si edhe shumë të tjera. Me këto puna qe i klasifikuar artisti i mbaruar, janë dhe shume tjere Shqipëtarë që ndërojnë me punat e veprat e tyre kombin Shqipëtarë.

(1) Kisha Shën Mitri, emëruar Tessalonike, qe ethemelluar në viti 1582. Në kjo kishë mëshonet Shqipë edhe Greqishtë, prej pristeripjeret, po gratë e vashat, këndojën vëngjilin Shqipë, marë prej gazetës qe botonet në Piana dei Greçi, i "Fiala e t'in Zoti", Kethjer shqipë prej Hiresrie e tji Piskopi Pal Sqiro'. Në kjo kishë gjenden dy gurë-varri, me thenien në gjuhë shqipë: në i pari shte thotë: *Vdekja joti gjela jime*, në i dyti: *Në vdekja mënd blihej Kalimëni nëk ishte këtu*.

(2) Kjo Kishë e Shën Gjergjit qe themelluar te viti 1564 edhe qe e para kishë e madhe, të katundit Piana.

(3) Grotta-Ferrata, e fameshe Abaci, e cila qe e themelluar në motë 1004, prej Shejtari Shën Nilo prej katundit, Rosano (Kalabri).

Në kjo Abaci, Shqipëtarët t'Italisë me e shkuat nivojën e priftërinjeve, i kërkuan leje Papës për me dërguar djemtë Shqipetarë, për me marë mezimet e priftelekut. Në kjo Abaci për qindra vjetë shqipetaret kan marë mezimet e diturin, e dashurin për kombin e tyre, për shumë kohë kjo Abaci ka qenë edhe ishtë në duartë e Shqipëtarevet, në kjo Abaci mezonet gjuha Shqipe zyrtarishtë, në kjo abaci kan dale më të Shkelqyemit Shqipëtarë të Italisë.

## KRYE XXVII

### JOSEFI KADIKAMI

Josefi Kadikami, Vjershëtor e Shkrimtar, edhe Atdhetar-i shkëlqyer, ishtë lindur në Katundi Shqipë të Kalabrisë, Shën Dimitri Korone. Mori mësimet në Kollegji Italo-Shqipë të a-tij Katundi, që në djaleri dëftoj mëndje e gjergësie, me idheal të lartë. Në një konkursë dhën prej Kollegjit për në zenazit, përpaqiti një tragjedhi, e cila qe e gjikuar, prej Profesorevet, për formën leterare e dramatike, një vepre e florinjente, autori ishte moshë vet 15.

Në 1860 kur u-grit populli Italisë kundra qeverisë Borbone rrondhi bashkë me shokët vtdashjes për me luftuar nën flamurin e Xheneral Giuseppe Garibaldi.


Më nje të Tetorit 1860, luftoj trimërishtë, në e madhia luftë nën qytetit Volturino. Pas që u-imbarta lufta e Italia u-bashkua tok, shkoj për me mbaruar mësimet në Onoversiteti të qytetit Napoli, në cila u-mbet që në kohë 1861 gjer 1865, që mbaroj mësimet.

Në 1869 qe i-emeruar profesorë të Kollegjit Italo-Shqipë në Shën Dimitri Korone, në cili shkoj, edha mesime gjer në 1876, kohe që ardhë i-emeruar Direktor të Kollegjit Garopoli në katundi Korigliano-Kalabro.

Këtij Kollegj me diturin e mësimet të larta, idha një perparim shum të madh, tue me qene i pernjohur prej botës Inte-

letuale, vendi më i-mirë tē mesimevet tē Kalabrisë, nē ky kollegjë u-mbet gjer nē 1888, kohë që ardhi thirrér prej Zottit Feliç Toççi, pér me ardhur nē Qytetet e Bashkuar t'Amerikës, pér tē dreqesuar tē vehtem gazetë Italiane e përdicme *L'Eco d'Italia*.

Në 1890 themeloj nē Astoria L. I., një kollegj me emërin madheshtor *Dante A-*



Prof. Josefi Kadikami

*lighieri*. Që nē ato Kohë ka qënë pér 30 vietë, apostuli i mësimit.

Kollonia Italiane, e Italo-Shqipetare Adhurojen këtë i vyer plak, i cili ka dhën dritën me mësimet e diturin e urtesin e tij, gjer sat jetë adhuruuar prej gjith zenevet. Prof. Kadikami ka qënë i vetini Adhetar i cili, me shkrime e konferanca, ka per-mbajtur n'emigratet Italo-Shqipetarë, dhezur flakën adhesore pér atdhen tē gjishëvet e tyre.

